

TASIM ALIJA

NJERIU



BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-7

A 58

QESH

Redaktor: Adriatik Kallulli

Piktor: Enrik Veizi

Tirazhi 8000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

Stabilimenti «8 NËNTORI», — Tiranë 1972.

PATRIOTI ME KOBURE

...«Eh, ç'kohë të arta që ishin ato! Perëndia e kishte bekuar njerëzinë! Njerëzit punonin dhe nuk ndiheshin. Sido që ta kishin hallin.

Kurse ne hanim e shqepeshim me mish të pjekur në hell. Pinim raki. Këndonim sa shkulnim gurmazet e mushkëritë. Apo s'qemë burra në vakt atëhere...

Me këto punë të ndritura merrej atëhere edhe i ndrituri, Sali aga Kalemi, pinjolli i fundit i brezit të gjashtë të këtij agallëku. Thonë i fundit dhe jo ndryshe, se ky farë agai nuk u martua që nuk u martua, megjithëqë e lutën sa mundën e ku mundën.

Se përse nuk u martua, kjo mbeti një sekret që u mbyll njëherë e përgjithmonë bashkë me të zotin.

Kështu Sali agai, duke bekuar shpirtin fisnik të katragjyshit të tij, për pasurinë dhe emrin e nderuar që i la trashëgim, zbrazte damixhanat me raki rrushi. Megjithëse ishte koha kur përqark bëhej luftë e përgjakshme, atij nuk ju trondit as gjaku prej agai dhe as burrëria.

Një natë atë e ftoi për darkë vetë Mithat beu. Thonë se atë natë në shtëpinë e Mithat beut u derdh rakia si lumi i Vjosës. U mbajtën fjalime aq të zjarrra

e aq patriotike, sa muret e asaj shtëpie nuk i kishin dëgjuar ndonjëherë.

U lidhën besë e u bënë bera. Këto desh e lanë pa mend Sali again. Atij sa vinte e po i mbusheshin sytë me lot fisnikë.

Kishte ngrënë gati gjysmë tepsie me mish dashi, kishte rrufitur mbi dy okë raki, po asnjë fjalë s'kishte mundur t'u shpëtonte veshëve të tij të gjatë. Mendonte. . .

«Duhej të mallëkonte veten dhe agallëkun e tij që kishte harruar fare mëmëdheun e mjeruar, i cili po hiqte shpirt, i lënë e i përbuzur nga fëmijët e tij të prapë e mosmirënjohës. Duhej të mallëkonte sërisht veten dhe agallëkun e tij që ishte larguar nga këto punë e ishte dhënë pa mend pas lapërdhisë. Duhej pastaj të mallëkonte edhe një herë veten për disa gjëra të tjera, të cilat s'dihej pse s'po i vinin në mendje me aq kthjellim, sa t'i shquante mirë. . .»

I prekur e i lënduar në sedër, mes asaj darke e atyre farë zotërinjve, mes asaj rakië që të frymëzonte për bëma e puna nga më heroiket, Sali agai u ngrit e tha këto: «O miq të shtrenjtë e të nderuar! Gjer më nashti munda trurin se ç'mund të bëja unë për mëmëdhenë e shumëvuajtur, po asnjë ideal nuk më shkrepse në kokën e topitur nga hallet. Nuk dija nga t'ja mbaja, nuk shquaja dot udhën e vërtetë. Po fjala e Mithat beut më ndriti mendtë e çoroditura nga lufta dhe babëzia. . . Nashti, o miq, do di ç'të bëj!

Unë, o vëllezër shqiptarë, do të vdes për mëmëdhenë. . . për. . .», ai diç deshi të thoshte ende, po burrat shpërthyen në duartrokkitje e brohorima dhe e përfshinë në krahët e tyre patriotin, kush më parë e kush më pas.

Ngrinin gotat lart, lëvdonin e ngjatjetonin Sali again, sytë e të cilit po derdhnin lot ngazëllimi të përzier me raki.

Mithat beu, i prekur përmbi të tjerët nga kjo shfaqje e rrallë patriotizmi në ziafetet e tija, u ngrit dhe në mes të gjindjes, duke ju drejtuar Sali aga Kalemit, tha: «Të përgëzoj, o burrë i nderuar, o stërnip i gjallë i Musa agait, rahmet gjetë atje ku prehet! Ti do jesh besniku im, i afërti im. Shqipëria nuk do humbasë, o vëllezër, sapo që paskemi akoma të këtillë burra. E kush të kish njohur, o Sali aga! Në shenjë nderimi po të jap bakshish një kobure!» — dhe bëri përpara. Këtë radhë duartrokitjet qenë më të zjarra; gotat u mbushën plot e përplot, u ngritën lart dhe sakaq u zbrazën në gurmazet pa fund.

Në mes të gotave që tringëllinin e zbrazeshin, mes pjatave me mish që uleshin e boshatiseshin në çast, Sali agai deshi të mbante një tjetër fjalim tron-ditës, por i emocionuar si asnjëherë, duke shtrënguar në dorë koburen e beut, arriti të thoshte vetëm këto: «Po... po... Unë do vdes për mëmëdhenë... rroftë bej Mithati!»

Që atë natë, kur Sali agai u inaugurua si patriot, vendosi t'i jepte vetes më tepër rëndësi e duk. Ai do të vdiste për mëmëdheun dhe donte të dinte se ç'i duheshin ende një patrioti, i cili kishte vendosur të bënte një hata të tillë. Që të nesërmen u bë më i dëgjuar. Kudo që ja shtronin, ai e shihte të udhës të mbante fjalime, që i mbyllte përherë kështu: «Bëmani hallall, o shqiptarë, se kam vendosur të vdes si burrat, për mëmëdhenë! Mos më mbani mend për keq, se të keqen asnjëherë s'ja kam ndjellur njeriut, as hasmit.»



Këto të preknin pa masë dhe të afërmit e tij bënë hesap me mend e me gishta, se kur u binte radha ta ftonin këtë azgan burrë, sapo që së shpejti do të ndaheshin me të.

Dendur Sali agai rrinte e vriste mendjen... «A ka patur ndonjëherë Shqipëria të tillë burra? Pa dyshim jo! E cilit nuk i dhimset jeta? Po pse vallë mua nuk më dhimset jeta? Për besë, s'e di!»

Këtu Sali agai ndjente të dridhura në trup e në zemër dhe lëshohej mbi gotën shpëtimtare të rakisë. Flokët e gjatë e të zezë i binin anësh e mbi ballë, si një shtëllungë e shpleksur leshi, po atij aq i bënte. Fundi edhe flokët për mëmëdheun do t'i linte.

E ç'i duheshin më flokët e zezë, sytë e fryrë, ç'i duheshin veshët e gjatë, goja që i hapej vesh më vesh, ç'i duheshin këto pra?

Edhe sot nuk dihet mirë se qysh ra në betejën e parë Sali agai. Gjithashtu nuk është saktësuar as numri i të vrarëve, sa u plagosën, sa pushkë u zbrazën, sa pula u zunë ngushtë dhe sa u zunë me pula në duar. Janë në kërkim vetëm gjurmët e Saliut, që ja mbathi nga sytë këmbët si asnjëherë në jetë. Atë djall dyfeku, që rëndonte si një cjan i therur, s'pa ku e vërviti, duke lënë një boshllëk në muze.

Koburja, që i rëndonte sa një çanak me dhallë, në atë vrap të hatashëm desh i këputi belin, po ai as që u kujtua fare se kishte edhe kobure me vete, aq qysh kishte marrë.

Si kaloi kështu furtunë tri fshatra, u fut në derën e një miku. Po edhe aty i bëhej sikur e ndiqnin prapa. Darka ishte aq e bollshme, sa që Saliu i harrroi të ndjekurat dhe luftën. Ishte darkë, jo shaka. U ngritën aq shumë shëndete për again, sa që sikur njerëzit të majmeshin sipas shëndeteve të rakisë,

nuk dihet ku do të shtriheshin, sa tonelata peshë mishi do të arrinin dhe ç'do të mbanin në brez në vend të kobureve!

Aty nga ora gjashtë e natës (allaturka) në tryezë u shtrua një qengj i pjekur, i paprerë. Kjo nuk çuditi asnjëri, po i bëri të luanin ca nga vendi e t'i afroheshin tryezës, megjithëqë kishin ngrënë sa s'mbanin më.

Po i zoti i shtëpisë ua preu yryshin.

— Ky qengj i pjekur, o miq, është për Sali aganë. Kemi një bast të vjetër. Po e hëngri këtë, hallall edhe mëzin kërr, po s'e hëngri dot, do t'i fluturojë edhe pela çile.

Të gjithë shkundën gotat dhe ja mbërthyen sytë patriotit. Ai filloi nga kofshët. Mishin e zhvishte nga kocka me një aftësi të çuditshme patriotike. Kockat i flakte pa parë ku, ndërsa mishin e kapërdinte si të qe hashure taze. Kështu fluturuan kofshët, humbën brinjët dhe Sali agai po u afrohej burrisht shpatullave për t'i shporrur edhe ato nga faqja e dheut.

Njerëzia shihnin si të muosur patriotin me kobure, i cili s'kishte ndërmend t'u linte asnjë kockë të tjerëve, duke fituar bastin më të rëndë të atyre anëve. Kjo gjë nuk i pëlqeu as Kaman Kokudhit, që filloi të binte në lloi për këtë punë.

Papritur ngjau e thëna, ajo që askush nuk e pandehte. Atë çast një ballist i dehur zbrazi dyfekun në vërë të genefit. Dy vetë, që po dremisnin, u hodhën përtpjetë dhe dhanë alarmin: «partizanët!»

Kaq deshi puna. Të shumët u hodhën nga penxherja; e shkulën atë me forcë nga çyçyvetë, të tjerë po vriteshin te dera, që duhej të qe bërë së paku katër herë më e madhe, një u fut në sepet dhe dy në musandër. Sali agait ju zu keq. Ndali përtpjën

e furishme, zgurdulloi sytë, u ngrit më këmbë dhe hapi duart anësh. Po kocka i vajti më thellë në gurmaz. Gulçonte.

Dy çipat e buzëve ju zbardhën nga një shkumë e hollë që ju ngri aty. Gratë dhanë kujen sipas zakonit. I zoti i shtëpisë, që s'dinte nga t'ja mbante, u përkul mbi të e tha vetëm kaq: «Përse vallë në shtëpinë time, o zot i madh?»

Kështu e dha jetën për mëmédheun ky patriot i ndritur!

AMORE A PRIMA VISTA

Ata ishin ulur përballë njëri-tjetrit. Si dy kapedanë të lashtë. Dhe në të vërtetë, kapedanë ishin, veçse jo të lashtë. Qenë ulur jo për bisedime. Jo për armëpushim! Jo për armëpushim, pasi armët e Ballit nuk ja bënë ndonjëherë «bam» apo «bum» mbi pushtuesin.

Dhe, kur asnjë armë nuk ja bën «bam», nuk ka si të bëhet armëpushim.

Ata qenë ulur të pinin. Kishin festë atë ditë. Se qe ditë e madhe: kishte lindur perandori! Edhe pse perandori nuk kishte lindur në Shqipëri, edhe pse ai nuk qe shqiptar as nga nëna, as nga babai dhe as nga ndonjë rrugë tjetër e tërthortë, populli ynë e kishte për «detyrë» të gëzohej. Të festonte dhe të gëzohej! Bile ai, populli, fare mirë duhej edhe të krenohej. Të krenohej, pasi diku, prapa diellit kishte lindur një perandor!

Forcat italiane të pushtimit dhe forcat «patriotike» të Ballit kishin marrë të gjitha masat për këtë festë. Se jo çdo ditë lindin perandorë për Shqipërinë!

Mundej, ndoshta në radhët e Ballit ngjiste diçka e tillë pas rakisë, por ata qenë modestë dhe nuk arrinin të kapardiseshin mbi fronin perandorak. Kë-

naqeshin vetëm me festa dhe me dolli, sikur përditë të kishin lindur perandorë apo mbretër.

— Të pimë, kapedan Dalipi! — Ngriti gotën togeri italian. — Të pimë për perandorin! Edhe për njëri-tjetrin! Se ne duhemi shumë!

— Po, ne me të vërtetë duhemi shumë — ja ktheu komandanti i çetës balliste. — Dhe unë shpesh rri e vras mendjen: përse duhemi kaq shumë?

— Oh, po ne një gjak kemi, i dashur! Na ndan vetëm një copë det me ujë. Por gjaku s'bëhet ujë! Hajde, me fund!

— Brum! E që ta paç llafin... tek ajo dashuria jonë. Çudi, besa!

— Oho, besame muçon. ¹⁾

— Jo, jo Besa me Muçon! Ata janë ndarë sot dy javë. Po unë e kam fjalën te dashuria jonë. Sapo të pashë për herë të parë, m'u mbush mendja top se do t'ja kalonim birinxhi. Dhe nuk u gabova fare. Që me syrin e parë.

— Kësaj ne i themi: Amore a prima vista, ose, dashuri me shikimin e parë. Hajde, gëzuar!

— Shëndeti i zotërisë sate. sinjor tenente!

— Mos vajti vonë për fjalimin? A do të jetë grumbulluar turma? — pyeti oficeri fashist me një ton autoritar, meqë kjo i përkiste detyrës dhe jo dollisë. Dhe ai, si oficer i fashizmit, e kishte parim ta ndante detyrën nga dollia, qoftë edhe me anën e tonit të zërit. Ishte e vërtetë se dëndur i ngatërronte padashur, por në lëmshin e ngatërresave të tjera këto nuk ngrinin kandar.

1) Bésame mucho — puthëm fort (spanisht) (varg nga një këngë e njohur).

— Milet i besoj të jetë mbledhur — ja ktheu Dalipi. — Megjithatë, po dal të shikoj njëherë vetë.

Në mënyrë që populli të gëzonte dhe të sqarohet sa më mirë për ditëlindjen e perandorit, qytetarët qenë urdhëruar të mblidheshin përpara bankës. Aty do të mbaheshin fjalime panegjirike për perandorin dhe perandorinë.

Meqë ishte ditë pazari, te bashkia qenë mbledhur fshatarë e qytetarë. Për këtë ishin kujdesur bashkarisht si karabinierët, ashtu edhe trimat e Ballit. Përse të mos gëzonin edhe fshatarët për perandorin?

Të zënë krah për krah, togeri italian dhe kapobanda e Ballit çanë përmes turmës dhe vajtën në krye të detyrës. Dalipi, si zot shtëpie e kishte parë të arësyeshme të pinte më shumë nga togeri fashist.

Prandaj edhe këmbët atij po i merreshin më shumë! Veçse ishte bërë më i përzemërt, më i dashur me mysafirin.

Përpiqej të mos e tradhëtonin këmbët dhe kësaj ja dilte duke u mbajtur më fort pas togerit, i cili e merrte këtë shtrëngim si shprehje të dashurisë «me shikimin e parë».

— Ku drejtin do ta mbajmë këtë fjalim, xhanëm? Këtu nuk shikoj asnjë vend apostafat! — tha togeri.

— Po ja, që nga ballkoni, sinjor tenente — ju përgjegj Dalipi.

— Çfarë drej ballkoni, more?! Nuk e shikon se ai ballkon tundet e lëkundet si krah balone?! Apo mos keni qejf të bëheni kërmë!?

— Larg qoftë, kush e tha? Po ne atë palo ballkon kemi. Nuk do të qe keq ta kishim provuar një herë.

— Qysh? Ta provojmë? — Pyeti me padurim togeri.

— Po ja, të hipim më përpara një skuadër me xhandarë. Po qe se ballkoni nuk rrëzohet, të zbresin ata dhe të hipim ne të dy, që. . .

— Dëngëla, kapedan, dëngëla!

— Më lejoni, sinjor tenente? — Gjeti rastin të futej në valle kryetari i bashkisë. — Më lejoni ta zgjidh këtë si zot shtëpie që jam?

Dalipi i hodhi atij një shikim prej maçoku, kur një kone i afrohet atij t'i marrë thelën e mishit të kobuar.

— Pa hë, të të shohim nga do ja mbash! — I tha italiani.

— Po ja këtu në bashki, për nevoja të miletit, kemi një karro me dy kuaj dhe me dy rrota. Përse të mos hipni aty dhe të mbani fjalim?

— Ide e madhe, ide nazionale! Desha të thoshja në rang nacional! Avanti!

Pas pak karroca e bashkisë çau përpara dhe ndali në mes të turmës.


Togeri italian, kryetari i bashkisë dhe Dalipi, hipën lart. Për të mos i lënë rast tjetrit t'i hynte prapë në pjesë ai, kryetari i bashkisë, Dalipi e mori vetë fjalën.

— Mëmëdhetarë dhe nationalistë! Sot është një ditë e madhe për Shqipërinë dhe për Italinë bashkë. Se ne tani jemi bashkë. Jemi kështu pasi duhemi shumë!

— Si gjarpëri në gji! — Ja priti dikush nga populli. Kjo fjalë u pasua nga duartrokitje të gjata e zjarrta, të cilat togeri italian i mori tjetër për tjetër.

Ai pandehte se kështu po e ftonin të merrte fjalën.

— Kapedan Dalipi e tha me vend, sot është një ditë e madhe. . . Kjo është një ditë e madhe, pasi ka lindur një perandor të madh. . .



Kuajt, që nuk merrnin vesh asnjë fjalë italisht, tundnin bishtin, herë pas here për të larguar mizat. Se kuajt dhe perandorët, sado që ndryshojnë nga njëri-tjetrit, nuk i durojnë dot as mizat dhe as mushkonjat. (Sidomos kur mbahen fjalime patriotike. Kjo është vërtetuar në shekuj.)

Ndërsa togeri fliste mbarë e prapë me oratorinë e një të dehuri, Dalipi dhe kryetari luanin kokën në shenjë aprovimi. Në fakt, edhe dy kuajt, që nuk i luanin dot kokat nga freri, luanin bishtin, por kjo nuk mund të merrej si një shenjë aprovimi për meritat e perandorit italian.

— Ne, zotërinj, me tetë milion bajoneta në duar jemi një fuqi, një armë tepër glorioze...

— Këtë sapo e pamë edhe në frontin italo-grek — ndërhyri dikush nga turma. Italiani, i cili edhe këtë radhë gjallërinë e mori për aprovim, vazhdoi:

— Pra, ne jemi akoma vetëm në fillim, o shqiptarë të Shqipërisë!

— Dita e mirë duket që në sabah! — Ja priti njëri.

— Mua më duket se po flet Ali bej Këlcyra! -- I tha Dalipit kryetari i bashkisë.

— Prit ta dëgjojmë! — Ja ktheu ftohtë tjetri. Përballë karrocës dhe drejtpërdrejt saj po afrohej një fshatar, djalë i ri, hipur mbi një pelë çile. Karrocieri i bashkisë nga ana tjetër po ndukte lehtë frerët e kuajve të tij.

Sikur këto lëvizje të vogla të ishin parë me vigjilencën e kuesturës, mund të qenë marrë për të dyshimta. Po, në atë rrëmujë festive askujt nuk i shkoi mendja në të keqe. Aq më tepër ishte dita që kishte lindur perandori! Ç'e keqe mund të ndodhë ditën që ka lindur një perandor? Asgjë veç fatbar-

dhësisë. Bile, atë ditë mund të flerë edhe kuestura.

E, megjithatë, kuestura as atë ditë nuk po flinte. Por, që të merrej edhe me bishtat e kuajve, nuk i kishte shkuar ndër mend.

Papritur u ndie një hingëllimë lirike. Karroca, ku kishin hipur autoritetet e lavdishme, u lëkund dhe ja dha me të katra përpara. Kuajt nuk pyesnin për frerë. Ç'kishte ngjarë me ta?

Njërit nga kuajt, sapo dalloj nga larg pelën çile, ju turbullua mendja dhe sytë i vetëtitën. Ajo pelë diç i kujtonte nga rinia e parë, gjë që ja ndezi flakë pasionet.

U vërtetua me këtë rast se, «amore a prima vista» paska të bëjë edhe me kuajt. Sidomos, kur janë racë e kryqëzuar.

Populli shpërtheu në duartrokitje, brohori, vërshëllima!

Autoritetet, që po shtypeshin e paloseshin mbi njëri-tjetrin sipër karros, nuk arritën ta stabilizonin situatën, megjithëqë ishin autoritete!

Kuajt, që nuk përmbaheshin më, ja kishin marrë me të katra pas pelës çile, e cila tashmë u kishte kthyer bishtin e derdhur.

Kështu, ai qytet i vogël, për shkak të dashurisë së kafshëve me shkimin e parë, nuk pati fat t'i dëgjonte deri në fund meritat e panumërta të perandorit.

«BULETINI LUFTARAK I ÇETËS «VETËMOHIMI»»

Ne patriotët sypatrembur, të renditur në këtë çetë, nën udhëheqjen e shenjtë të baballarëve të kombit, jemi mobilizuar, pa rezervime, në luftën kundër qafirit që desh të na shkelte vatanin. Dyfekët tanë të larë me raki s'kanë lënë vend e vrimë pa shpuar. Ne s'kemi harruar kurrë se s'duhej të vononim, po të arrinim gjithmonë të parët, sidomos në ato vende «ku leh qen e ku del tym, ku ja bën daullja bym!»

Nganjëherë na është dashur të bëjmë dyfek edhe me stanet e barinjve, me njerëz të lanetisur. Por, siç thotë fjala «Kokë lashë, kokë mora», dhe ne s'kemi dalë asnjëherë pa një a dy desh më shumë nga ç'kemi lënë të vrarë prej plumbave të çobanërisë jezite. Vetëm gjatë këtyre dy javëve kemi shfarosur nga faqja e dheut mbi 60 pula shqerake, të cilat, po të kishin mbetur gjallë dhe po të kishin rënë në duart e qafirit, do të kishin bërë mbi 1500 vezë, të cilat, po të ishin shtruar, do të nxirrnin të paktën 1400 zogj, e një zot e di ku do të kishte përfunduar kjo llogari, sikur ne të mos i kishim dalë përpara këtij rreziku.

Kësisoj kemi kontribuar në pakësimin e rezervave ushqimore të armikut.

Në luftën për sigurimin e rezervave ushqimore janë shquar: 1) Pelivan Kadaifi, që mbajti në krahë një dash të majmë në dy fshatra 6 orë larg njëritjetrit. Hajrulla Musai, që na solli nga tri fshatra larg një vozë druri me 40 okë gjalpë, e të tjerë, plot trima me fletë që japin jetën për atdhe.

Kombi nuk ka si harron e s'mund të mos nderojë burra të shquar si Shefik Sheremeti i cili, për të mos rënë i gjallë në duart e partizanëve, u mbyll në një bodrum, ku e ka mbajtur xhanin një muaj plot vetëm me mish të pjekur e me ujë. I paharruar do të jetë heroizmi i Servet Pulastrenit i cili, gjatë lëngimit prej dy muajsh nga një plagë në shpinë gjatë sulmit mbi kotecët, s'ka vënë gjë tjetër në gojë veç petulla me mjaltë. Kësisoj po marshon ballëhapur njësia jonë mëmëdhetare drejt lirisë.

Ejani të gjithë nën parullën tonë: «Shqipëria e shqiptarëve — Vdekje e tradhëtarëve»!

Shtabi i Çetës «VETËMOHIMI»
24 e vjeshtës së tretë 1943

ATA QË VDIQËN NË NËNTOR

Në Botë vdesin shumë! Vdesin njerëz, ide, institucione, shtete. Por, Zyra e Shërbimeve Funerale të Historisë nuk ua del dot të gjitha vdekjeve.

Ata, për të cilët bën fjalë ky shkrim, vdiqën qysh në nëntor të vitit 1944, por disa ende nuk janë varrosur. Se, është tjetër gjë të vdesësh, dhe është tjetër gjë të varrosesh!

Këto nuk duhen ngatërruar! Disa e kanë më të lehtë të vdesin, se sa të varrosen! Dhe bash për dy monstra të tillë është fjala.

Dy vetë presin të pëlçasë!

— E dëgjove, Fadil efendi? U hodhën mbi Maliqin!

— Mos, more! I gjori kryeministër! Ç'ju desh atij politika?!

— E more jangllëç, jahu! Jo mbi Maliq Bushatin, po mbi kënetën e Maliqit.

— Ashtu, ë? E ç'do bëjnë aty, apo do zënë zhaba?

— Jo, po do e thajnë... Thonë ata, de!

— More, të madh oreks që kanë! Përse nuk i

shtrijnë këmbët sa ç'kanë jorganin? Le që ata s'kanë fare jorgan! Ku e gjetën? E ku e hanë dot ata me Maliqin?

— Ata ju futën.

— Por, do ngecin brenda. Apo nuk është baltovinë ajo kënetë. Edhe bualli nuk del dot që aty. Se për të futur është kollaj, xhanëm. Po, sa për të dalë, ngushtohet sa vërra e gjilpërës.

— Kështu llois edhe unë. Pastaj... pastaj... he, he, prite kur të pëlcasë! Inglitera nuk duron shumë. E di, unë e di! Ja, shiko Greqinë, ti. Edhe Amerika nuk do bëjë sehir. Ata kanë aq shumë bomba dhe balona, sa nuk dinë ç't'i bëjnë!

— Ashtu them edhe unë, efendi...

Si shumë po zgjaten!

— E more vesh, Harun aga? Kërkojnë të zgjaten. Ha, ha, ha, duan të... zgjaten! Thonë se po fillojnë një ferrovijë andej nga Durrësi. A nuk është për të qeshur?

— Ferrovijë? Kanë hak, se nuk e dinë që e ka marrë ferra uratën. Këtu, jahu, edhe Maliqi do të thahet, edhe ferrovija do të ndërtohet.

Por... jo nga komunistët, jo... Ata nuk dinë të bëjnë një kotec, e jo një ferrovijë. Inglitera me ti. I kanë ferrovijat ata, dinë të bëjnë punë. Dëgjo mua,

— Megjithatë, si shumë po zgjaten, aga. Aleatët duhej të kishin zbarkuar. Ç'dreq po bëjnë?

— Mos u sëkëlldis, Fadil efendi, mos u sëkëlldis! Punët e mira bëhen dalëngadalë. Ata duan të zbarcojnë me një rrugë sa më demokratike.

— Ashtu qoftë, xhanëm, nuk them se jo!

As këtë radhë!

— Kjo qe dorë e fortë, efendi!

— Zaten këta vetëm duart kanë!

— Sidoqoftë, deputetët na lanë shëndetin. Ata
çoç mund të bënin. Se ishin të gjithë burra të mirë.
Dhe nga diplomacia kishin haber.

— Doemos, doemos. Diç mund të bënin, po nuk
u eci. Çokush i ka spiunuar. I ka marrë më qafë,
që e marrtë pas qafe, e marrtë!

— Ashtu them edhe unë. Ama, vetëm mos plastë,
se do të lozë mirë qeni i kallajxhiut.

— Qeni të zotin nuk do ta marrë vesh!

— Për allah, qeni i kallajxhiut do të lozë!

* * *

— Thonë se nisën një kombinat pëlhurash.

— Kanë hak, se mbetën lakuriq. Por më vjen
keq se do t'u mbetet në themele. Këta dashkan të
ngrenë kombinat! Pa përfillur fare Ingliterën! Këta
që nuk dinë nga kapet mushka! Zaten, nga axha-
minjtë çdo gjë duhet të presësh.

— Sidoqoftë, nga idetë nuk janë edhe aq zba-
thur, efendi. Filluan me kënetën e parë, me ferro-
vijën e parë, me kombinatin e parë...

— Po ç'e do se do t'u mbeten përjetë të parat,
të parat, të parat...

Nuk do të ketë të dyta, nuk do të ketë të treta.

As të katërta nuk do të ketë. As të pesta!

— Jo, se e dyta do të jetë të plasurit, xhanëm!

— Po, të plasurit, po! Veçse si shumë po vonohet. Mos ja kanë shtruar me kumar ata inglezët dhe na kanë harruar fare? Apo mos i ka marrë baruti ujë Inglihterës?

— Ku ta dish, ajo në mes të ujit është, si bretkosa!

— Po prapë mua nuk ma ha mendja. Për të plasur do të plasë.

— Ashtu them edhe unë. Do plasë që ç'ke me të!

Më në fund plasi!

Fadil efendiu priste mikun e tij në kafe, «Kursal». Kishin dhjetë ditë pa u pjekur. Dhe prapë miku i tij nuk po dukej gjëkund.

Duhej të shoshitnin gjithë ato gjëra. Kur do të pëlciste... si, qysh?

Më në fund, meqë Harun agai nuk po dukej gjëkund, Fadil efendiu kapi bastunin dhe u çapit drejt shtëpisë së mikut.

Te shkallët e shtëpisë së Harunit, ai takoi një tjetër mik të lashtë që po fshinte sytë me shami.

— Plasi! I gjori ai, plasi më në fund...

— Plasi? — pyeti me ngazëllim Fadil efendiu. Dhe ti po qan nga gëzimi me sa duket. Se dhe ai këtë ditë kishte pritur.

— Ç'kishte pritur, mor mavri, ç'kishte pritur? Tjetrit i plasi zemra, kurse ti... Që burrë i mirë, rahmet pastë...

— Aaaa...

* * *

Ai plasi, se nuk kishte si të mos pëlciste. Se ai, bashkë me shokët e tij nuk mund të duronin më! Dhe plasi... Dhe bëri mirë që plasi... Se më shumë do të torturohej...

Dhe përditë dikush do të pëlciste... Se nuk mund të duronin.

Dhe ende nuk janë varrosur të gjithë. Se për të plasur, plasën shumë!

Megjithëse përditë e më tepër po u priten leqet, ata prapë presin e shpresojnë të pëlcasë.

Dhe nuk vonon e pëlcasin vetë... një nga një...

Ç'ESHTË DASHURIA?

Të them të drejtën, unë nuk e di ç'është dashuria! Jo vetëm sepse s'kam dashuruar ndonjëherë gjer më sot, por edhe sepse njerëz të ndryshëm më flasin krejt ndryshe për dashurinë.

Disa më thoshnin se kjo gjë do të sqarohet, kur unë të arrija në moshën e dashurisë. Por e keqja ishte se ata nuk binin dakord se kur fillonte dhe kur mbaronte kjo moshë. Kështu që çështja u ngatërrua edhe më tepër.

Së pari duhej sqaruar: ç'është dashuria? Së dyti: cila është moshja e dashurisë? Pra, në fillim unë kisha vetëm një pyetje, tani u bënë dy! Me sa dukej, sa më thellë ta ngisje këtë temë, aq më shumë pyetje e pikëpyetje do të dilnin. Prandaj unë nuk desha të pyesja më tej nga frika se mos ekuacioni i dashurisë bëhej kështu me shumë të panjohura.

Pashë edhe disa filma mbi dashurinë, por ata shumë pak më sqaruan për sa kërkoja. Edhe filmi «Në moshën e dashurisë» ishte më tepër një koncert vokal se sa film. Po ashtu nuk arritën të më sqarounin as librat e shkruar për dashurinë. Bile ata më ngatërruan edhe më keq.

Sipas tyre paskej dashuri të parë, të dytë e deri të dashuria e fundit. A nuk i ngjan kjo një porosie

në restorantin popullor? Ç'i ngatërrojnë pra dashuritë me restorantet?!

Sa për fqinjët e mi, disa thonë se dashuria është mirëkuptim, të tjerët: grindje e përditshme, zënka, shamata. Me një fjalë për dashurinë mund të flasësh lirisht, pa doganë, dhe prapë je brenda.

Se qenka edhe ashtu edhe kështu. Si shtëpia e Nastradinit! Por mua nuk më ndodhi as ashtu e as kështu.

Isha duke konspektuar diçka nga një manual teknik mbi tornon, kur papritur dera u hap me vrull dhe brenda hyri Vasiu, burri i tezes sime.

— Oho, keçja e xhaxhait! Po ku je, moj bijë, si je?

— Mirë, falemi nderit, xha Vasi— ju përgjegja unë disi e hutuar, pasi vizita e tij ishte jashtë radhe.

— Mirë, ë? — Dhe toni i tij ndryshoi papritur si shiu i korrikut.

— Po, gëzohem që je mirë, se ashtu duhet të jesh dhe se neve ashtu na e do zemra. Por, sidoqoftë, mos harro diçka. Ti ke më të mëdhenj mbi krye. Këta kanë detyrime karshi teje. Të dhanë zanat, edhe shkollë po të japin. Dalëngadalë do të thuash, po kush tha se punët e mira nuk bëhen dalëngadalë? Megjithatë, detyrimet tona ndaj teje dhe përgjithësisht ndaj brezit të ri nuk mbarojnë me kaq. Sidomos kur është fjala për të gjetur shokun e jetës.

Nuk them xhanëm që të mos njiheni, apo meazallah, të mos dashuroheni, veçse këto gjëra, si njëra si tjetra, nuk duhen kryer pa dijeninë tonë dhe përpara ceremonive familjare. Pastaj, ne më përpara duhej të dinim diçka në këtë mes: nga është djali, me se merret, ka apo nuk ka diplomë, punon në Tiranë apo jashtë saj? Mos vallë është ndonjë person

i pazëvendësueshëm? Se edhe kjo ka rëndësinë e vet.

— Khaxhi Vasi, më falni, po unë nuk e di se...

— Eee, e kuptoj xhanëm, mosha jote, drojtja jote... ashtu duhet bërë, sikur s'di gjë. Por, sidoqoftë, një ditë para se të jetë vonë, ne, njerëzit e tu, diçka duhet të dimë. Bile nuk ke bërë aspak mirë që e ke pleksur pa dijeninë tonë. Se edhe ne mbajmë përgjegjësi.

— Po unë nuk di të kem pleksur gjë, mor xhaxhi Vasi!

— E, de, e kuptoj. Ashtu kam thënë edhe unë, kur u kapa me presh në duar para 30 vjetësh. Sidoqoftë kungulli gjithnjë del mbi ujë. Ti je nga një familje e nderuar, mikpritëse, me tradita dhe kulturë. Ndaj nuk të ka hije të veprosh kështu. Ne nuk themi të jesh e nënshtuar, xhanëm, se ne nuk jemi konservatorë. Por sidoqoftë edhe kaq liberalizëm për kushtet konkrete aktuale nuk bën. Besoj se do më kuptosh, bija ime dhe se nuk do na hapësh më telashe — përfundoi ai duke u larguar ashtu siç hyri (pa kërkuar pëlqimin tim).

Pra ai besonte se... por unë nuk mund të bëja gjë për të vënë në vend besimin e tij. Se unë ende nuk dija ku rrihte çekani. Ose më mirë të them, që çekani rrihte mbi kokën time, meqë isha bijë e një familje të kulturuar, po se përse rrihte konkretisht ky çekan, unë s'e merrja dot me mend.

Në këto e sipër nga dera që kishte mbetur e hapur u fut në dhomë im atë. Nga pamja ai dukej sikur ishte një vazhdim i xha Vasit, megjithëse nuk kishin lidhje gjaku e gjirie.

— Hë, gjidi mavije, nën hundën time, ë? Mos përfiton vallë nga butësia ime? Apo mos pandeh se, meqë ke një baba të kulturuar, mund të bësh si të

duash? Apo të thotë koka se ky qenka emancipimi?
Hë, de, përgjigjmu!

— Babi, më falni, po unë nuk di gjë.

— Po e di unë në s'e di ti! Pse, ç'pandeh ti, mos ha bar unë? Apo pandeh se e kam kullotur çairen?

— Babi, po sqaromëni njëherë, çfarë kam bërë unë?

— Aha, dashke sqarime... në vend që të na sqarosh ti vetë! Dëgjo, mos pandeh se, meqë yt atë ka njëfarë kulture, njëfarë diplome dhe njëfarë posti, ti duhet të jesh pararoja e liberalizmit? Mos harro se në dejet e mi, në gjakun tim nuk ka ndikuar as kultura, as diploma, as posti! Ky gjak është po aq i pastër, sa ç'ka qenë edhe 300 vjet më parë! — Dhe ai doli duke e tërhequr derën me aq forcë, saqë xhamet kërcitën dhe u dridhën për një copë herë.

Ndoshta edhe unë duhej të dridhesha një copë herë! Mirë; po si mund të dridhesh, kur nuk di se përse duhet bërë kjo? Edhe në gjyq, para se të dënohesh, të parashtrohet dhe të vërtetohet akuza.

Kurse mua po më dënonin jashtë çdo procedure juridike.

Nëna dukej edhe më e shqetësuar. Kjo ndikoi edhe tek unë, pasi me të gjithmonë jam kuptuar më lehtë. Mos vallë me të vërtetë kam bërë ndonjë gjë që s'e di as unë?

Ajo ma mori kokën në duar dhe, me një ton të përzier midis gjykimit dhe përkëdheljes, më tha:

— Po pse, moj nanë, s'ma pate kallëzue me vakt? A thue edhe mue do më mbajsh sekrete? Po ti, moj nanë, deri tash s'më ke mbajtë gja!

Si ban vaki kjo? Unë ta marr vesh nga bota? Jo, moj nanë, këtë nuk ma merrte mendja! Unë u mburrsha me ty. Të kishte nana si djalë. Po ja, djali

i nanës doli gocë! Pse, pse kështu, moj nanë?

— Moj mami, po aman, se më plasët, tregomëni, ç'kam bërë unë e shkreta — ngula këmbë unë gati e përlotur.

— Po ç'do bash ma tepër, moj nanë? Mos don të na venë teneqen, a? Të të përcjellë i biri i botës në orën dhjetë deri te shkallët, pesë orë pasi ka hy dielli dhe tri orë pasi baba ta ka ndaluar vonesën, a nuk asht turp ky? Dhe te shkallët keni ndejtë plot një çerek sahati!

Përse kështu, moj nanë, nuk patët tjetër vend me u sqarue?

— Po ti, moj mami, e di se ka edhe vende të tjera, po ne nuk kishim punë të atilla, ne...

— Po pra, ju, ju, moj nanë, para se ta pleksnit, të më pyesje njëherë! Mund të ta ktheja një llaf me mend, se hala s'më kanë rrjedhë.

— Moj mami, po ne s'e kemi pleksur ende.

— Qyqja, moj gocë! Po pse, kur dashke të më kallëzosh ti, kur të blesh karrocën e fëmijës, a?

— Jo, moj mami, po ne akoma nuk kemi biseduar gjë. Ne jemi shokë të mirë. Vetëm kaq!

— Shokë, thotë! Çfarë shokësh, moj gocë, të lesh bashkë flakën dhe benzinën!?

— Po dale, moj mami se... — dhe fjala m'u zu në grykë... Se në të vërtetë këtu nuk qe fjala as për flakë, as për benzinë dhe as për zjarrfikësat që ishin alarmuar gjer në këtë shkallë.

Ne ende nuk kishim vendosur në duhej të flisnim për dashurinë, apo jo. Ai kishte vetëm dy javë që punonte në uzinën tonë. Ai, me sa kuptoja unë, matej të më fliste edhe për dashurinë. Po ja që të

tjerët u ndodhën më të shkathët dhe ja morën fjalën nga goja!

Dhe këtë ngjarje e hodha në letër me kaq besnikëri, duke shpresuar sadopak se mund të sqarohet diçka nga pyetja: ç'është dashuria?

NJË ME NJË

Ndokush do të pandehë se këtu është fjala për ndonjë ndeshje futbollit, meqë unë dikur jam marrë me këtë lloj sporti. Por unë e lashë futbollin po atë ditë që lashë edhe cigaren, domethënë, sapo u martova, siç kanë vepruar edhe disa nga shokët e mi.

Këtu fjala është për një fejtton, të cilin shefi ma besoi mua meqë isha i ri në detyrë dhe duhej t'ja merrja dorën punës një orë e më parë.

Unë, saherë që marr një detyrë nga shefi, e ndjej të udhës të futem aty për aty në mendime të thella që të mund të dal sa më faqebardhë. Se nganjëherë mendimet e thella s'të lënë në baltë.

Duhej të shkruaja një fejtton mbi ngurimin dhe formalizmin në çështjen e ngritjes së shoqeve në përgjegjësi.

E prita me gëzim këtë detyrë, nuk di pse, po ja që më bëhej qejfi kur në përgjegjësi gjej sa më shumë gra. U nisa me dëshirën, që sa më parë të bëja fejtonin.

Hyra në një uzinë. Drejtorin nuk e gjeta aty. Kjo më dëshpëroi dhe më bëri të mendoja se diçka nuk do më shkonte mbarë. Edhe kryeinxhinieri diku kishte vajtur me shërbim.

Atëherë, desha s'desha, u futà te shefja e kuadrit. Them, desha s'desha, se për një fejtton të tillë nuk duhej të shqetësoja një shoqe.

Po ç'të bësh, kur nuk ke nga ja mban! Disa nuk arrijnë ta kuptojnë kaq gjë dhe ta marrin për të keq pastaj.

— Ne në përgjithësi kemi punuar mirë për ngritjen e shoqeve dhe të të rejave në përgjegjësi të ndryshme — kështu ja filloi shefja e kuadrit, ndërsa unë hapa blokun e shënimeve.

— Disa rezultate i kemi arritur që tani, por mendojmë se kemi ende për të bërë. Natyrisht, ne mund të bënim më shumë, por, ju e kuptoni... pikëpamjet subjektive nga njëra anë dhe ngurimi i shoqeve nga ana...

— Më falni, por unë dua të di konkretisht, sa shoqe janë ngritur në përgjegjësi dhe si po e kryejnë ato detyrën? — e ndërpreva unë nga frika se mos më linte aty treni i mbrëmjes dhe i fundit që nisej për në shtëpinë time.

— Po, ja, t'i marrim me radhë. Një sapa u emërua nëndrejtoreshë, katër brigadiere dhe gjashtë zëvendësbrigadiere, një kryetare e komitetit profesional të uzinës, tri, po kryetare nëpër reparte, një përgjegjëse administrate, dy drejtuese të rrethëve artistike, një kryetare e kryqit të kuq të uzinës, dy shefe teknike, një shefe prodhimi, tri teknologe, një përgjegjëse gruaje me dy zëvendëset e saj, katër i kemi dërguar në kampin e pushimit, ndërsa gjashtë të tjera do të shkojnë në turnin që vjen. Veç kësaj...

— Më falni — e ndërpreva unë këtë herë, se nuk desha ta haja sapunin për djathë. — Ju më numruat kështu tridhjetë e shtatë shoqe. Mirë, po, me sa di unë, në uzinën tuaj keni gjithsejt 26 shoqe.

Si ka mundësi, që nga 26 shoqe gjithsejt, 37 u ngrëkan në përgjegjësi? Mos vallë, padashur keni shtuar gjë? — e pyeta unë i sigurtë se fejtoni doli i gatshëm si një hashure taze.

Ja kështu bëhen punët. Ti vret mendjen gjatë gjithë rrugës se si do t'ja dalësh në krye me faqe të bardhë, kurse tjetri, sikur ta ketë për detyrë të zbardhë faqen tënde, vete e ta jep fejtonin të gatshëm në dorë.

— Ju nuk e keni gabim — ma ktheu ajo.

— Ne vërtet 26 shoqe kemi gjithsejt, por puna qëndron kështu: Meqë shoqet duhet të ngrihen sa më shumë në përgjegjësi, e kemi parë të arsyeshme që, një shoqe ta ngremë në dy apo tri përgjegjësi. Kështu, nëndrejtoresha është njëkohësisht edhe kryetare e komitetit profesional edhe përgjegjëse e gruas. Po ashtu, njëra nga brigadieret është edhe nënkryetare e komitetit profesional, por u numrua edhe si e dërguar në kampin e pushimit, gjë që është plotësisht e vërtetë. Po deshët e verifikoni.

— Jo, nuk ka nevojë. As për këtë dhe as për të tjerat. Po ju, shoqe, a e kuptoni, a jeni e ndërgegjeshme se këtu ka formalizëm? Se kështu nuk ecet? Se kjo praktikë është në dëm të çështjes? Se ne duhet të bëjmë një punë djersitëse për këtë problem?

— Po, shok, ne e kuptojmë. Gabim e kemi dhe gabime, me sa di unë, bëhen kudo ku punojmë. Por me kohë edhe ne do t'i ndreqim këto gabime.

Se në fund të fundit, këto gabime janë bërë nga vullneti ynë i mirë për të ngritur sa më shumë shoqe në përgjegjësi.

Po a ka formalizëm në këtë mes, do të thoni ju. Ka, si nuk ka. Edhe ne e kuptojmë këtë gjë. Po ja, ndihma e shokëve, e ekipeve nga lart, shokët që

vijnë këtu me eksperiencën e tyre, përditë e më shumë na japin dorën.

— Kjo është tjetër gjë. Po ju, vetë, me forcat tuaja, me mundësitë tuaja, a e kuptoni se kështu nuk ecet?

— Si nuk e kuptojmë! Kjo duket sheshit. Po ja, meqë ra fjala dhe meqë ju jeni këtu, a mund të na ndihmoni diçka me eksperiencën tuaj? A mund të na tregoni diçka nga eksperiencia juaj për ngritjen e shoqeve në përgjegjësi aty në redaksinë tuaj?

Të themi të drejtën, kjo pyetje më ka kapur po aq në befasi, sa ç'më ka kapur dikur edhe pedagogu i matematikës, kur më ktheu për në shtator. Por detyra ime ma donte të mos e humbisja pusullën. Po ashtu detyra ma donte të mos humbisja as materialin e fejtimit. Megjithatë, isha mbërthyer keq. Nuk kisha nga t'ja mbaja. Të gënjeja, këtë nuk ma lejonte as shefi dhe as ndërgjegjja ime.

— Ne, shoqe, duhet ta dini, se... ne punojmë në kushte të tjera. I thonë redaksi asaj, jo shërbim, jo zona të largëta, këtu ka, si të thuash pengesa objektive për femrat...

— Kjo varet si ta kuptosh. Unë sa për eksperiencë ju pyeta. Më falni, në qoftë se ju preka në sedër! Vetëm se desha të dija diçka edhe nga puna juaj në këtë drejtim, asgjë më tepër. Po edhe këtë, në rast se do të keni mundësi, të kuptohemi.

— Oh, ne kuptohemi që ç'ke me të. Por puna është se, për arësyet që rendita më lart dhe siç kuptohet nga ato arësye, në redaksinë tonë nuk kemi asnjë shoqe.

— Sidoqoftë edhe kështu nuk lejohet. Edhe këtu ka vend për formalizëm. Pse të mendoni kështu?.. Pse të... .

Ajo kishte të drejtë. Kaq gjë po e kuptoja edhe vetë. Pavarësisht se nuk qe faji im personal që në redaksinë tonë nuk kishte asnjë femër, unë fillova të skuqesha.

E kuptova se takimi përfundoi një me një dhe se fejtoni im përfundoi në një autofejton.

KUSHËRIRAT E GJYSHES

22 korrik

— Dëgjo, pëllumbi i gjyshes! I vogël nuk je më. Tani duhet të martohesh. Gjella me kripë, kripa me karar. Të gjithë u martuan, vetëm ti nuk dëgjon. Eh, si erdhën kështu kohët! Gjyshi yt, ndjesë pastë, mori tri gra. Ti asnjë. Kushedi se ç'mendojnë bota!

Unë e dëgjoja gjyshen me vëmendje dhe hera herës vija buzën në gaz. Qeshja jo për tjetër gjë, por vetëm se kisha vënë re që, kur unë vija buzën në gaz, po kjo gjë ngjiste edhe me gjyshen. Dhe dihet që gazi e zbut bisedën. Sidomos kur ajo ka rrezikshmëri... Po kur vallë kanë rrezikuar gjyshet tona të dashura?

21 janar

— Gjyshe, keni të drejtë. Unë, më në fund vendosa ta shkrep. Por dua të marr edhe pëlqimin tuaj. Më keni përkundur që kur linda. Jo pse unë ngulja këmbë për këtë, ju e bënit vullnetarisht. Edhe tani, bile, dashamirësia juaj më ngjan me një nishan. Prandaj dua t'ju pyes së pari ju. Vajzën e Nedretit, ju e njihni mirë, sepse edhe Nedretin e njihni mirë.

Papritur gjyshja u step dhe filloi të zbehej. Kjo më shqetësoi pasi ajo vuan edhe nga tensioni. Sakaj, vrapova dhe i mbusha një gotë ujë. Por nuk qe nevoja. Megjithatë, për çdo rast, ujin e piva vetë.

— Ç'thua ashtu, o prokopia e gjyshes? Mos kërkon të na vërë teneqenë bota?

— Pse kështu, moj gjyshe?

— Sepse jemi farefis, more derëmirë!

— Farefis? Që nga kështu? Unë nuk di gjë!

— Po ku dini gjë ju të rinjtë! Ju vetëm për dashuri dini. Dhe nuk njihni as farefisin tuaj. I ndjeri gjyshë i Nedretit me atin tim ishin kushërinj. Kushërinj të shtatë me sa mbaj mend. I ati i Nedretit me mua bie po kushëri, ti e kupton. Vetë Nedreti me tët atë a nuk është po ai fis. Ti me të bijën je gjithashtu po ai fis. Fisi ynë i madh i sakajve jemi bërë shtatë copë fshatra, dhe asnjë kru-shqi nuk kemi lidhur deri tani me njëri-tjetrin.

12 shkurt

Unë nuk desha që gjyshja ta hapte më muhabetin e martesës sime. Jo pse nuk desha të martohesha (përse të mos jem i singertë), porse kjo nuk qe aq e lehtë. Unë e di kokën e gjyshes. Sepse edhe ajo e di kokën time. Ndaj në vegjëli gjithnjë betohesha për kokën e saj. Këtë e bëja edhe në shënjë respekti, edhe për reciprocitet. Gjyshja, gjithashtu, betohej për kokën time, megjithëse kishte 6 djem e 5 vajza. Kështu që unë dija edhe zemrën e gjyshes.

— Ti thua, o vajzën e Nedretit, o s'ka tjetër!

— më ngacmoi gjyshja, ngacmim që unë tashmë e prisja. — Ti e dashuron atë?

— Unë nuk e dashuroj atë dhe as ajo nuk më dashuron mua!

— Epo ç'më kërkon më, o lanet, se më ngrive gjakun! Unë thashë se mos qe trashur aq shumë brumi sa do të zinte! — tha gjyshja tepër e lehtësuar.

— Po ne, moj gjyshe, sapo kemi filluar. Kemi simpati për njëri-tjetrin! Dhe mendojmë që edhe dashuria do të vijë më pas. Ajo i ka sytë në ngjyrë të detit.

— Lumë e det kjo puna jote, mor nipçe! T'i kisha patur kështu të gjithë nipërit dhe mbesat, do të kisha vajtur me kohë në teknefes.

— Po pse atëhere betoheshe për kokën time?

— Sepse pandehja që çoç do të bëheshe!

— Dhe nuk u bëra gjë?

— More për të bërë u bëre goxha, po ç'e do! Je keq nga buka! Gruaja e mbledh burrin. Se burri pa grua është si kali pa kapistër. Po me atë të bijën e Nedretit mos e zgjat, të keqen gjyshja! Do të na turpërosh faqe botës. Sa për mua, e di mirë që do të thonë: «Po ajo gomarja plakë të bukur sehir që bëri»!

— Moj gjyshe, po me një farefis që zë shtatë fshatra është qesharake të mos bëhet krushqi.

— Ehuha, prapë me shakara ja kthen ti gjyshes! Shtatë fshatra vërtet, po ama, janë fshatra namuzi. Kemi nderë grurët bashkë! Një ujë pimë... një diell na ngroh...

— Më duket, o nipçe, se ti do të mbetesh si Zenua i Hykos. Do të të shpojë shkopi dorën, do të të shpojë! Zaten, kur mëson shumë, kështu katan-disesh. Se gruaja nuk do tru të tilla.

— Po çfarë truri do gruaja, moj gjyshe?

— Nga ato që, kur të të vijnë ty, nuk do t'i hanë më as qentë e mëhallës! Eh, pikë në zemër do të më mbetet ky fati yt, o nipçe! More si shumë tatëpjetë nga kashta e librave!

1 prill

— Ç'mendohesh, o gjyshe! Gjysma e mijës dihet!

— Ç'të mos mendohem, o malli i gjyshe! Gjyshja të gjitha i di, po këtë mendjen tënde nuk e merr dot vesh, edhe pse veshët akoma s'më kanë lënë...

— Oho, mendja ime dihet! Unë do të ha rru-gët. Vetëm se do t'i ha me gjithë trotuare, sado që nuk e honeps dot. Do të më shpojë shkopi dorën. Si Zenua i Hykos! Gjyshe, moj, unë jam axhami, ndaj mos ma verë veshin, se dhe veshët më janë rri-tur ca si tepër, moj gjyshe!

— Lëri shakatë, o i pagjarpë, se unë e kam me gjithë mend. Të kam gjetur një deli vajzë. Ti xha-nëm nuk e meriton atë, po ç'të bëj unë që të kam nip.

— E cila qenka kjo deli vajzë?

— Si mënjollë. Me rrogë, me zanat, me prokopi.

— Po cila është, de?

— Nga der' e mirë. Me terbiet. Pastaj, ç'nuk i zë dora.

— Unë të pyeta për emrin, moj gjyshe, dhe jo për duart.

— Ajo i thotë hënës: o dil, o të dal.

— Po emrin, Hënë e ka?

— Është një mbesa e Nedretit.

— Si? Po nuk më bie farefis? — pyeta gjyshen me habi gati fëminore.



— Çfarë farefisi, mor karafil? Ajo e ka mbesë nga i shoqi. Është vajza e të kumatit. Po vajzë, ama! Një herë ta shikosh dhe të ngrijnë sytë!

— Ashtu, xhanëm, po nuk bie kushërirë e parë me të bijën e Nedretit?

— Po pastaj?

— Si? Po unë nuk kam se si të marr kushërirën e farefisit tim. Do na qeshin bota, moj gjyshe! Për mua mbase nuk do të thonë gjë. E shumta, do të thonë: i rroftë shkolla! Po sa për ju...

— Eh, me këto mend që më ke ti, do të marrësh gjishtin në gojë.

— Jo, po dale, moj gjyshe. Ta bëjmë hesap mirë këtë punë, se mos dalim eksiq pastaj. Ajo është kushërira e kushërirës sime... jemi ngrohur nën një diell, apo jo?

— Eh, nipçe, nipçe, kush t'i psonisi ato tru!?

14 prill

Gjyshja u përpoq që disa ditë të hiqej qejfmbe-tur me mua. Kjo më prekte, sepse përpjekjet e saj ishin të sinqerta. Dhe niseshin nga një qëllim fis-nik. Por gjysheve tona nuk u kanë ecur role si kë-to. Nuk dihet pse atyre u shkon lehtë inati.

Nga një bisedë që pata me nënën time, mësova diçka tepër interesante për gjyshen.

Interesante dhe të nevojshme. Ndoshta do të qe më mirë sikur këtë gjë ta kisha mësuar më për-para, po me sa dukej nuk i kishte ardhur radha...

— Ti kështu ngul këmbë për të bijën e Nedretit?

— Po, gjyshe.

— Po e ke farefis, mor ditëgjatë, e ke tënden!

— Unë timen e kam, xhanëm!

— Po nuk bën, more, nuk bën! Të merr vesh koka, apo jo? Pse, u shuan vajzat dhe s'mbeti këmbë që, o atë, o s'ka?

— Unë nuk e kam fjalën për këmbët. . .

— Po, se ti e ke nga koka! Të rroftë shkolla!

— Moj gjyshe, dua të të bëj një pyetje, po a ma jep fjalën e nderit se nuk do të ma fshehësh të vërtetën?

— Uuu. . . llaf është ky? Kur ta ka bërë këtë gjyshja!?

— Mirë! Tani dua të di, ju vetë me të ndjerin gjysh, a nuk ishit farefis?

— Po kush ta ka thënë këtë, o firaun?

— Moj po lëre kush ma ka thënë. Unë dua të di: është kështu?

— Eh, shejtani vetë je ti! Nuk do të mbetesh fare rrugëve, jo! As si Zenua i Hykos nuk do të mbetesh. Por mos harro ama, se me tët gjysh kjo u bë hatajetë. . . Qemë fis i madh, mor nipçe. Kush i dinte të gjitha degët?

— Aha, lëre, gjyshe dhe mos e nga më tej! Edhe tani fis i madh jemi. Dy herë më i madh se atëhere. As unë nuk i dija këto degë.

Dhe dalëngadalë gjyshja filloi të më lëshonte pe, derisa unë u kapa me të dyja duart pas degës sime. . .

OKË E KOKË

Urtë e butë e plot tiganin! Doemos, njerëzit me mend në kokë kështu duhet t'i rregullojnë hesapet. Një njeri i tillë me mend në kokë është edhe Tuni Dora. Ai e kishte fejuar me mblesëri bijën e tij, Tushin, me një dhëndërr të psonisur andej nga Thana. I psonisur nga ana e dajës së vajzës. Dhe Tuni priste nga dita në ditë krushqit që ta mbyllte këtë mesele dhe për të hapur ndonjë damixhan me raki. Se edhe rakia nga durimi kishte nisë të avullohej.

I priste krushqit Tuni, jo pse e kishte zënë meraku për ta, gjë që edhe mund të ndodhte në rrethana të tjera, porse ditët sa vinin e bëheshin më me zarar. Qënë prishur shumë fejesa të këtij kallëpi. Me rininë nuk bëhej shaka. Ja, një e dy e mund të të çatisin brenda në shtëpi e të të thonë: «Përse, mor shoku Tuni, përse vepron si anadollak? Përse ke thyer vendimet e kuvendit të pleqve?

Dhe hajde pastaj, të kam rixha, hajde e jepu xhevap! Ta zënë fjalën në grykë këta të rinjtë, or babam. Janë pëllëmbë e barut këta...

Parandjenja nuk e kishte gënjyer Tuni Dorën. Për të prishur fejesën e kurdisur të së bijës, nuk u ngrit më këmbë vetëm organizata e rinisë, por edhe

vetë e bija, Tushi. Jo vetëm e bija, por edhe organizata e frontit.

Tuni i ndjeu shpatullat pas murit prej guri!

— Avashni, bre burra! Kurajo, bre! Kush tha të mos e prishim këtë fejesë? Pse, ç'më bëtë mua ju? Fanatik? Bah! Lipsur qofshin mblesëritë! Ja ku e prishëm! Mos e merrni kështu me kaq yrysh. Epo, ja që jemi një çikë të vjetër de, një çikë gërxho, siç i thonë. Epo, ç't'i bësh, de? Gërxho jemi ne. Nuk na këmbeni dot, se s'ka kush na merr.

Po prapë bijat tona i duam. I duam se janë tonat. Përse të mos i duam? Vetë i kemi bërë, nuk na lidhi njeri! Kemi mbeturina, domosdo që kemi.

Jemi njerëz, apo çfarë jemi? Dhe, në qoftë se jemi njerëz, a mund të mos kemi mbeturina?

Kështu e hodhi lumin Tuni i zgjuar. Pastaj, bashkë me të shoqen filluan ta shoshitnin, jo trahana, por këtë bela të re në shtëpinë e tyre të vjetër.


Thirrën në ndihmë edhe dajën e vajzës, Iso Qokën tri katunde larg. I duhej dhënë rrugë kësaj ngatërrese!

Dhe Isua, si njeri i shtëpisë dhe i hallit, i gjeti rrugë shtegut të mbyllur. Thirri të mbesën, Tushin dhe i tha:

— Do të vish me mua në shtëpi, pasi të ka ardhur nga ushtria daja i vogël dhe kërkon të takohet. E ka marrë malli shumë, lanetin. Kështu i merr malli ushtarët.

Tushi, pa dyshuar për asgjë në fjalët e dajës, u nis me të.

Iso Qoka kishte të drejtë të interesohej për mosprishjen e kësaj krushqie. Jo vetëm si daja i vajzës po edhe si kunati i dhëndrrit.



Ja se si pleksen punët nganjëherë. Në një mënyrë që nuk bën të shpleksen, pavarësisht se si e bie rasti. Isua kishte marrë motrën e dhëndrrit, përse, pra, të mos i jepte vajzën e motrës? Okë e kokë, siç i thonë! Edhe miqësia forcohej dyfish, edhe mbesës i jepte duart tutje, përpara se të bënte ndonjë proçkë atje me rininë, a ku di unë! Pra, okë e kokë! Po për këto okë dhe për këto koka kanë dalë feste të reja! Dhe këtë fakt e harroi Isua!

Sa shkeli vajza në shtëpi të dajës, ndodhi një çudi: në vend që ta prisnin si zakonisht me petulla, e veshën nuse, e hipën në kalë dhe drejt e në gjendjen civile të fshatit të bashkuar, ku prisnin edhe krushqit me dhëndrrin në mes.

— Hëëë, deshe të na turpëroje xhizin, ti, gjidi firaune! — I hakërrohej rrugës dajo Isua asaj. — Deshe ta bëje allafirënga, ëëë?!

«Ja se si bëhen punët e mira, urtë e butë e plot damixhanin!» — mendonte me vete dajo Isua. Kur-se së mbesës:

— Po pse, moj cipëplatur, ta thotë mendja se do të gjesh burrë më të mirë nga ai që të ka gjetur daja ty? Apo pandeh se unë nuk ta dua të mirën? Apo pandeh se unë nuk di t'i zgjedh burrat?

Po ti, moj shejtane, kur mësove të zgjedhësh burra, që nuk të hyn më në sy dhëndrri? Hë, de, folë, përse më skuqe me pahir?

Gjer këtu Isua e kishte kurdisur punën si sahat. Për këtu sahati i tij rroskop ngeci.

Nëpunësja e gjendjes civile e pyeti dhëndrrin

— A e doni ju, Tushin për grua?

— Po! — Arriti të shqiptonte ai si me fodullëk.

— Po ju? — Ju drejtua Tushit nëpunësja.

— Unë nuk e dua!

— Si!?

— Po, nuk e dua. Jo vetëm kaq por, meqë jam në zyrat e pushtetit popullor, i drejtohem për ndihmë pushtetit që të më heqë nga kthetrat e këtyre batakçinjve!

Kaq e pati puna. Pastaj...

Dhëndrri u kthye pa nuse në shtëpi, ndërsa dajë Isua u kthye pa të mbesën.

TREGIM PËR PASQYRAT

Unë asnjëherë nuk kam patur simpati të veçantë për pasqyrat. Kjo ndoshta ka rrjedhur ngaqë pasqyra nuk m'i ka mbuluar asnjëherë kusuret. Veç kësaj, pasqyra kurrë nuk ka mundur të futet përtej pamjes sime të jashtme. Kështu, dalëngadalë, ftohja ime me pasqyrat sa vinte dhe zbriste nën zero. Bënin përjashtim vetëm rastet kur unë detyroheshja të rregulloja flokët e mjekrës.

Por, që pasqyra të ma ruante dhe të ma shpërblente këtë ftohtësi, kjo nuk më kishte shkuar në mendje. Dhe kjo ndodhi kështu.

* * *

Në jetën bashkëshortore çdo njeri i ka kusuret e veta. Si të gjithë edhe unë kam pjesën time në këtë mes. U martova me dashuri, jo për gjë tjetër, po vetëm sepse padashur rashë në dashuri.

Padashur... po pastaj çdo gjë vinte vetë, me dashje dhe me dashuri, bile! Se, aq është, sa të hysh në valle.

Edhe ajo më dashuronte ! Ajo asnjëherë s'më tha s'të dua. Përndryshe unë do ta kisha bërë problem. Me aq sa të mundesha, kuptohet!

Thonë, ose duan të thonë, se në dashuri nuk ka arësytim. Mundet të mos jetë krejt e vërteta me kaq. Se çfarë dhe si arësytetja atëherë, me hollësi nuk më kujtohet. Por diçka të tillë mbaj mend ashtu çalë-çalë...

«Ajo është e bukur, simpatike... unë e dashuroj... po vallë, mos është e thënë që, meqenëse e dashuroj unë, të mos e dashurojë as edhe një tjetër?.. Hëm, po kësaj ç'i thonë? Kushdo ka të drejtë të dashurojë! Se monopoli i dashurisë nuk ekziston. Si i bëhet... Po përderisa e dua unë, ç'punë ka tjetri, ose...

Dhe u bë kështu: Që atë ditë tek unë lindi xhelozia... Dhe kjo nuk qe e lehtë për mua. Të tjerët, nuk e di, të thonë ç'të duan.

Nuk di sa e pranojnë burrat e tjerë xhelozinë, po sa për mua e them hapur: «Ajo më sfiliti».

«Kush qe ai që dje mbrëma në kinema «Partizani», radha 31, karrigja 14, të buzëqeshi në atë mënyrë?. Po ai burri, që desh u përplas me ty përpara sallamerisë qëndrore, përse tha: «Ku të kam njohur?» Më thuaj, ku të ka njohur dhe përse deshi të të njihte sërish?

Përse shoferi i urbanit që na çoi në varreza shikonte oreçast nga ti? Si i thua ti kësaj?»

Ajo nuk më përgjigjej! Shikonte dhe buzëqeshte. Po, nuk më përgjigjej! Dhe unë detyrohesh të çarmatosesha vetë. Se nuk mund të marrësh inat me një buzëqeshje.

Dhe ajo ashtu qe: Një buzëqeshje prej vishnje! Jo buzëqeshje standart, si ato që dalin nga kokat e ulura përmbi formularët.

Disa duan të thonë se gruaja të fal, kur bëhesh

xheloz, por nuk të fal kurrsesi, kur nuk bëhesh xheloz. Për këtë të fundit nuk kam ç'të them, pasi unë nuk pata ndonjë rast që të mos bëhesha xheloz. Dhe ajo nuk më ndëshkoi asnjëherë për këtë.

Pas martesës gruaja ime u bë më e bukur. Kjo m'i shtoi telashet. Në fakt, kjo shtoi xhelozinë, që vinte në përpjesëtim të drejtë me telashet dhe, po të llogaritet sipas rregullit të treshit të drejtë, nuk dihet ku të nxjerr hesapi.

Shumë vetë e përhëndesnin gruan time. Akoma më shumë i buzëqeshnin. Lëre pastaj sa i kalonin afër, ose ashtu si pa dashje e çiknin lehtë, si të qe fëshfëshe. Dhe hajde e t'i kontrolloje të gjithë këta se ç'elementë qenë.

Njëherë më shkrepri të më bënte një listë të plotë të të gjithë kushërinjve të saj, po pastaj ndërrova mendje, se m'u duk punë pa leverdi. Do të ngatërrrohesha edhe më keq me gjithfarë emrash e mbiemrash. Dhe hajde t'u bëje gjenealogjinë...

Mendoja se këto telashe do të merrnin fund pas lindjes, për dy arsye kryesore:

E para: se pas lindjes ime shoqe nuk do të ishte më aq e bukur se sa përpara lindjes.

E dyta: se, po qe që do të bënte djalë, me rritjen e tij, unë do të kisha një ndihmës të çmuar në përpjekjet e mia për të zberthyer të gjitha buzëqeshjet që i drejtoheshin dashurisë sime.

Por të dyja këto shpresa u përmbysën nga dy arsye të tjera të forta: E para: se ime shoqe, pas martesës, për habinë time, lindi vajzë. E dyta: se ajo, për taksiratin tim, u bë edhe më e bukur!

E kuptoja edhe vetë se nuk duhej të bëhesha xheloz, se kjo nuk më kishte hije, se xhelozia ishte një mbeturinë anadollake, po prapë, sapo që ndonjë



kalimtar i buzëqeshte gruas sime, mua më hipte gjaku mbi nivelin e kokës. Dhe mendoja: Përse të mos dilte një dekret, sipas të cilit, burri të ishte i detyruar t'i buzëqeshte vetëm gruas së tij dhe asnjë femre tjetër? Kjo do të më lehtësonte mjaft.

Pas lindjes së parë erdhën edhe tri vajza të tjera në certifikatën e gjendjes sime familjare. Dhe keni parë kështu ju? Rriteshin e zbukuroheshin bijat e mia, zbukurohej edhe ime shoqe! Për të rritur nuk rritej, po, për të zbukuruar, sytë të mbeteshin mbi vetullat e saj, sapo e shikoje. Sikur të kishte emulacion për bukurinë, mua do të më duhej t'i jepja edhe një fletëlavdërimi sime shoqeje!

Po mua më qe bërë koka furtunë. Dhe ropatesha nga mëngjezi në darkë... Me dy turne, me tri turne duhej të kontrolloja se mos ndokush kapërcente normat!

Nga eksperiencia ime personale, e them me përgjegjësi se gruaja nuk duhet të jetë e bukur. Kjo aksiomë është provuar në shpinën time. Ndoshta edhe në të tjera shpina. Kush s'më beson, s'i kam faj! Unë nuk e këshilloj ta provojë...

Xhelozia ime nuk ishte me të bërtitura, as me qortime, as me zënka. Ajo ishte e qetë dhe e thellë si vetë dashuria ime! Ishte, si të thuash, një xhelozia e kulturuar! Dhe prandaj më ropaste mirë...

Një ditë, në MAPO, po provoja një kravatë para pasqyrës. Gruaja dhe gocat po më rrinin pas, si garda e Safos. Po papritur vë re se një mashkull, i cili përpiquej të rregullonte kravatën blu, po u buzëqeshte fare hapur amazonave të mia...

Ishte aq intime kjo buzëqeshje, saqë nuk mund të durohej, sado vullnet të mirë të kishe. Dhe unë

boll kisha duruar! Doja vetëm një rast të tillë flagrant!

U ktheva me rrëmbim për ta kapur fajtorin me presh në duar.

Po ai rrezili nuk dukej gjëkund. E ruajta gjakftohtësinë si një teknik frigoriferi dhe pas një rrotullimi 180 gradësh hodha sytë në pasqyrë... Duhej ta verifikoja edhe një herë..

Kur, ja, ai maskarai, i cili me një buzëqeshje donte t'u merrte mendjen pesë femrave, po rrinte aty si hu gardhi, duke u marrë sërish po me atë kravatën bajate. Veçse nuk po i qeshte më buza.

Por kjo mua nuk më interesonte. Unë doja flagrancën! U mora sërish me kravatën time, duke dashur t'i lija kohë atij tjetrit... Dhe ja arrita!

Nga turinjtë e tij po varej si patëllxhan një tjetër buzëqeshje dërmuese.

U ktheva në moment, kur çdo gjë u zhduk!

— Po ku drejtin u fut?

— Kush? — pyeti e habitur garda e amazone!

— Koka ime! — u përgjegja unë i kapur me presh.

S'kisha faj! Xhelozia më kishte verbuar aq tepër, sa që me një kravatë tjetër, unë edhe veten time po e ngatërroja me dikë, vetëm e vetëm pse u buzëqeshja gocave dhe gruas sime.

* * *

Ky qe shërbimi më i madh që më kanë bërë pasqyrat deri tani! Ndoshta ma bënë për hakmarrje, apo për gjë tjetër, këtë nuk munda ta kuptoja dhe as që do të përpiqem për ta verifikuar!

STILET E KTHIMIT

Unë dhe Minai u futëm në dhomë, pothuaj në një kohë. Ka të ngjarë që t'ju duket po kaq i çuditshëm dhe fakti që ne lëshuam nga një fishkëllimë pothuajse prapë në një kohë, veçse me nota të ndryshme, sipas shijeve personale.

Dhe kishim të drejtë. Sapo hoqëm qafe lëndën më të vështirë. Ndërsa tani na priste me padurim lënda më voluminoze. Por ne i kishim marrë masat. Kësaj lënde i kishim vënë në dispozicion 15 ditë. Kështu, vetëm po të ishte kungull nuk do ta merrje. Dhe dihet se kungujt zakonisht piqen në vjeshtë.

U ulëm dhe i ramë kalemit: 15 ditë pushim — 990 faqe tekst. I binin 66 faqe në ditë. Si shifër e madhe kjo, por edhe madhësitë janë relative. Po qe se ne do të mësonim nga 15 orë dita, na takonin nga 4,4 faqe në orë.

Ose, duke marrë për bazë peshën, llogaritë dalin më të thjeshta. Teksti peshon 960 gram. I bie të mësojmë 64 gram tekst në ditë. Me nga 15 orë dita, baraz me 4,3 (afërsisht) gram në orë.

Epo, për kaq gjë, nuk ka arësye të alarmohesh, apo jo? Sa ka të sëmurë që pinë po kaq apo më tepër gram ilaçe në ditë dhe nuk keqësohen. E ç'u bë se

një student gëlltiti 4-5 flakona me formula dhe përkufizime?

Teksti kishte gjithsejt 350 faqe me formula. Por kjo nuk na shqetësonte tepër. Kjo është një lëndë e tillë shpirtgjërë saqë, po të mësosh një formulë bazë, mund të ndërtosh me lehtësi dhe nja 70 formula e indekse të tjera.

340 faqe mbusheshin me pikëpamje të ndryshme mbi çështje të njëjta dhe 83 faqe pak nga të gjitha. Sa për bibliografinë prej 11 faqesh, s'e vinim fare në hesap, jo për mungesë edukate, por sepse pedagogu i lëndës na e kishte përjashtuar nga provimi për këtë vit.

Ngrita kokën dhe i shkela syrin Minait, gjë që ai ma ktheu pa vonesë.

— Si thua?

— Kemi kohë!

— Epo?

— Çohemi!

Mbështollëm tekstin voluminoz që peshonte sa një tru i plotë dhe u nisëm drejt stacionit të trenit. Në Rrogozhinë u ndamë. Ai drejt Elbasanit. Unë në Fier.

S'i thonë shaka, 15 ditë pushim për një provim. Pavarësisht se teksti kishte 990 faqe dhe peshonte 960 gram, ne nuk duhej të na trembnin shifrat.

Të nesërmen e ditës që arrita në shtëpi u vura të mësoja. Aty nga mesi i parathënjes, dera e dhomës buçiti nga ca grushta të regjur dhe të fuqishëm. Ishte Halimi, shoku im i fëmijërisë.

— Hajde a derëzi të dalëm! Ç'më je mbyllur kështu si Oso Kuka? Ti je i zgjuar, e merr provimin edhe pa e hapur librin.

Ç't'i thoshja. Presioni i tij e mposhti rezistencën time dhe u ngritëm.

Të nesërmen vendosa që derën të mos e hapja sikur tërmeti të binte. Dhe me të vërtetë ra tërmeti. Po unë s'u tunda. Më pas na doli se nuk qe tërmet, por shpatullat e Demos, që shtynte derën. Si nuk i shkoi kjo, Demua mori fizarmonikën dhe nën dritaren time filloi të më bënte serenatë në orën 10 të ditës (ndoshta duhet thënë «seredita» po unë nuk guxoj, pasi nuk munda të konsultohesha me filologët).

Pashë ç'pashë mbylla tekstin me kujdes dhe i lashë formulat në qetësi.

Kështu më fluturuan 12 ditë nga pushimet e këtij provimi dhe në ditën e 13 unë u gjenda përsëri në trenin Fier-Tiranë.

Isha aq mbrapa, saqë pak shpresa më kishin mbetur. Por shpresa nuk humbet, sado e vogël që të jetë.

Në korridorin e konviktit, ballë për ballë meje, po marshonte me hap ushtari Minai. Ne të dy u futëm në një dhomë pothuaj në një kohë. Dhe, pothuaj me një zë pyetëm:

— Ku je?

— Fare esëll!

— Po ti?

— Idem!

Llogaritëm ç'na duheshin për ato tri ditë. Më pas, nisëm një shokun tonë në pazar i cili do të psoniste: bukë, djathë, marmalatë, vezë dhe sheqer për tri ditë. Mbyllëm derën nga brenda dhe hapëm tekstin plot vrull dhe energji.

Pas një ore nuk m'u durua pa e pyetur Minain:

— Në ç'faqe je?



— 85.

— Po ti?

— 44.

Pauzë! Pauzë, por në të vërtetë unë zieja nga brenda. Ai të ma kalonte mua? Në një kohë kur duheshin thyer normat dhe duhej ngritur rendimenti! Vendosa të zëvendësoja normat e vjetra të studimit. Sa për ngritjen e rendimentit, ajo do të provohej në prani të pedagogut.

Pas një ore.

— Ku je, Mina?

— Në faqen 120. Po ti?

— Tek 189-ta.

Ai lëshoi një fërshëllimë, por mua në fakt m'u bë qejfi, se e pashë që ja mbylla gojën.

— Ku je, Tolo?

— Në faqen 370. Po ti?

— Tek 450!

— Fiuuuu!..

Pas një ore.

— Ku je, Mina?

— Tek 600-ta. Po ti?

— Në faqen 770-të!

Me këto përpjesëtime, ne dalëngadalë po i afroheshim shpejtësive kozmike. Por vullneti ynë i mirë dhe i fortë bëri që ne t'i arrinim dhe t'i kalonim shpejtësitë kozmike. Më në fund arritëm dhe kaluam edhe shpejtësinë e dritës. Kështu gjatë atyre 3 ditëve, sipas nesh lëndën e kishim përsëritur nga 12 herë. Pas një beteje të tillë, e kishim për detyrë që të hynim në provim me kurajo dhe me optimizëm! Edhe pedagogu po kështu na priti. Por ne nuk kemi ndër mend të qahemi për pritjen e tij.

Unë nuk e dëgjova dot Minain, pasi unë për-

gjigjem para tij. Kështu që nuk mund t'i vë duart
në zjarr, se me ç'stil u kthye ai për në vjeshtë. Por,
prapëseprapë, kam besim se të dyja stilet tona kanë
patur aq shumë pika të përbashkëta, saqë do ishte
tepër vështirë t'i dalloje.

KUSURET E MUNGESAVE

Sapo dola nga dera shokët m'u vërsulën pothuaj fluturim dhe më mbuluan me pyetje:

— Hë, si dole?

— E more?

— Bazën, apo me tejkalim?

Unë i shikoja si i shushatur, fshija djersët dhe nuk dija se si t'u përgjigjesha. Me të vërtetë që nuk dija se si t'u përgjigjesha.

Kjo ndoshta erdhi ngaqë edhe pedagogut nuk dita si t'i përgjigjesha. Ishte, si të thuash, një inerci e heshtjes.

— Hë de, se na plase, e more, apo jo?

— Jo, nuk e mora!

— Si? Mbetë?

— Jo, nuk mbeta!

— Ej, tutkun, shkundu, se e ke humbur fare! Ç'janë këto aguridhe që këput?! As e more dhe as mbete, po ç'dreqin bëre, atëhere? — më pyeti i revoltuar Hulua. Ai kishte të drejtë. Dhe unë po e prisja me kurajo shfrimin e tij legjitim. Por, meqë kjo histori nuk fillon këtu, unë s'kam se si ta shpie deri në fund pa u kthyer disa muaj prapa.

*

*

*

Në pushimet e sivjetme verore, unë nuk munda të shkoja në plazh si gjithë shokët e mi. Dhe kjo e gjitha për faj të kokës sime! Por, jo përherë, koka bën, koka pëson, siç duan të thënë disa. Këtë radhë po e pësonte i gjithë trupi, pasi plazhi, me sa garantojnë mjekët, nuk i përket vetëm kokës.

Unë isha kthyer për në shtator në një lëndë, prandaj vullnetarisht hoqa dorë nga plazhi. Se dy kunguj nën sjetull nuk mbahen. Dhe unë nuk i mbajta të dy!

Në qershor bën si bën, se e di që pas qershorit vjen shtatori. Por në shtator, edhe pse qershori vjen pas, ty s'të hyn në punë, sepse, siç i thonë, e merr ferra uratën!

Në lëndën e «Kristalografisë» mua më tërhiqte vetëm emri i saj tingëllues. Të gjitha faqet e tjera që vinin më pas, të ngarkuara me formula si devetë e karvaneve të Saharës, nuk para më magjepsnin. Kjo, jo vetëm për mungesë ekzotike!

Rrija në bangën e fundit dhe vizatoja pamje nga plazhi. Por ftohja ime në këtë lëndë arriti kulmin dy muajt e fundit, kur unë nuk shkela më në leksionet e «Kristalografisë». Mungesat e mia i lehtësoi edhe ndërrimi i pedagogut të lëndës me një tjetër për motive shëndetësore. Shpjegime të tjera nuk pati, as pëlqimi ynë s'u kërkua.

Sakrificat e mia për të mos u paraqitur në leksione patën pasoja jo fort të këndshme. Në prag të provimit të «Kristalografisë», unë u tërhoqa (jo për

motive shëndetësore) dhe takimi përfundoi aforfe:
0 me 1, dhe me një katër në mungesë.

Nuk u dëshpërova dhe aq. Do të vinte shtatori,
do të mësoja dhe do të merrja një notë për të qenë.
Kështu, pushimet e mia të sivjetme unë i flijova me
qëllim që të siguroja një notë më dinjitoze në këtë
lëndë dinjitoze.

Ngrysu e gdhiu, erdhi më në fund jo vetëm
shtatori, po edhe dita e provimit. Hulua më futi
krahun, sigurisht që të më ngrinte moralin dhe më
përcolli për në fakultet, ku do të takoheshin të
kthyerit. Ecnim pa folur, megjithëse donim të flit-
nim.

— More, Hulo, po si e quajnë pedagogun, the,
se e harrova?

— Martin, Martin Shkodra.

— Hë, mirë! Po ma përshkruaj pak, që ta kem
parasysh!

— Pak flokë...

— Pa tjetër...

— Pse pa tjetër?

— Përderisa jep atë lëndë... po tjetër?

— I gjatë dhe i dobët...

— Po, i dobët! Nuk dyshoja.

Kështu, duke ndërprerë e duke penguar njëri-
tjetrin, arritëm t'i bënim edhe një portret (nuk di
sa besnik) pedagogut të lëndës.

Gjithnjë kam patur dëshirë të m'i përshkruanin
që më parë njerëzit me të cilët do të kem të bëj.

Te shkallët Hulon dikush e ndali, ndërsa unë
vazhdova të ngjitesha, i sigurtë se nuk kisha njeri
që të më ndalte pa ja arritur qëllimit. Përndryshe,
ç'kërkoja unë aty?

Në korridor e pashë atë që duhej të shikoja...

pedagogun e lëndës... Pak flokë... i gjatë... i dobët... i menduar... E ndoqa pas. Ai u fut në një auditor, në derën e të cilit shkruhej qartë: «PROVIM». Atë kërkoja edhe unë. Provimin dhe pedagogun e lëndës. Hyra pas tij.

— Kam ardhur të jap provimin.

— Urdhëroni!

Mora një biletë dhe u ula. Pas meje hynë dhe pesë-gjashtë studentë të tjerë nga kurse të ndryshme që përsëritën gjestin tim.

Bileta më dukej tepër e errët, megjithëse ajo qe një letër e bardhë me kollë të ndritur. Me sa dukej, faji nuk qëndronte te letra e biletës, se sa tek ato që shkruheshin mbi të.

Unë për bela katër leksionet e fundit i lashë mënjanë, po kurrë nuk ma priste mendja se do më binin vetëm ato. Se fundi i fundit, këtë nuk e bëra me qëllim. «Si dreqin i paska ndarë kështu ky pedagog Shkodra pyetjet? Kjo s'është parë ndonjëherë!» E, megjithëse në të vërtetë kjo praktikë s'qe parë ndonjëherë, një gjë e tillë nuk më nxirrte nga balta.

I hodha një sy rreth e rrotull sallës së auditorit me shpresë se do ta kapja fillin e Arianës te ndonjë nga ekspozetë e shumta. Por edhe ato më dukeshin po aq të mjegullta sa edhe bileta.

— Me leje, profesor! Ka mundësi ta ndërroj biletën?

— Si të doni, veçse do t'ju ulet një notë.

— Dakord! — Ndërrova biletën dhe mora frymë i lehtësuar.

Nga katër leksionet e fundit nuk mund të më binin pikërisht mua të katërta për vetë faktin se

nuk i kisha përfillur. Me këto mendime inkurajuese, mora guximin t'i hidhja një sy biletës...

...Jo mjegull, po muzg... Muzg, që sa vinte dhe errësohej në trurin tim plot tension... Djalli e mori, prapë ato katër leksione! Edhe dyzet të kishin qenë. Ta ndërroja sërish biletën, nuk ma lejonte as edukata dhe as teoria e probabilitetit.

Sajova ca formula po aq të sigurta sa ato kalatë që nuk i bëra dot me rërën e plazhit.

«Polimeret... polimeret... po ku dreqin i kam takuar polimeret në «Kristalografi»?.. Prandaj nuk bëje mirë që lije leksionet dhe shkoje në filma. Të paktën nuk qenë as filma shkencorë... Ndoshta nuk do të të vriste kaq shumë këpuca! Po nejtse, kjo s'që për fajin tënd. Dhe as që mund të ndreqet tani.»

Kur më erdhi radha, unë u ula pothuaj mekanikisht përballë pedagogut. Ai më pa me një farë dyshimi të çuditshëm.

— Më duket se në leksione nuk ju kam parë fare!

— Këtu ka dy arësye! — ju përgjegjja unë me dyshim, se e mora me mend që, nga të gjitha përgjigjet e mia, vetëm kjo do shkëlqente. Dhe vijova të shkëlqëja: — E para, sepse unë rri përherë në bangat e fundit dhe e dyta, se jam ca i shkurtër. Kështu që nuk para bie në sy. Mjaft pedagogë kështu më pyesin, me dyshim, por unë...

— Nejtse, kjo s'ka rëndësi, ma mirë po hyjmë në temë.

Thoshte ai, të hyjmë në temë, po në të vërtetë, isha unë ai që do të hyja në valle. Lëre se ç'hyrje... ngëc... ngëc... polimeret... shkrapa-shkrupa... Shikoja pedagogun se mos reagonte gjë, por sytë e tij u ngjanin këtyre polimereve të pakapshme.

— Deri tash, asgja nga këto që kemi thanë nuk hyn këtu — sugjeroi ai.

— Po ky hyjnë, profesor?

— Atë duhet ta dini ju!

Edhe unë doja ta dija, se më duhej, po s'e merrja dot me mend!

— E kam më të lehtë të koncentrohem po të më bëni pyetje ndihmëse.

— Ashtu? Mirë, pra, unë jam gati.

Dhe, ai me të vërtetë ishte gati. Ja filloi me pyetjet ndihmëse. Mirë, po ato, jo vetëm që nuk më ndihmuan por më ngatërruan më tepër. U trullosa! Nga binin gjithë këto gjëra, xhanëm? Si ka mundësi që në katër leksionet e fundit të shtjellohen tërë këto formula... Apo mos vallë «Kristalografia» e ka lënë çdo gjë me peshë në katër leksionet e fundit?

— Më thuej, së paku, objektin e landës! — pyeti pedagogu.

— «Kristalografia» është një lëndë e cila...

— Prit, prit, cila landë, thatë?

— «Kristalografia» — ju përgjegja unë më i sigurtë se çdo herë tjetër.

— Cila «Kristalografi», mor shok?! Unë jap vetëm «Kiminë organike».

— Më falni, po nuk jeni ju, profesor Shkodra?

— Cili Shkodër, mor shok? Unë jam Gashi!

Në përfundim të këtij dialogu dramatik, shpërthyen të qeshura plot bujë. Nuk kuptoja se ç'hynin të qeshurat aty? Dhe me të vërtetë, ç'hyjnë të qeshurat, në dash në «Kristalografi», në dash në «Kiminë organike». Së paku, kështu më duket mua.

Pedagogu, duke u përpjekur të mbante të qeshurat, më ra në sup dhe më tha: — Çohu, djalo! Ti

nuk njohke as pedagogun e landës dhe vjen të japësh provim!

Dola pothuaj, mekanikisht dhe aq i hutuar, sa që edhe derën kërkoja ta hapja nga ana e kundërt. Tashmë më duhej të gjeja se në ç'dhomë jepej riprovim «Kristalografia» ime! Veç kësaj ishte e domosdoshme t'i hapja sytë mirë, se mos e ngatërroja sërisht me ndonjë lëndë tjetër.

KAFKA E KALIT

Kishte dy arësye tepër serioze që në auditor zotëronte qetësia. E para: Ne përgatiteshim për provimet e qershorit. E dyta: Ishte natë, aty rreth orës dhjetë! Se natën, edhe kur s'ka provime qershori, supozohet të ketë qetësi, si nëpër auditore ashtu edhe nëpër vende të tjera. Bëjnë përjashtim vetëm netët e dasmave, ditëlindjet, argëtimet dhe grindjet familjare, si dhe të tjera raste kësodore.

Unë isha ende te bretkosat, ndërsa shoqja ime e bangës, Liza, po djersinte mbi skeletet e dinosaurëve. Meqë nuk i dilnin tamam kockat e kurmit, ajo po i përsëriste ato që nga fillimi, herë me anën e gishtërinjve e herë me anën e grupimit të vijave perpendikulare.

Papritur ajo lëshoi një ulërimë dhe më kapi nga krahu. Unë u trondita si nga ulërima ashtu edhe nga duart e saj. Njeriu kurrë nuk duhet të kapet në befasi. Sidomos nga seksi i kundërt! Mund të jetë me zemër të dobët, po mund të jetë edhe me tension. Lëre pastaj, që unë, për fat të keq, i kam të dyja.

Të gjithë kthyen kokën nga unë.

— Te dera, te dera! — pëshpëriste Liza dhe

nuk më lëshonte. «Ç'dreqin ka te dera? — thashë me vetë dhe padashur çova sytë andej.

Prapë padashur u rrëqetha! Te dera gjysmë e hapur qëndronte pezull një kafkë kali. Unë e di se nata ka shumë mistere por, që të arrinte puna gjer këtu, nuk ma hante mendja, prandaj po rrija në pritje.

Auditori filloi të gumëzhinte si zgjua bletësh. Sytë i kisha mbërthyer te kafka që rrinte pezull. Ajo lëvizi pak turirin lart, u ul poshtë sikur diç po nuhaste dhe sërish u kthye në pozicionin e parë.

E di që në jetë ndodhin gjëra të çuditshme! Por nuk besoj në mrekullitë. Si mund të shpjegohet fakti, që një kafkë kali të ngrihet në këtë orë të natës dhe të vijë kështu pa pyetur njeri në auditorin tonë? Përse vallë ta ketë bërë këtë? Ç'kërkon nga ne? Ç'ndjenja vallë mund të të ngjallë një fakt i tillë? Pa të shohim se ç'do t'i shkrepë, të bëjë më tutje, kësaj kafke të çuditshme...

Pas pak dera u hap tamam dhe kafka e kalit tërhoqi pas Banushin, shokun e kursit tonë. Ose më mirë, Banushi hyri triumfator me kafkën e kalit në dorë.

— Ke parë kështu ti? Kasten e bën ai, e njoh unë!

— Kasten, kasten, po mua më ngriu gjakun.

— Po unë që nesër kam provim?

— Ti duhet të flesh, se vajti vonë!

— Banush, ku je, o i paudhë? Përse na prish qetësinë? — i hoqa vërejtjen me dashamirësi, pasi tashmë isha çliruar plotësisht, si nga frika ashtu edhe nga duart e Lizës.

— Si? Unë prisha qetësinë? — u hodh papritur në sulm shoku im. — Turp të keni! Për nder, turp

të keni! Unë sakrifikoj gjumin e natës, kurse ju më akuzoni! Po pse, a s'paskam të drejtë të mësoj edhe unë si gjithë të tjerët? Natën, natën! Ditën, ditën! Si gjithë të tjerët. Përse të mos mësoj? Apo dëshironi që të përsërit vitin? Mos vallë doni që të kthehem në shtator dhe të tallen kalamajtë e lagjes me mua?

E pashë se Banushi kishte njëfarë të drejte! Fundi, përse të mos mësonte? Megjithëse atij nuk po i qante fort zemra për mësimet, prapëseprapë, ky vullnet duhej inkurajuar. Auditori ra prapë në qetësi.

— Kush e gjen — u ndie sërish zëri i Banushit — çfarë kali ka qenë ky? — dhe tregoi kafkën. — Kalë shale, karroce, apo samari? Nga Myzeqeja, nga Peqini, apo nga Zadrima? Natyrisht, duke gjykuar vetëm nga kafka! Kush e gjen, e merr provimin aforfe!

Kjo pyetje u prit me të qeshura dhe qetësia e zakonshme kapërceu e u hodh nga dritaret e katit të tretë. Edhe mua më qeshej, por s'doja ta bëja veten. Dhe as të hidhesha nga dritaret e katit të tretë, se auditori ynë nuk ngrihet mbi ujë si Venecia. Duhej mbajtur qëndrim. Mundësisht i prerë!

— Ja ta zëmë se pedagogu të bën një pyetje të tillë në provim, si do të përgjigjem unë? — vijoi me seriozitet Banushi.

— Atëhere përgjigju, kurse tani mëso, se na le dhe ne pa mësuar — ja ktheu Kola, një student që nuk di ta çojë kokën kur flet.

— Jo, po të sqarohemi. Shokë, unë kam nevojë për ndihmë! Pse kështu i ndihmoni ju studentët e dobët? Keni marrë dhe zotime. Turp të keni! Me kafkën dhe u mërzhitët! Po kur të vete gjer te bishti?

U pa puna! Edhe vonë vajti. Unë mbylla dispensën, ose më mirë të themi gjysmën e dispensës, pasi gjysmën tjetër ma ka marrë Liza.

Nesër do t'i këmbejmë dhe do të vazhdojmë kështu deri në fund. Ky është shfrytëzimi maksimal i bazës materiale. Me shifra del 200 për qind. Me nota: varet se si do të ndahesh me pedagogun. Përfundimin e ke të firmuar në librezë.

Të nesërmen po në atë orë. Unë e Liza rrinim po në ato pozicione. Gjithashtu edhe të tjerët. Dhe bash në atë pozicionin e djeshëm, nga dera gjysmë e hapur u fut një kafkë majmuni. Dhe qëndronte pezull po aty. Por ne tashmë qemë të përgatitur.

Kafka e majmunit, pas një pesëminutëshi qëndrim pezull, bëri përpara në dorën e sigurt të Banushit. Në sallë pati ilaritet.

— Edhe kjo duhet sqaruar mirë! — ja nisi Banushi. — Në është majmun nga kopshti zoologjik, apo nga xhungla. Mirë, po edhe xhungla ka shumë. Amazona, Brazili, India, Afrika, Australia! A nuk të bëhet koka xhunga-xhunga me këto xhunglat?

— Të lutem, këto sqaroi në provim — ja ktheu atij po ai Kolë, i cili nuk di ta ngrejë kokën kur flet. Sidomos kur kërkon qetësi.

— Shokë! Ju jeni egoistë. Turp të keni! Për nder, turp të keni! Ju mendoni vetëm për vete dhe për notat tuaja. Ca më keq. Ju jeni egocentristë! Bible, edhe ekzistencialistë! Po pse, kështu ndihmohet shoku? Kjo është dashamirësia studenteske? — shpërtheu Banushi.

Meqë akrepat e orës po i afroreshin takimit të 11-ta, unë mbylla gjysmën e dispensës sime, Liza mbylli gjysmën tjetër të po kësaj dispense dhe u ngritëm.

Në provim mua përherë më takon të dëgjoj qyfyret e Banushit. Them qyfyret, pasi ai kurrë nuk di të përgjigjet pa qyfyre. Ja hedh vetëm matematika me ato formulat pa fund, ku nuk di si dhe qysh t'i futë ato qyfyret e tija pa fund! Qyfyret nuk mund të shprehen me formula dhe, për mirësjellje, as formulat nuk mund të shprehen me qyfyre. Ky është një gabim të cilin matematika e trashëgon nga lashtësia, por që do të rëndojë mbi të gjithë brezat.

Edhe këtë radhë në anatomi, Banushi doli të përgjigjej. Për çudi, bileta e tij fillonte me kafkën e kalit!

«E hodhi lumin», thashë me vete, pasi ai rrinte me kafkat jo vetëm ditën, por edhe natën.

Në përshkrimin që Banushi i bëri kafkës së kalit kishte gjëra aq mahnitëse, aq fantastike, sa që cilido kalë do të kishte turfulluar e do të kishte hingëllitur me ulërimë sikur ta dëgjonte. Ose, sikur të dilte ndonjë kalë sipas përshkrimit të tij, asnjë hipist nuk do të guxonte t'i afrohej të tillë krijese!

Në fillim pedagogu po e shikonte me ca sy, që sa vinin e bymeheshin, sikur bëheshin gati për të avulluar. Por pastaj ai i ra shpejt hilesë dhe mundi të qetësohej.

Banushi nuk shkëlqeu as në pyetjen e dytë, ndërsa në të tretën, kushedi përse, e pa me vend të mos e hapte gojën.

Pedagogu filloi pyetjet ndihmëse me qëllim shpëtimi. Por, meqë Banushi dinte mirë not, ai nuk qe mësuar t'i përdorte kamerdaret e shpëtimit.

Kur dolëm jashtë, e pyeta me sinqeritet:

— Si kështu, more Banush, pyetje më të lehta nuk kishte!?

— Eh, vëlla, të gjitha punët m'i ngatërroi ajo e mallëkuara kafkë e kalit! Ajo ma prishi gjithë te-
rezinë! Kafka e kalit!

— Jo, Banush! Së pari, me ata që nuk jetojnë,
mos hyrë në hakë! Unë mendoj se gjithë punën ta
ka prishur kafka jote dhe jo ajo e kalit! — i thashë
po me sinqeritet, meqë nuk dija se si ta ngushëlloja
ndryshe.

I DASHURI MINA :

Ti më luteshe të të shkruaja diçka për provimin. Je i çuditshëm. Ta kam thënë edhe herë të tjera, por ti nuk ke vënë mend. Dhe mbetesh po ai që ke qenë: i çuditshëm dhe i dashur!

Pra desha të të shkruaja diçka për provimin. E pse të ta prish? Ja ku po të shkruaj. Hyra siç hyj në çdo provim. I qetë, pa emocione (vetëm zemra e prish ritmin, por ajo nuk komandohet nga unë në ato çaste). Përshëndes pedagogun dhe marr biletën. Ulem te dritarja.

— Më ke gjithnjë te dritarja. Qoftë vjeshtë, dimër, apo verë! Ti e mban mend mirë se sa më pëlqenin mua dritaret, që i vogël! Se pse, nuk e di. po ja që më pëlqejnë ende!

Aty i hedh një sy pejsazhit që më del përpara, gjë që ndikon në çlodhjen e nervave dhe të zemrës. Hap dhe shikoj biletën. Pastaj marr kurajon t'i ngre sytë mbi pedagogun. Se bileta dhe pedagogu kanë lidhje në këtë mes. Ti e ke provuar dhe vetë. Ata përbëjnë një kapitull.

Pyetjet janë të lehta (ose unë e di mirë). Përcaktoj notën me mend (aty rreth tetës) dhe tund stilon në duar. Kur përgatitesh sistematikisht gjatë

vitit, pak puë të mbetet. E kam provuar në shpinën time këtë.

Pedagogu shikon dhe habitet. Kurse unë s'kam pse të habitem. Thonë se ky pedagog nuk i honeps dot ata studentë që nuk habiten. As ata që i futin miq. Ky pra nuk i ha miqtë! Kjo më gëzon, pasi edhe unë nuk i ha miqtë. Miku, detyra, distancë kilometrike.

Në përgjithësi unë simpatizoj jo vetëm ata pedagogë, që nuk i hanë miqtë, por edhe ata miq, që nuk i hanë pedagogët.

Dikush përgjigjet para meje, por unë nuk përqëndrohem dot ta dëgjoj dhe këtu ua qaj hallin pedagogëve, të cilët janë të detyruar të na dëgjojnë deri në fund, pavarësisht se çfarë themi.

Ja ku më vjen radha. Ulem përballë pedagogut. Katedra me tryezën e tij më ngjajnë si kala, të cilën unë e kam rrethuar nga të katër anët me leksione, formula, konspekte, e tjera. Janë llogariturat të gjitha: pelegu, azimuti, distanca, shpejtësia. Me një fjalë: triumf i sigurtë.

Unë flas. Pedagogu dëgjon. Dëgjon dhe nuk më ndërpret. Unë i respektoj ata njerëz që më dëgjojnë dhe nuk më ndërpresin.

Po i afrohesha fundit (sipas meje). Mendoja se lëkundjet sizmike të notës sime ndodheshin midis tetës dhe nëntës.

— Kaq kisha.

— Më falni, por unë do t'ju bëj disa pyetje suplementare.

— Ju lutem, kjo është e drejta juaj.

Pasi më hodhi një shikim thellësisht psikologjik, ai më bëri pesë pyetje të zgjedhura. I prega-

tita pa humbur kohë. Por pedagogu nuk qe dakord me përgjigjet e mia, edhe pse unë s'i kisha hedhur poshtë leksionet e tij mbi këtë temë. I tregova shënimet e mia plot formula dhe skica. Tha se në formulat kishte të meta të theksuara fonetike. I çuditur e pashë në sy por, meqë m'u duk gjakftohtë, e mblodha veten. Fonetika dhe formulat? Hajde e zbërtheje këtë!



Me sa dukej në përgjigjen time kishte diçka që nuk shkonte, ndërsa në këmbënguljen e pedagogut kishte diçka që nuk kapej nga unë.

Thonë të mos e kërkosim qimen në vezë. Po të jetë kështu, atëherë, përse zogu, që sapo del nga veza, ka pupla me qime?

— Vëmendja minimale që keni treguar gjatë vitit nuk ju ka lejuar të koncentroni dhe të asimiloni anën akademike të problemit — konkludoi ai.

— Unë nuk di të kem nënvleftësuar gjë — ju përgjegja.

— Ashtu ju duket. Por unë këtu përpara kam të gjitha mungesat tuaja. Boshllëqet e konstatuara te ju kanë lidhje direkte me temat që keni munguar. Unë e kam theksuar përherë, se mungesa e prezencës fizike gjatë zberthimit teorik të çështjeve është absolutisht e pakompensueshme as me një vullnet të posaçëm dhe as me ndonjë rast intelektual të veçantë. Ju nuk e keni patur parasysh këtë.

— Unë, shoku pedagog, kam munguar. Kjo është e vërtetë. Por unë kam munguar me kriter.

— Ç'dëshironi të shprehni me këtë?

— Faktin se kam munguar në ato tema, të cilat kanë qenë disi të përsëritura.

— Pra, ju ngulni këmbë se në lëndën time ka përsëritje?

— Unë ngul këmbë se në çdo lëndë ka një dozë përsëritjeje.

— Kam bindjen se, duke ju lënë në dispozicion pushimet e verës, do të vëreni se në lëndën time nuk ka përsëritje. Për lëndët e tjera nuk mbaj asnjë përgjegjësi — deklaroi dhe vizoi katrën në listë.

— Ju mund të më lini në dispozicion krejt vi-

tin e ndoshta më tepër, por ujët e tepërt koha nuk mundet kurrë ta avullojë — ju përgjegja duke u ngritur. Pedagogu e pa me vend të mos e vijonte këtë polemikë me një vjeshtuk. Hapi librezën time në faqen e parë. Lexoi me zë emrin, emrin e babës dhe mbiemrin.

Unë asnjëherë nuk kam qenë dakord me gjeneralitetet e librezave tona. Pse të shënohet aty emri i babës? Dhe a nuk dëshmon kjo për një koncept patriarkal në trajtimin e çështjes? Unë them se po!

Ndoshta këtu e ka hallin edhe pedagogu, i cili nuk po e shfleton më tej librezën. Ku ta dish, ndoshta ai edhe këtu kërkon të asimilojë anën akademike të çështjes.

E kuptoj kush e ka ngatërruar atë kështu. E kuptoj, por nuk dua t'i vij në ndihmë. Shfletoi librezën, shikoi notat me radhë dhe tha:

— Më falni, por dua t'ju bëj edhe disa pyetje.

— Me sa di unë, pyetjet bëhen para se të vihet nota dhe jo pas!

— Po, por unë jam kundër notës. Ka dhe forma të tjera vlerësimi. Pastaj, këtu kemi të bëjmë me një rast të veçantë.

— Jo, unë nuk jam një rast i tillë. Ju lutem, vini notën dhe më ktheni librezën! Tani e mori ferra uratën, përse të më pyesni më?

— Unë mendoj ta rishikoj notën — tha ai.

— Jo, shoku pedagog! Si njeri me parime dhe me vendosmëri akademike, ju takon të shënoni katrën dhe të më ktheni librezën!

Por ai ngulte këmbë. Unë u largova pa e marrë librezën. Të nesërmen ma ktheu një student. Më kishte vënë tetë. Ti do të thuash: pse e pranova?

Së pari, jam i mendimit se pak a shumë e meritoj këtë notë, së dyti, ende nuk e kam mbyllur çështjen.

Ja pra, i dashur Mina, ky qe provimi im. Sidoqoftë, kur të vish ti për këtë lëndë, përgatitu më mirë se unë, pasi, ku ta dish? Mundet që libreza jote të mos hapet në faqen e parë!

Përqafime
Yt vëllaçko R a q i!

LLULLA DHE BURNOTI

Në korridorin gjysmë të ndriçuar të fakultetit dëgjohej vetëm ecejaka e tre vetëve. Këta ishin, shefi i katedrës dhe dy pedagogë. Njëri nga pedagogët pinte duhan me llullë, kurse pedagogu tjetër preferonte burnotin. Shefi kishte gjetur karar me cigarishte.

Secili ecte sipas një linje të caktuar, të tillë, që të mos takonin njëri-tjetrin. Si një trafik i kaltruluar me saktësi matematike, për të mos patur ndonjë përpjekje apo ndonjë aksident katastrofik kësodore. Ndërkohë, njëri nga pedagogët, ai me llullë, devijoi përkohësisht nga linja e tij dhe ju afrua eprorit të vet.

— Shoku shef — tha ai — jam dakord me të gjitha materialet mbi revolucionarizimin e shkollës. Duhet të lëvizim, të këmbejmë eksperiencë, të diskutojmë. Ja, unë në kuadrin e kësaj lëvizjeje, mendoj të hyj një orë për të dëgjuar leksionin e kolegut tim — dhe shënoi me kokë nga pedagogu që hiqte burnot me tërë kapacitetin dykanatësh të mushkërive.

— Mrekulli — ja ktheu shefi — ja ku e ke kolegun. Mund t'ja thuash.

— Në asnjë mënyrë. Po t'ja them unë, ai do ta marrë si një ndërhyrje personale. Ndërsa ju, si një instancë eprorë, rezervoni të drejtën e një toni zyrtar dhe kategorik.

Shefi i katedrës ju afrua me rezervë linjës së pedagogut tjetër.

— Në kuadrin e lëvizjes për revolucionarizimin e shkollës, këtë orë dëshiron të vijë te ju për të dëgjuar leksionin, kolegu përballë — i tha atij shkurt.

— Nuk jam kurrësi dakord — ja ktheu tjetri. i pregatitur mirë për këtë përgjegje, pasi e kishte marrë vesh bisedën edhe pa qenë nevoja e ndërmjetësimit. Përgjegjen, shefi ja kumtoi të interesuarit.

— Po përse? — pyeti ai.

— Po përse? — Ju transmetua pyetja atij që hiqte burnot.

— Sepse jam i sigurtë që ai nuk vjen në leksionin tim për qëllime humanitare.

— Sepse ai është i sigurtë që ju nuk vini në leksionin e tij për qëllime humanitare — i përsëriti shefi pedagogut me llullë.

— Kjo nuk është aspak e vërtetë. Unë njihem si njeri korrekt dhe dashamirës.

— Mua pak më intereson kjo. Dashamirësia i takon kryqit të kuq dhe jo fakultetit tonë i cili, ose nxjerr kuadro, ose i hedh plehurat në kosh. Por, në qoftë se ai ngul këmbë, unë pranoj të vijë, veçse në asnjë mënyrë i pashoqëruar nga ju, apo nga zëvendësi juaj.

Shefi i katedrës kapërceu linjën dhe ju afrua tjetrit. I transmetoi qetësisht fjalët e kolegut dhe në pritje ndezi një cigare.

— Nuk kam asnjë kundërshtim që të mos më shoqëroni. Përkundrazi, unë vetë e kisha një mendim të tillë. Veç nuk isha i sigurtë në duhej t'jua thoshja tani këto apo më vonë.

Sapo ra zilja, në auditor u futën pas studentëve: shefi i katedrës dhe të dy pedagogët me shikim jo te njëri-tjetri. Shefi me njërin pedagog u ulën nga fundi i auditorit, kurse pedagogu i lëndës zuri vend në katedër. Ai, pa e hequr tubetin e burnotit nga hundët, hodhi një sy anembanë auditorit, sikur donte të qepte çdo shteg të mundshëm shpërthimi. Ky lloj shikimi ishte një paralajmërim stereotip për auditorin.

Studentët duhej të ishin shumë të vëmendshëm, dhe të mos kapej ndonjë me presh, përndryshe, e puthi halla.

Këtë radhë pedagogu e pa të arësyeshme që apelin ta bënte më ngadalë se herët e tjera, duke shqiptuar me kthjelltësi maji si zanoret ashtu edhe bashkëtingëlloret, pa përfillur kështu faktorin kohë. Koha për kokat e mëdha duhet të rrijë gatitu!

Para se të fillonte leksionin, ai bëri një hyrje të jashtëzakonshme, duke folur për rëndësinë e përsëritjes shkencore. Pasi sqaroi me saktësi dhe imtësi rëndësinë e përsëritjes shkencore, pedagogu, për çudinë e studentëve, filloi të shpjegonte një temë, të cilën e kishin përfunduar tre muaj më parë. Pa marrë parasysh reagimin e studentëve, ai vijoi detyrën, duke vigjëlur njëkohësisht me rreptësi qëndrimin e kolegut. Ishte një prezencë që e bezdiste më keq se fijet e xhamit në qafë.

Ja, kolegu diç po flet me një studente përpara tij. Pastaj, shiko, po i merr edhe fletoren. Hëm... ai i mori fletoren. Si duhet konsideruar kjo? «Gjest

humanitar», «shkelje integriteti», apo «agresion i hapur»? Më mirë do të ishte ndoshta ky formulim: «Dhunim i integritetit ajror dhe profesional».

Kështu dhe jo ndryshe, pasi fletorja me leksionet e tija u kap në ajër prej kolegut nga dora e studentës. Do që mirë që ajo shoqja studente të kthehej në shtator. Ndërsa kolegun, meqë nuk e kthen dot në shtator, duhet ta mbash në shënjestër, mbase, ku ta dish, një ditë të vjen vetë në grykë të pushkës. Si lum ai pastaj!

Duhet të më njohin mirë se ç'burrë jam.

Pasi mbaroi leksioni, auditori dalëngadalë u zbraz nga studentët. Por jo nga pedagogët. Ata mbetën aty të tre veç e veç!

— Me ç'të drejtë ju ja morët shënimet asaj studentes? — Pyeti pedagogu i lëndës, jo vetëm i fyer.

— Unë ja mora sipas të gjitha ligjeve të mirësjelljes — u përgjegj kolegu, si të ishte në të tatëpjetë.

— Shoku shef, për të gjitha këto, unë jam i mendimit që, unë dhe kolegu të mbajmë një procesverbal! — Propozoi burnoti.

— Shefi u kthye dhe i transmetoi propozimin në fjalë tjetrit.

— Le ta bëje procesverbalin, po unë nuk do ta firmoj. — Pra do të dilte një monolog dhe jo një procesverbal. Por arësimin tonë nuk do ta revolucionarizojmë dot as me monologje dhe as me procese.

— Jam dakord, duhet të bëjmë çmos në mënyrë që t'i revolucionarizojmë të tjerët dhe për këtë ngul këmbë që të mbajmë procesverbalin në fjalë — tha pedagogu i lëndës.

— Po, por së pari ne duhet të *revolucionarizohemi*, pastaj të *revolucionarizojmë* — tha kolegu.

Shefi kthente kokën sa në njërën anë në anën tjetër, sikur të ndiqte nga afër një ndeshje energjike pingpongu.

Debatet vijuan gjatë dhe me pasion. Duhej apo nuk duhej ky procesverbal për të revolucionarizuar më tej arësimin popullor?

— Ju thoni të *revolucionarizojmë*, ndërsa duhet thënë të *revolucionarizohemi*! Ndryshimi është aq i madh, sa nuk ju shkon ndër mend!

— Këtu nuk ka asnjë ndryshim. Këtu ka vetëm lojë fjalësh! — shfryu me inat burnoti. Por llulla, tepër e indinjuar, ja ktheu:

— Këtu paska lojë fjalësh? Më falni, por vetëm një i lojtur mund të gjykojë kështu!

— Domethënë, unë jam i lojtur?!

— Unë nuk e thashë atë fjalë! Ju merreni si t'ju interesojë!

— Shoku shef, ju jeni prezent. Ju i dëgjuat të gjitha. Për këtë, unë mendoj të mbajmë një tjetër procesverbal.

Debati u fut thellë, mori për qilizëm. Dhe nuk dihej se deri ku do të kishte arritur plori, sikur hyrja e studentëve gazmorë të mos i kishte shkundur nga ajo trulllosje.

Sidoqoftë pedagogu me burnot u betua se nuk do t'ja linte thatë kolegut atë davanë e procesverbalit.

«PRISHËSI I QETËSISË»

Unë e kam të qartë se edukimi i fëmijës është një detyrë sa delikate aq dhe e zorshme. Bile unë mendoj se është detyra më e vështirë. Bile vështirësitë mendoj se ngrihen në katror me mungesën e aftësive pedagogjike. Që i ri u dhashë shumë pas shkencave ekonomike dhe nuk më shkoi ndër mend t'i hidhja një sy edhe shkencës së pedagogjisë. Ndërsa tani më duket se, siç i thonë, e ka marrë ferra uratën. Tani nuk di nga ta kap lëmshin.

Kam një djalë në klasë të pestë. E quajnë Baton. Ndoshta emri s'ka nevojë të përmendet, por unë e bëj këtë pikërisht sepse nuk di nga ta filloj lëmshin.

Jam kujdesur me sa kam mundur që këtë djalë ta edukoj sa më mirë, bile mundësisht ca më mirë nga ç'jam edukuar vetë. Te të tjerët çdo gjë duhet ta bësh më mirë se sa te vetja.

Pandehja se deri diku ja kisha arritur qëllimit. Nga komshinë nuk më kishte zënë veshi ndonjë ankesë. Im bir nuk hipte në kumbullat e të tjerëve, siç kisha bërë unë në fëmijëri. As bajamet nuk ua trazonte. Nuk mbante llastiqe dhe nuk qëllonte me gurë. Asnjë xham nuk qe bërë thërrime nga dora e tij e urtë. As nga shkolla nuk i qe ndjerë zëri. Këto gjëra m'i kishin pakësuar telashet.

Punoja më me frymëzim. Në shkollë kisha nja dy-tre muaj pa shkuar. Më dukej sikur e bezdisja shkollën, duke pyetur dendur e më dendur mbi sjelljet e tim biri. Pastaj, të them të drejtën, meqë dëgjoja përherë lëvdata, dukej sikur shkoja të pyesja kasten që të ma lavdëronin djalin.

Fundja ai si gjithë të tjerët qe. Ndonjë yll në ballë, apo në krah nuk kishte. Pse të mos bënte ai ndonjë — proçkëz si gjithë vërsa e tij? Rritej si të gjithë ai, apo rritej si në inkubator? Kjo gjë kishte nisur të më shqetësonte.

Pra, më dukej sikur unë shkoja në shkollë që të më lavdëronin tim bir. Me këtë rast vura re se lek-sikun mbi lëvdatat nuk e paskemi të lavruar sa duhet. Nisa t'i rralloja vizitat në shkollë.

Dhe ja, një ditë shkolla erdhi tek unë. Në fakt jo shkolla, por mësuesi kujdestar.

— Kam rreth 15 vjet që punoj si mësues. Kam kaluar gjithfarë tipash nëpër dorë. Të zgjuar, çapkë-në, dembelë, qaramanë, të shkëlqyer, fyçka! Në shkollën ku jap mësim tani, s'kam as tre muaj. Të jem i singertë. Në fillim djali juaj, Batoni, më dukej i gjallë dhe i zgjuar.

Dhe vërtet, këto veti atij nuk i mungojnë. Bile mua më duket se ai i ka me teprim. Po, po, mos u çuditni hiç! Të jemi të singertë.

S'kisha se si të mos habitesha me të dhe me vetëveten. Paskësja një djalë më të zgjuar dhe më të gjallë nga ç'duhej! Mirëpo të jemi të singertë, ç'të keqe përmban në vetëvete kjo gjë e mirë? Dhe sa duhet të jetë masa këtu?

— Ja kështu, siç i thonë, gjella me kripë, kripa me karar. Është tepër i gjallë. Aq sa arrin të prishë qetësinë. Kur e pashë në orën e fiskulturës, mua më

ngriu zemra! Ai bën ushtrime që të ngjethin mishrat. Unë mbylla sytë të mos shikoja gjë. Po sikur të pësonte ndonjë aksident, kush do të përgjigjej, thoni ju?

E kuptoj. Fiskultura është fiskulturë. Lëvizje trupi, gjallëri, shkathtësi. . . Por ama, gjella me kripë, kripa me karar! Shkathtësi sa të të ngrijë gjakun nxënësi nuk duhet. T'i bëjë ushtrimet ngadalë dhe qetë-qetë. Kështu edhe syri kënaqet edhe rreziku mënjanohet.

Po në klasë, thoni ju? Të jemi të sigurtë — dhe ai nxori një blok nga xhepi, blok që me sa dukej kishte të bënte me sinqeritetin e tij.

— Ja një minutë. Po, në klasë. Gjatë një jave mësim me mua, ka kthyer 17 herë kokën prapa, 14 herë ka shikuar në tavan, 12 herë nga dritarja, 15 herë djathtas, 24 herë ka shikuar në pika të papërcaktuara dhe 29 herë majtas. Pra, kuptohet menjëherë që do të mbetet mëngjërash.

Po kjo nuk ka shumë rëndësi. Në vijim të një jave mësimi ka kapur në fluturim 16 miza.

— Më falni, po ju nuk e keni dezinfektuar shkollën?

— Ju lutem, kjo është një çështje tjetër! S'ka të bëjë me temën!

— Dakord, xhanëm po, kur të hanë mizat, diç do bësh. Si edhe qetë, kur i ha zagali.

— Nejse, ja po ja falim ato të 16 mizat — tha me zemërgjerësi pedagogjike mësuesi kujdestar. — Po këtë që shfletoi tri herë deri në fund librin e këndimit? Dy herë i nxori gjuhën Alzanës, shoqes së bangës. Tri herë i tërhoqi gërshetat Teutës, bile u mat edhe për të katërtën herë, po ndërhyrja ime nuk e la.



Pastaj, a e dini ç'thotë për tokën? «Po të qe toka e rrumbullakët, si një portokalle, dielli do ta kishte pjekur me kohë». Të jemi të sinqertë, me pikëpamjet shkencore nuk luhet kështu!

— Të mos e ketë thënë me shaka këtë?

— Me shaka? Më falni, po si mund të kuptohet shakaja në një orë mësimi? Mos vallë mua më paguan shteti për të bërë shakara me nxënësit?

Këtu ma mblodhi! Këtë burrë, shteti nuk kishte se si ta paguante për të bërë shakara me nxënësit! As me mua!

— Po a e dini se çfarë thotë për aritmetikën?

— Jo!

— Aritmetika — thotë — u duhet njerëzve të trashë, pasi ata që janë të zgjuar duhet t'i bëjnë hesapet me mend. Ja, dy e dy bëjnë katër.

— Që dy e dy bëjnë katër, kjo është e vërtetë!
— Thashë i hutuar.

— Unë nuk e hedh poshtë, po kjo do bërë me kalem. Përndryshe, përse prodhohen kalemata? Pastaj, të jemi të sinqertë midis nesh. A nuk dëshmon mohimi i kalemit për mohimin e shkencës në përgjithësi? Mirë, po kjo do ta dëmtonte seriozisht përgatitjen teorike të djalit tuaj.

Kështu, mësuesi kujdestar vijoi të më kumtonte një nga një sjelljet alarmante të tim biri, që mendoja se po më rritej si në inkubator!

Unë, që edhe me aq nuk i kisha të qarta konceptet pedagogjike, këtu m'u ngatërruan ca më keq. Por nuk duhej të ngutesha. Duhet dëgjuar të dyja palët, para se të përcaktosh fajtorin. Ky është një parim i lashtë i drejtësisë, pavarësisht se ç'konsideratë ka drejtësia për këtë parim.

— Si i ke punët me mësuesin kujdestar, Baton?

— Pyeta me autoritet tim bir.

— Oho, mrekulli, babi! Ai është shpirt njeriut! Dhe është i palodhur! Asnjë mësues tjetër nuk punon dot sa ai! Shpjegon, këshillon, mban shënime. Dhe kurrë nuk të qorton, babi! Fjala vjen, po qe se ti i nxjerr gjuhën dikujt, ai nuk të sikterris, por të thotë urtë e butë: «Gjuha, mor pëllumb, nuk është krijuar për të përqeshur shokët, po për të dalluar sheqerin nga zeheri». Po të vrasësh një mizë, ai ja fillon: «Mirë bëre, xhanëm, por mos harro se kjo është detyrë e shërbimit sanitar!

Ai kështu jo vetëm na mëson, por edhe na zbaton, babi. Vetëm për çudi, ai vetë kurrë nuk qesh! Ne me të vërtetë çuditemi, si bën shaka kaq të holla dhe vetë nuk qesh! Ku ta dish përse nuk i qesh buza? Përse thoni, babi?

Rrallë rastis që singeriteti i fëmijës të të ngrejë nervat. Dhe një nga këto raste të rralla u desh që ta provoja edhe unë.

Ndërsa Batoni më jepte shpjegime me buzën në gaz, unë përfytyroja mësuesin kujdestar, serioz dhe të tronditur me blok në dorë, i cili më numronte se sa miza kishte kapur gjatë një jave im bir, duke lënë kështu pa punë shërbimin shëndetësor.

...«Ne dendur e pyesim për ca gjëra, ku jemi të sigurtë se ai do të na bëjë të qeshim. Dhe qeshim. Po ai vetë meazalla se qesh! Çudi!»

Me të vërtetë pedagogjia është shkencë e vështirë! Dy herë u mata t'ja pristja fjalën Batonit dhe ta bëja rezil për hir të mësuesit kujdestar. Por, saherë që matesha, goja nuk më zërthehej. Po ç'qëndrim duhej të mbaja pra unë në këtë mes? Me mësuesin kujdestar, apo me tim bir?

Për këtë, ju drejtova këshillit pedagogjik të shkollës.

KORIJA E KRYETARIT

Toponomastika, për mendimin tim, e ka pisk punën. Ne e kuptojmë se sa vështirë është të zgjidhësh një enigmë të tillë si: «Përse filan vend quhet, fjala vjen «Hunda e Derrit»?

Përgjigja këtu do të ndërlikohej për vetë faktin se ky emër mund të jetë 400-500-vjeçar.

Po ka emra të tillë edhe më të lashtë. Po hajde, të lutem, e gjeju zanafillën këtyre toponimeve! Aq më keq kur nuk zberthen dot një toponim të tillë të ri, si: «Korija e Kryetarit».

* * *

Aty ku njëherë e një kohë fëshfërinte në verë «Korija e Kryetarit», tani po jepnin e merrnin disa gjeologë me hartën e rrethit në duar.

— Unë jam i sigurtë se «Korija e Kryetarit» ka qenë pikërisht këtu! Ja «Burimi i Sulos», ja «Pusi i Hallës», dhe ja «Përroi i Shelegut»! — tregonte me nervozizëm njëri nga gjeologët duke harruar se për të gjitha këto asnjë nga shokët e tij nuk e kundërshtonte. Për më tepër askush s'kishte faj pse nuk po dukej gjëkund mbi faqe të dheut «Korija e Kryetarit»!

norët e egër të pyllit. Për të mos e parë me sy këtë tragjedi, kryetari i hipi motoçikletës dhe ja shkeli me 70 në orë drejt qytetit. Nuk donte ta dëgjonte as krismën e sëpatave, se i dukej sikur po i prisnin gjymtyrët e tija. Kështu e bënte përherë ai. Sapo që lindte nevoja për të vënë sëpatën në pyll, kryetari ja mbathte për qytet një ditë më parë, se veshët e tij nuk e duronin dot breshërinë e sëpatave. Bile ai mallëkonte pse nuk qenë shpikur ende sëpata pa zhurmë (me amortizatorë).

Katër ditë pas kësaj hataje, kur stallat kishin hedhur shtat dhe koriya që eksiqosur për ibret, në zyrën e kryetarit dikush trokiti ngadalë me bishtin e sëpatës. Qe ai mjeshtri i madh, më i madhi i fshatit në përdorimin e sëpatës. Ai që vinte çerek i gërmuqur dhe si xhaxho.

— Hë, po ti, përse e fute kokën këtu? — E pyeti ashpër kryetari, duke parandjerë se tjetri do të kishte ndonjë kërkesë të drejtë dhe mallëngjyese.

— Unë, shok kryetar... shoku kryetar, unë... bile jo unë, po fëmijët e mi... ti e kupton se ke dhe vetë fëmijë... pra dimri po vjen... Stallat e lopëve, bukuri... po fëmijët e mi... kulmi i shtëpisë është kalbur, saqë me breshërin e parë do bëhet dërmile. Ju e kuptoni, kjo gjë nuk do u bënte mirë fëmijëve të mi, ju keni vetë fëmijë, apo jo?

— More, ja, ta zëmë se edhe unë kam fëmijë, po ç'hyn kjo këtu? Ç'dreqin kërkon nga unë? — Sërish kryetari e ruajti tonin e ashpër.

— Vetëm dy lëndë, shoku kryetar, ju betohem, për Abaz Ali, vetëm dy! Ja kaq, me nder, sa bishti i kësaj sëpate. Kjo është punë fëmijësh.

— Dhe ku t'i gjej unë këto? — pyeti kryetari tashmë i lëkundur lidhur me ashpërsinë e tij.

— Po ja, shoku kryetar, si ajo puna e stallave...

— Qysh? Të lutem shumë qepe gojën! Dhe qepe mirë bile! Jo si ato komçat e këmishave të gatshme! More shokë, po a jeni në vete ju? E shkatërruat pyllin, e shkretuat korijen, arin tonë të gjelbër... Oh, pylli im i dashur, o, e shtrenjta koriya ime... Kështu si e kanë zënë këta vandalë, do të vijë një ditë që vetëm kukumjaçkat do të këndojnë mbi trunget e prera. Ah, ç'njerëz pa zemër...

— Kryetar, shoku kryetar, po ç'janë këto, mor shoku kryetar? Për Abaz Ali, që s'janë gjë! Koqe kumi janë! Të zërë çatia kalamajtë e mi brenda, kurse pyjet e tua të rriten e të rriten gjer në qiell! Punë është kjo, shoku kryetar?! Ju keni kalamaj dhe vetë... duhet ta kuptoni... Kjo s'është punë kalamajsh...

I rrethuar nga pylli i tij dhe nga kalamajtë e tjetrit, kryetari u dorëzua. Fundi dy lëndë qenë. Duke mbushur sytë me lot për ato dy lëndë që ende s'ishin prerë, kryetari u ngrit e doli.

— Vetëm shiko! — Ju kthye fshatarit. — Kur t'i presësh, më lajmëro një ditë që të arratisem nga fshati. Se nuk i dëgjoj dot goditjet e sëpatave. Më copëtohet zemra, si ashkëlat e trungjeve.

— Si urdhëron, të lajmëroj unë, shoku kryetar — ja ktheu tjetri me gëzim. E pse të mos e lajmëronte, kur nga largimi i kryetarit ai dilte më i fituar në atë mes?!

«Për stallat ne premë 4-fishin e lëndës së nevojshme — filloi të arësyetonte me veten e tij mjeshtri i madh i sëpatës — po unë mos jam gjë budalla që të pres vetëm dy? Jo, për Abaz Ali, unë nuk jam as budalla dhe as hajvan...» Dhe, meqë nuk ishte as budalla e as hajvan, ai mbushi dy qerre me

lëndë. Për të mos rënë në sy një shfarosje si kjo, trungjet e prera i leu me bajga gjysmë të thata. Po edhe ato bajga nuk i mori nga ato të lopës personale, se mos i mbetej pa pleh kopshti personal. Ai i mori ato nga stalla e kooperativës.

Kryetari u kthye pas dy ditësh, por nuk e pa me vend t'i verifikonte në vend se sa trungje kishte prerë mjeshtri i madh i sëpatës. Ai nuk kishte zemër ta bënte një gjë të tillë. Ai do të mallëngjehej, do t'ja shkreppte vajit mu në mes të trungjeve të prera, gjë që pak hije do i kishte një kryetari si ai.

Dhe kjo që arësyeja kryesore që korija po qe-
thej «zero», si rekrutët. Bile në disa vende nuk qe-
thej, por rruhej si me brisk «Solingen» apo «Zhilet».
Se kryetari jo vetëm që nuk verifikonte sa dru qenë
prerë, por as vinte në dijëni teknikun e pyllit për
të bërë damkosjen.

Kështu, dita-ditës, person për person, sëpatë më
sëpatë dhe «Korija e Kryetarit» një ditë nga ditët
nuk fëshfërinte më. Sepse drurët nuk fëshfërijnë
me rrënjë, por me degë. Sytë e kryetarit u mbushën
me lot! «Kush e ka bërë këtë masakër? Ah, përse
nuk më prenë mua njërën dorë, apo njërën këmbë?
Apo makar të dyja? Përse pra?»

Shfarosja e korijes bëri bujë të madhe. Drejto-
ria e pyjeve e hodhi kryetarin në gjyq. Të tjerë nga
komiteti propozuan që kryetari, për riedukim, të
emërohej roje pylli...

«Kjo, o shokë, do të ishte ideale... Por unë, o
shokë, nuk e bëj dot këtë detyrë! E dashuroj shumë
pyllin! E dashuroj aq shumë, sa që, po gjeta njeri
duke prerë dru, unë me siguri që do ta vras! Bile
mund të vras deri më shtatë njerëz, po që se i kap



duke prerë dru! Jo, nuk dua të bëhem edhe unë kriminel».

Se ç'u bë më vonë me këtë kryetar dhe cili qe ky njeri, kjo humbi bashkë me legjendat e tjera. Vetëm në hartën e rrethit tonë ka mbetur emri «Korija e Kryetarit».

Ndërsa në njërin nga sirtarët e komitetit flet një vendim i tillë, i hedhur në letër:

«Të pyllëzohet me goditje të përqëndruar me fidana shelgu «Korija e Kryetarit» dhe t'i ndërrohet emri, për arsye se në pronën kolektive nuk duhet të ketë firma personale, kushdo qofshin këta persona!»

GJYQI NË PYLL

Roja e pyllit po bëhej gati të ngrihej e t'i hidhte një sy sektorit, se mos kushedi, kishte guxuar të dilte ndonjë kafshë nga strofka e saj, apo ndonjë sëpatë nga hauri. Po, padashur shtangu në vend.

Nga jaka e palltos e kishte mbërthyer paq një panxhë ariu dhe po e ngrinte lart, si të qe kërmill. Roja shqeu sytë nga frika dhe habia po nuk kishte ç'të bënte. Panxha e ariut po e shtrëngonte si me morsetë.

Langoi i tij nuk dukej gjëkundi, le që edhe sikur të dukej, çfarë mund t'i bënte ai një ariu të tillë. Roja nuk mund as të fliste dhe as të ulërinte. Duart i vareshin pa fuqi.

Ariu, si e shkëputi nga toka, e vërtiti rojen dy metra pas vetes në këmbët e dy derrave të egër dhe të një cjapi elegant e po aq të egër. Me sa dukej të tre ata ishin sejmenët e ariut.

Sejmenët e mbërthyen sakaq rojen fatkeqe dhe e lidhën duar e këmbë. Pastaj cjapi i egër e mori në shpinë dhe bënë tutje përmes pyllit. Prapa vinte rëndë-rëndë e madhështor ariu.

Pylli ishte i qetë! Por kjo qetësi, ndryshe nga herët e tjera, e tërbonte rojen. Ai priste të dëgjonte

zhurmë, hapa, të shtëna. Vetëm diçka e tillë do të mund ta shpëtonte nga taksirati. Por, pylli heshte si një piano e mbuluar. As zhurmë, as hapa dhe as të shtëna.

Cjapi i egër po e mbarte me devocion ngarkesën e tij dykëmbëshe. Sepse kështu e duan kanunet e pyllit.

Rrugës turma u shtua. Nga pylli dilnin dhel-përa, sorkadhe, ujqër, ketra e bile edhe lepuj! Ke parë ti? Edhe lepuj! Dhe as që u bënte tërr syri.

Pse, do të thuash ti? Vetëm pse nuk mund të përdor çiften! Po, hë, hë, sikur ta kisha, të gjithë këta zuzarë nuk do të gjenin vend të futeshin!

Turma e kafshëve sa vinte e shtohet! Vinin si në shtëpinë e tyre!

Roja, bile, po çuditej nga mbiu gjithë kjo mori kafshësh në një kohë kur çiftja e tij bënte kërdrinë në pyll e në koriye... Si kishin mundur të shpëtonin gjallë gjithë këto?

— E paskan kapur më në fund edepsëzin — pëshpëriti një ketër.

— Ai nuk është i pakapshëm. Duket që nga mustaqet!

— Tani besoj se do t'ja ndreqin samarin!

— Epo, boll ka shirë mbi brinjët tona...

Në mes të pyllit turma ndali dhe qarkoi rojen e pyllit, i cili nuk po merrte vesh akoma se ç'që e gjithë kjo. Si guxonin t'i afroheshin ashtu ato kafshë që gjer dje merrnin lemerinë me të parë atë dhe çiften e tij.

— Gjyqi do të bëhet këtu — hungroi ariu. — Ujku do të jetë prokuror, dhel-përa në mbrojtje dhe çakalli me baldosën gjykatës.

Sakaq, të emëruarit zunë menjëherë vendet, du-

ke treguar kështu një rregull dhe një disiplinë shenibullore. Çdo gjë qe gati.

Ujku shpalosi një dosje të madhe, ndërsa ariu, në shenjë respekti për fillimin e gjyqit, shua jti llullën me putrën e tij.

— I pandehur! Akuzohesh se ke shpërdoruar tepër rëndë postin tënd të lartë si roje e pyllit dhe e faunës së tij. Krimet e tua janë aq të shumta, sa dhe drurët e këtij pylli, por ne këtu nuk do t'i biem njëri gozhdës e tjetri potkoit. Do të përmendim krimet më barbare, të cilat do të na bindin për ndëshkimin që ti meriton.

Pa dashur ta zgjatim shumë me një kriminel profesionist, po numrojmë krimet më në zë e më të llahtarshme që ka parë fauna e këtij pylli.

— Ke zhdukur me shumicë, pa kriter dhe pa mëshirë, skotën e lepujve mishëmbël, pa respektuar as kalendarin e gjuetisë.



— Jo vetëm që i ke vrarë lepujt, por shpesh ua ke hedhur qenve mishin e tyre, duke e dyfishuar kështu zullumin.

— Jo vetëm që ua ke hedhur qenve, por shpesh nuk i ke lënë as ata të hanë gjer në fund.

— Ke qëlluar mbi dhelprat, por jo me qëllimin fisnik që të shpëtosh pulat e fshatit, por vetëm e vetëm për lëkurën e tyre të bukur e të kushtueshme. Edhe këtu ka ngritur krye interesi personal dhe jo ndjenja e detyrës.

— Me të njëjtat motive ke qëlluar edhe mbi kunadhet. Pavarësisht se shpesh nuk ke qëlluar në shenjë. Kjo nuk dëshmon për humanizëm.

— U ke rënë më qafë më shumë nga ç'duhej, thëllëzave, mëllënjave, turtujve dhe s'ke patur fare konsideratë për mishin e laraskave dhe të sorrave,



duke fyer kështu gjithë skotën e tyre me pupla e me sqep.

— Je treguar mjaft burracak, meqë asnjëherë nuk e ke ngritur dorën mbi ujit, duke e ditur mirë rrezikshmërinë e tyre shoqërore.

Për të gjitha këto, për ato që nuk përmenden këtu dhe për ato që nuk do të përmenden asnjëherë, pa dashur ta zgjat më tej frymëmarrjen e një krimineli, i propozoj të nderuarit trup gjykues këtë ndëshkim:

— I pandehuri të dënohet me vdekje, duke u varur në bishtin e dhelpërës, me qëllim që të mos ndjejë shumë tortura.

Trupin e rojes e mbuluan djersë të ftohta. Këtë gjyq ai nuk e priste. Shpesh mendonte se e kishte tepruar zullumin po, që të arrinte puna gjer këtu, kurrë nuk ja kishte prerë mendja.

Po ja që sot i erdhën të dyja: gjyqi dhe vdekja! Sikur ta kishin bërë me fjalë që më përpara!

Trupi gjykues u ngrit më këmbë. Roja hëngri një shkelm nga prapa. I egri cja, i tha:

— Kur jepet vendimi, qëndro si qiri!

Të pranishmit kishin të gjithë nga një çifte si ajo e rojes. Mbi të u drejtuan të gjitha grykat dyshe të çifteve. Gjithësecila, me sa dukej, kërkonte pjesën e saj.

Vendimi i gjyqit ishte më i mëshirshëm: Roja dënohej me pushkatim, duke u kthyer mbi të të gjitha grykat e zjarrit që mbanin kafshët e pyllit.

Por, sa shkrepri çiftja e parë nga thonjtë e një lepuri, (të cilin ai dikur e pati plagosur rëndë) roja u hodh përpjetë dhe, u... zgjua! Fërkoj sytë me kujdes dhe u sigurua se me të vërtetë qe zgjuar! Kjo kishte rëndësi të madhe.

Përreth nuk dukej as gjyq dhe as kafshë, ndër-
sa djersët e ftohta e kishin mbuluar me të vërtetë...
«Si duhet kup^tuar kjo? Mos vallë e kam tepru-
ar? Mos duhen marrë më shtruar këto gjëra?» —
pyeti ai me vete, duke menduar përse çiftet janë me
dy dhe jo me katër gryka!

HUNJTË E FASULEVE

Sa dendur na ka qëlluar të dëgjojmë në jetë shprehjen «hu gardhi»! Bile, në shumë raste, kjo nuk thuhet vetëm për hunjtë e gardhit. Ndërsa mjaft rrallë mund të kemi dëgjuar të thuhet «hu fasulesh»! Ndoshta kjo ka ardhur edhe sepse dikur te ne ka patur më shumë hunj gardhi se sa hunj fasulesh. Se njerëzit kujdeseshin më shumë për gjerdhct se sa për fasulet.

E, megjithatë, ishin po ata hunj! Po, se ç'rëndësi të posaçme marrin hunjtë sot në agroteknikë, këtë do të përpiqem ta zbërthej seriozisht brenda kufive të këtij shkrimi.

* * *

U mbush një javë që kisha ardhur me shërbim në kooperativën bujqësore të cilën na e kishin dhënë në patronazh, por asnjë ditë nuk u bëra mbarë të dilja për gjah!

Është e vërtetë se unë nuk jam aq i krisur pas gjahut, si disa që njoh, por kjo nuk mund të bëhet

shkak që unë të rri një javë duarkryq, kur jam në një zonë të lejuar për këto punë.

Merret me mend se edhe çiftja ime gjatë kësaj kohe nuk munda t'ja bënte «bam», pa e marrë unë së pari një inisiativë të tillë. Por shpesh punët të rrëmbejnë me një ritëm të tillë, sa që nuk të del fare kohë, as për gjueti dhe as për piknik!

Ka të tillë amatorë gjuetie (se me profesionistët puna ndryshon) që, pasi kanë mbushur javën pa gjuajtur, venë e shtrohen në spital.

Ne ishim vazhdimisht të zënë me problemet e bujqësisë e të blegtorisë. Po sidomos me blegtorinë. Këtu punët nuk venin fort mirë. Sa mbaronim me derrat, duhej të ktheheshim nga mushkat, po ne s'mund të rrinim me to gjithë javën, pasi kështu do t'u mbetej qejfi dhive dhe pelave.

Te shpendët na u desh të ndaleshim ca më gjatë. Jo vetëm pse ato kanë mish të shijshëm, por edhe pse punët në atë sektor venin më lumë se kudo! Lumë e det, bile!

Ishin keq me planin e vezëve. Nga 14.000 kokrra vezë që duhej të dorëzonin, vetëm 2.600 qenë realizuar. Siç shihet, defiçit i madh.

Rreth kësaj pike u bënë mjaft diskutime, sa serioze aq dhe të bujshme. Qe defiçit i madh! Kjo dukej sheshit! Asnjëherë nuk ishte parë një defiçit i tillë i madh në këtë kooperativë.

Të gjitha diskutimet ishin dobiprurëse po, për mungesë vendi, unë do të jap vetëm një, të riprodhuar ashtu siç e dëgjova, duke rregulluar me sa të mundem vetëm shënjat e pikësimit. Flet brigadieri i blegtorisë:

— Pa tjetër që kushdo ka të drejtë ta bëjë një

pyetje të tillë: Përse del gjithë ky deficiet? Edhe unë ja kam bërë shpesh vetes këtë pyetje. Dhe kushdo tjetër e ka këtë të drejtë. Jo të drejtën për të dalë deficiet, po të drejtën e pyetjes mbi deficietin.

Pas kësaj pyetjeje do të dalë një tjetër problem për t'u sqaruar: Kush përgjigjet për këtë deficiet?

Po ta marrim hollë, hollë, duhej të përgjigjeshin pulat, por, meqë ato nuk kanë ndër mend të përgjigjen ndonjëherë, më bie mua një barrë e tillë, si brigadier i tyre, domethënë i blegtorisë.

Ka një gjë në këtë mes. Vezët numrohen me kokrra. Dhe kjo është një e keqe jo e vogël. Se në këtë mënyrë pulat rendin pas sasisë, duke lënë pas dore cilësinë. Kështu dekurajohet edhe stimuli moral.

Por pulat tona nuk kanë shkelur në këtë dërrasë të kalbur! Ato kanë patur parasysh mbi të gjitha cilësinë. Po ta krahasosh vezën e pulave tona me një vezë pule nga kooperativat e tjera, kjo e fundit do të të duket si veza e harabelit pranë vezës së patës.

E pranojmë se pulat tona bëjnë pak vezë, por hakun mos t'ua hamë, (siç mund të hamë mishin e tyre) ato bëjnë vezë të mëdha! Për këtë, aferim u qoftë! Por nga kjo ne mbetemi deficiet me planin!

Çfarë të bëjmë? Vezët nuk mund t'i ndajmë më dësh. As më katër. Vezëve nuk mund t'u shtiem as ujë, siç bëjnë me qumështin disa të pacipë.

Unë propozoj që për rastin tonë të gjendet kjo rrugëdalje: Vezët të mos i numrojmë me kokrra, por t'i peshojmë me kilogram. Ose t'i matim me litra, apo me metra kub! Atëhere do na shikonit ju: Do ishim deficiet, apo sufiçit me planin. — Dhe brigadierit u ul hijerëndë në karrigen e tij, që vinte e pesta pas asaj të kryetarit.

U vendos që ky propozim t'i kalohej për kompetencë komitetit ekzekutiv, seksioneve të blegtorisë dhe të tregëtisë.

Sapo dolëm nga mbledhja, kryetari më rrahu supin e majtë dhe më tha:

— Tani do të dalim për gjah!

— Për gjah! Me gjithë qejf, po nga do ja mbajmë? — E pyeta me gëzim.

— Këtu afër. Tepër afër.

— Si, kaq afër? Nuk shikoj asnjë pyll dhe asnjë gëmushë në tre kilometra rreth e rrotull.

— Nuk shikon vërtet, po kjo s'ka rëndësi. Do të gjendet diçka më e përshtatshme për të tilla punë.

— Pa hë, ç'është kjo?

— Prit, de! Rrugës do ta mësoh.

Hodhëm çiftet në krahë dhe me zagarin e kryetarit në krye zbritëm poshtë arave. Unë ecja i habitur dhe dy-tri herë desh theva qafën. Por këto raste më vlejten ta mblidhja rradaken, përpara se ta shtrembëroja në ndonjë monopati.

Isha i hutuar, po me të drejtë. Ku do të gjuajmë kështu? Se unë nuk di të gjuhet ashtu në tym. Pa pyje, pa gëmusha, pa ferra! Del nganjëherë lepuri i madh në ferrë të vogël, po këtu nuk kishte as ferra të vogla!

Kjo gjë më çudiste edhe më shumë edhe për një arësye tjetër. Kryetari më ankohej vazhdimisht se kishte shumë ferra nëpër këmbë! Po ku qenë vallë këto ferra? Hajde gjeje! Ja pra, që nganjëherë njerëzit ankohen pa shkak!

— Ti the se ku do t'i gjejmë ferrat? — Pyeti kryetari.

— Jo, po ku do të gjuajmë!? — e korrigjova unë.

— Do të gjuajmë në fasulet pllaqi.

— Si? — pyeta unë i çuditur, pa dashur t'u besoja veshëve.

— Oh, kjo është një histori e gjatë! — vazhdoi, duke më çuditur edhe më tepër. Se, sado e gjatë që të ishte ajo lloj historie, ç'kishte të bënte me fasulet pllaqi?

— Ne këto fasule i mbollëm për herë të parë. Morëm udhëzimet në komitet dhe farën nga dega e farnave. Pastaj i mbollëm. Donin toka me pjerrësi nga veriu. Duhet të rriheshin nga erërat. T'i zinte dielli. Dakord qemë dhe ne me këto, por e gjithë hataja erdhi nga hunjtë!

— Pse, nuk krisi huri? — Pyeta me dyshim.

— More, huri krisi që ç'ke me të, po ç'e do se që me vonesë! E kishte marrë ferra uratën! Pastaj, krisi i tëri mbi kurrizin tim!

Hunjtë për këto lloj fasulesh duheshin nga 3-4 metra të gjatë. Kurse ne ngulëm ca hunj të vegjël, sa për okllai, bile shpesh sa një bisht tigani. Dhe fasulet harbuan për kiamet! Po ç'e do, s'kishin ku të ngjiteshin.

Dhe erdhën e t'u bënë gëmusha-gëmusha! Edhe bualli mund të fshihet tani në to, e jo lepuri! Bishtaja kanë zënë sa të duash, si rrush, po ç'e do! Dielli s'i kap, era nuk i rreh dhe ato nuk po piquen dot! Dhe as që kanë ndër mend të piquen! Dhe nuk mbollëm pak, po 20 hektarë. Nga 25 kuntalë për hektar venë 500 kuntalë, ose 500.000 lekë të ardhura. Ky është një deficiet shtatë herë më i madh se ai i vezëve.

— Po, atëhere, përse nuk u diskutua ky lloj deficieti?

— Ehu, sa herë është diskutuar! Po ç'e do! Na puthi halla në të dyja faqet!

Ndërkohë zagari i kryetarit filloi të lehte. Gjhtarët duhet të kenë vënë re se ka lloj-lloj të lehurash! Kurrë nuk gjen dy të lehura të njëjta! Kjo vjen ngaqë zagareve nuk ua ka ënda të përsëritin po ato gjëra.

Por i zoti nuk e kupton dot zagarin e tij. Dhe shpesh kthehet duarbosh, pa i vajtur ndër mend se faji është i tij dhe jo i zagarit.

Kishim arritur te fasulet pllaqi. Me të vërtetë ato qenë shndërruar në gëmusha! Hunjtë nuk duke-shin fare, megjithëse kryetari thoshte se qenë sa një bisht tigani.

— Deri tani kemi vrarë mbi 35 lepuj, tri dhel-përa dhe një derr të egër. Pra, nuk na ka shkuar për dhjamë qeni e gjithë fara e fasuleve!

Ndoshta mund të kishim vrarë më tepër, sikur të kishim mbjellë nja dy hektarë më shumë fasule pllaqi dhe sikur të kishim dalë më dendur për gjah.

— Justifikohej kryetari.


Zagari dha alarmin. Para nesh kaloi si erë një lepur. Qëlloi kryetari, po pa marrë shënjë.

— Nuk prish punë! U shfajësua ai. — Do të dalin të tjerë lepuj sa të duash. S'kanë ku të venë. Sidomos tani që u korrën edhe misrat.

Pasi vramë tre lepuj dhe plagosëm dy të tjerë (këta të dy i patën nga unë kujtimet), u futëm brenda në parcelë. Ishte një xhungël e vërtetë! Aq, sa fillova të tronditesha... Po sikur të na dilte ndonjë tigër?

Dhe ja, diçka e zezë hungronte para nesh. Zemra filloi të më rrihte me forcë... Qëndrova dhe ngrita ngadalë çiften. Po kryetari më uli krahun dhe ho-
vin!

— Mos u tremb! Ai është brigadieri i perimeve



të thata. — Sqaroi kryetari. Dhe filloi. — Bën kurën e gjumit. Mos ja prish pushimin!

Pas një hungri të llahtarshme, që mua më ngriti qimet e këmbëve përpjetë, brigadieri i perimeve të thata u ngrit. Dukej tamam si mbreti i kësaj xhungle. Po ta matje gjatësinë e trupit të tij, të dilte afërsisht dy hostenë, ose tre hunj të zakonshëm.

Fërkoj sytë, u shtriq, gogësi si një motopompë dhe u nis drejt nesh.

U miqësua shpejt. Brigadieri i perimeve të thata kishte gjak të ëmbël. Ja hodha fjalën rreth fasuleve pllaqi.

— A e besoni? Duheshin hunj dy herë sa unë! Punë është kjo? A e besoni? Të jetë huri dy herë më i gjatë nga brigadieri? Punë është kjo?

Pra, i gjithë faji ynë qëndron te hunjtë! — U shkarkua ai.

— Këtë e besoj pa ma thënë ju! — Ja prita.

— Pse besoni kështu?

— Sepse, siç e tha edhe kryetari, huri duhej të kishte krisur me kohë!

Ndërsa kryetari shtoi me një pamje filozofi:

— Jo më kot, Nastradin efendiu e rrihte të bijën përpara se ajo ta thyente qypin. E çfarë t'u bëj unë tani këtyre qypave? — Pyeti ai, duke mos e përcaktuar se për cilët qypa ishte fjala.

INISIATIVAT E BARDHI

Bardhi kishte vendosur që përherë pyetjet t'i mendonte dhe t'i shoshiste mirë dy ditë përpara se t'i bënte. Duke vepruar kaq me maturi, ai kishte arritur të bëhej shembull në kolektiv për pyetjet me vend që bënte aty-këtu sipas rasteve dhe problemeve.

Po ja që atë ditë i doli një problem i papritur. Për atë problem aq të papritur, lindi një pyetje e papritur, për të cilën Bardhi nuk kishte parashikuar të mendohej dy ditë më parë.

Duhej të lëvizte një traktor nga Kooperativa Bujqësore e Bregasit në atë të Lumasit. Por, si zakonisht, më parë se të bëhej një veprim i tillë me përgjegjësi, duhej pa tjetër të pyeteshin shokët e komitetit. A ishin dakord ata me një lëvizje të tillë? A e lejonte situata konkrete këtë lëvizje? Mos duhej dërguar ndonjë i deleguar fuqiplotë për ta vëzhguar këtë lëvizje në terren?

Mos vallë duhej pyetur edhe më lart se shokët e komitetit? E përse fundi i fundit të mos merrej edhe pëlqimi telefonik i Ministrisë së Bujqësisë për një lëvizje të tillë? Mos kishte ndonjë gjë të keqe në këtë mes?

Ashtu de! Po kujt i duhet telefonuar së pari në

komitet? Shefit të bujqësisë, nënkryetarit, apo vetë shokut kryetar? Edhe kjo e ndërlikon akoma më tepër çështjen!

Po si duhet formuluar pyetja? Se edhe kjo gjë ka rëndësinë e vet taktike dhe praktike... Për një pyetje me peshë, ka shumë të ngjarë që të ngrihesh në përgjegjësi, ose t'i shpëtosh qarkullimit. Është e vërtetë se ende nuk njihet ndonjë rast i tillë, por, kjo s'do të thotë se nuk ka mundësi të ndodhë.

Bardhi nuk arriti dot të vendoste brenda orarit zyrtar, nëse duhej ta bënte një hap të tillë dhe të pyeste për lëvizjen e traktorit, apo jo! Fundi, duhej bërë diçka edhe për orët e lira!

Lëvizja e traktorit nuk paraqitej urgjente. E si kishin vepruar vallë fshatarët përpara se të shpikkej traktori?

Njeriu shpesh e ka të vështirë të lëvizë një karrige nga një zyrë në zyrën tjetër, e jo më të lëvizë goxha traktor të rëndë sa 54 kuaj nga një kooperativë në tjetrën.

Ai doli nga zyra me ndërgjegje të qetë dhe po me atë lloj ndërgjegje u fut në kuzhinë. Kreu me sukses detyrimet karshi drekës, pastaj kërkoi mendimin e së shoqes përsa duhej të pyeste.

E shoqja vuri buzën në gaz dhe ja ktheu:

— Ti, Bardhi, përherë pas buke bën shaka të holla!

...Dhe hajde pastaj e kërkoi mendimin e grave, të lutem! Po ato nuk të kuptojnë, mor byrazer! Ato nuk i kuptojnë dot problemet operative... Ja, ti i bën një pyetje me karakter tepër serioz, kurse ajo mendon se ke bërë shaka me të... Se si do t'i emancipojmë këto gra, hajde e merre vesh...

Të nesërmen Bardhi vendosi ta shtronte pyetjen pranë shokëve të komitetit. I ra numrit të shefit të bujqësisë! Ku të dilte le të dilte. Fundi shokët e seksionit duhej ta dinin se ai interesohej konkretisht dhe praktikisht për mbarëvajtjen e bazës.

Shefi i bujqësisë nuk ishte në zyrë. Zëvendësi i tij ja preu shkurt dhe fare pa takt Bardhit:

— Bëni çfarë të doni, shok! Unë nuk jam dispeçeri i SMT-së!

Ja, dhe kjo një fjalë goje ishte. Të bëje çfarë të doje! Po kush duhej të mbante përgjegjësi për një bëmë të tillë, se!

Pasi nuk pati sukses me seksionin e bujqësisë, Bardhi mendoi të pyeste ndonjë person tjetër më me përgjegjësi brenda për brenda komitetit. Se kështu edhe problemi nuk dilte jashtë.

I telefonoi nënkryetarit të komitetit. Biseda u zhvillua sipas këtij dialogu të padëgjuar gjer atëherë:

— Shoku nënkryetar! Kemi një problem të koklavitur që sapo na lindi. Duhet të lëvizim një traktor nga Kooperativa Bujqësore e Bregasit në atë të Lumasit. Si mendoni ju tani, a është oportune në momentin aktual një lëvizje e tillë?

— Alo, shoku Bardhi! Përsëriteni më ngadalë pyetjen tuaj, pasi mua më ngjan si shumë interesante dhe dëshiroj ta mbaj shënim!

Bardhi, që e hëngri pa përtypur atë koqe ulliri, ja përsëriti pyetjen me besnikëri dhe ngadalë. Dhe mori këtë përgjigje të ngatërruar:

— Shoku Bardhi, mos u bën merak. Unë tani u futa në brendësi të problemit. Pas ndonjë jave do të dal vetë andej nga SMT-ja dhe do t'jua jap përgjigjen në dorë! — Me kaq telefoni u mbyll...

Kjo përgjigje e ngatërroi edhe më tepër shokun Bardhi! Mos tallej kështu nënkryetari, apo e kishte me gjithë mend?.. Bah, e përse të tallej? Çfarë kishte këtu për t'u tallur? Le që shoku nënkryetar njihej si burrë serioz dhe nuk kishte përse të tallej në telefon gjatë orarit zyrtar.

Bardhi mendohej se kë mund të pyeste pas kësaj. Mos duhej marrë një inisiativë tjetër për të pyetur shokun kryetar të komitetit? Po a nuk dukej pak si e guximshme, pak si e krisur një inisiativë e tillë? Ç'mund të përgjigjej vallë shoku kryetar?

Më në fund ai kuturisi...

— Alo, shoku kryetar?

— Jo, jam dublanti...

Kjo e ngatërroi edhe më shumë Bardhin. Në telefon doli dublanti. Ai nuk kishte folur asnjëherë me dublantin! Nuk dinte si t'i drejtohej... Dublant, apo shoku dublant, apo...

— Urdhëroni, ju dëgjoj!

— Jo, më falni, kam gabuar numrin! Desha të merrja kryetarin e Kryqit të Kuq! — këputi në tym Bardhi dhe mbylli telefonin.

...Po tani kë të pyeste?.. Mos duhej marrë pëlqimi i kryetarit të gjykatës, apo i kinoteatrit për lëvizjen e traktorit?

Eh, sa keq kur ke një pyetje dhe nuk di kujt t'i drejtohesh... Dhe për më tepër, askush nuk të sqaron!..

Si e pa që shpresat për një përgjigje telefonike po dështonin njëra pas tjetrës, Bardhi vendosi të ndërmerre një inisiativë tjetër me përgjegjësi: Të shkonte vetë në Kooperativën Bujqësore të Bregasit dhe ta shikonte çështjen në vend. Dhe po në vend të vendoste pa pyetur fare njeri!

U ngrit, i hipi motoçikletës dhe fluturoi me 22 kilometra në orë! Ai e kishte si parim, kjo që shpejtësia e tij maksimale për rastet tepër urgjente!

Nga larg dalloi edhe traktorin në fjalë edhe traktorist Çomen që i tundte kasketën në erë. Ai po plugonte.

«Do ta sikterris», mendoi me vete Bardhi! «Ma tund kasketën sikur të kemi qenë shokë klase! Do t'i them përse të mos jetë nisur akoma për në Lumas! Vërtet që nuk ka patur ndonjë urdhër për një punë të tillë, po përse të mos ndërmernte edhe ai një iniciativë si kjo imja dhe të nisej pa pyetur njeri?»

— Çome, po ti përse nuk je nisur akoma për në Lumas?

— A, ç'tallej dhe ti, o shoku Bardhi! Unë kam dy orë që jam kthyer nga Lumasi! Se mos kishin patur ndonjë punë të madhe ata!

— Si? Ti ke vajtur dhe ke ardhur? — pyeti me habi Bardhi.

— Kështu më duket edhe mua! — ja ktheu me të qeshur tjetri.

— Po ku e more një urdhër të tillë, xhanëm? — pyeti Bardhi, por e pa se edhe kjo pyetje ishte pa vend.

Bëri me motoçikletë një kthesë prej 180 gradësh dhe mori rrugën e kthimit i vendosur që këtej e tutje, sido që të vinte puna, ai nuk do të pyeste më vend e pa vend për vogëlsi të tilla.

PROJEKTET E GËZIMIT

Gimi i mbledhi një nga një copat e letrave ku genë shënuar të gjitha mendimet, kërkesat dhe propozimet e punonjësve, u vuri nga një numër në krye, i palosi me kujdes dhe i futi në dosjen që priste posaçërisht për këtë mision.

Vështrimi i shpejtë dhe i rrufeshëm që u hodhi të nesërmen këtyre materialeve, vërtetoi edhe një herë parashikimet e tija.

Fryrje kishte, teprime kishte, ç'donte më shumë ai për të përdorur gërshërët e tija, të cilat kishte kohë që po i prifte për këtë ditë.

Ç'pandehnin njerëzit? Mos vallë ai, Gimi, do u lëshonte rrugë kërkesave të tyre, ashtu siç mund t'i lëshosh rrugë trenit?

Ja ku kërkokan dy torno, një frezë dhe një dekovil për të ngritur një linjë të brendshme. Pse punë është kjo? Si mund të mjaftojnë kaq pak gjëra për një linjë të re? Pse kështu duhet të ndihmohet kooperativa jonë? Mos vallë me kaq pak ne mund të fillojmë nga prodhimet industriale, ashtu siç jemi zotuar? Jo, jo, të gjitha këto duhen përmbysur. Nëse nga ne kërkohen prodhime industriale, ja përse kemi nevojë ne:

— Katër torno, dy freza dhe një trapano.

— Një gur zmeril për kovaçanën dhe një çekan pneumatik.

— Pesë linja dekovili për të lidhur pesë sektorët e kooperativës me qendrën. Dhe këto sa më moderne.

— Jo një kombinat sharre, siç mendoka brigadier i ndërtimit, por një kombinat druri. Pse, pak drurë ka këtu? Apo mos nuk dimë ne ta përdorim drurin? Kush nuk beson, le të vijë në mbledhjet tona...

...Hëm... po më?.. Sikur të merrnim ca far-na të zgjedhura nga Afrika... Thonë se edhe në Australi ka hibride të famshme. Edhe nga Kanadaja diçka duhet të kërkojmë... Si dreqin nuk kalon një lumë në mes të fshatit? Kështu do të kishim gojë të kërkonim një vapor ose së paku një anije peshkimi... Hë, sa për anijen e peshkimit, fare mirë mund ta shënoj, pasi ne kemi rezervuarin prej 3 km³. Është e vërtetë se aty ne nuk kemi hedhur akoma rasatet e peshkut, por kjo do të bëhet me kalimin e kohës. Ndërsa një anije peshkimi në projektkërkesën tonë do të na ngrinte shumë... Mjafton që njerëzit atje sipër nëpër komitete apo ministrira të marrin vesh se ne ua dimë emrat këtyre maqinave moderne dhe të ndërlikuara. Ata nuk duhet të pandehin se ne hamë bar këtu në fshat...

...Po sikur të kërkojmë edhe një helikopter?.. Duke e lidhur këtë kërkesë me nevojën e një kontrolli operativ mbi sektorët që i kemi kaq larg nga qendra! Hëm... ta kërkojmë apo jo? ..Po sikur të bëhemi qesharakë... Eh, sikur ta dinim nëse ka kërkuar dhe ndonjë tjetër diçka të tillë... Atëherë do ta shënoja pa ma bërë syri tërr...

...Hëm... Ç'mund të kërkonim tjetër... Një

varrezë moderne kafshësh. Fondet e nevojshme për këtë, materialet e ndërtimit... Vërtet se nuk kemi pothuaj asnjë ngordhje në blegtori, por ama, varrezat duhen, qoftë dhe për dekoracion... T'i jepnin vendit një pamje sa më simpatike.

Kështu Gimi hartoi një projektkërkesë madhështore, duke mbushur një formular që mund të krahasohej me plastmasin e një shtrati për domatet e hershme.

...Sa t'i hedhin një sy këtij projekti dhe do të mendojnë më seriozisht për ne... Do të kuptojnë se edhe ne marrim vesh nga bota dhe nga jeta... Edhe ne i dimë disa emra të ngatërruar nga shkencat dhe nga teknika moderne... Dhe, ku ta dish, ndoshta edhe për mua njerëzit nga lart do të mendojnë më seriozisht... Përse këtë kuadër kaq të përgatitur ta lëmë në një kooperativë.? Po sikur të më thonë, «urdhëro, shoku Gimi, merr në dorë tani seksionin dhe bëj si të dish... Ti për ne i ke kaluar me sukses këto prova...

Jepi, pra, jepi, Gimi... Daltë për mbarë e gjithë kjo...»

Dhe Gimi i dha me të gjitha forcat. Bëri një relacion në stil panegjirik mbi projektin e vet dhe, duke marrë parasysh rezultatet e mira, i vuri zarfit të madh tri vula...

Tashmë Gimi priste si në ethe përgjigjen, apo jehonën e relacionit të vet madhështor dhe historik. Dhe ja, një ditë i telefonuan nga komiteti... Ai duhej të paraqitej urgjent aty...

Po, ai këtë e priste... për këtë ai qe i përgatitur... Ai duhej të thirrej me urgjencë... Sepse mungesa e tij ndjehej për rastet më urgjente... dhe ai u nis me urgjencë...

«Projekti yt është i habitshëm!» — I thanë në komitet, por kaq gjë ai e dinte më mirë nga shokët e komitetit. Ai e dinte se pikërisht kështu do t'i thoshnin. Përse të mos qe i habitshëm projekti, kur ai kishte shkrire të gjitha energjitë për këtë punë?

«Është pak si qesharake që ju keni vënë 100.000 copë tulla dhe tjegulla për ushqim kafshësh... unë nuk e di që të ketë kafshë të cilat të ushqehen me tulla, apo me tjegulla! Nuk di çfarë kafshësh të çuditshme qenkan ato të fshatit tuaj... Nejse, këtu mund të ketë ndonjë gabim versioni... po ja, më poshtë ju kërkoni 13 kv. mjaltë për meremetim banesash... Nejse, edhe këtu mund të ketë gabim versioni... po rakia, ç'kërkon në fermën e pulave?... Po tagjia në mensën e kooperativës?... Kush ha tagji nga ju në mensë?

Gimit ju kthye peshku i kurrizit në ulluk... Po, po, shoku i komitetit kishte të drejtë... ashtu qe... ai kishte nxituar... vetëm e vetëm që relacioni i tij të mbërrinte i pari në komitet... dhe ja kishte futur roma për toma... Sidoqoftë edhe versionet e kishin ngatërruar shumë... Tulla për ushqim kafshësh... Po sikur ta merrte gazeta këtë mesele? Dhe ajo na duhet... Por, jo... ishalla çështja nuk vete deri atje...

«...Pra, Gimi, mblidhi lecat, ose më mirë formularët, thuaj, dhe nisu nga erdhe...»

Kështu, Gimi, duke marrë me vete tornot, frezat, anijet dhe helikopterët e tij, mori rrugën për në bazë.

JETA DHE SHKENCA

(Fjalë për kërkimet)

Natyrisht që fjala për kërkimet duhet të specifikohet disi sepse, siç dihet nga eksperiencia, ka disa lloje kërkimesh. Ka kërkime gjeologjike, arkeologjike, bërthamore, minerale, e tjera. Ka dhe kërkime burokratike, por këto nuk janë ndarë ende më vete, megjithëse për nga volumi i kapërcejnë llojet e tjera të kërkimeve.

Dhe, për t'i ardhur në ndihmë kësaj ndarje të vonuar, ne do të ndalemi pikërisht këtu. Kjo ngjarje mund të merret edhe si argument shkencor, edhe si fakt konsultativ, edhe si dokument historik. Kjo lihet në dëshirën e vetë lexuesit. Ne do të përpiqemi që faktin ta japim ashtu siç është dhe siç e lyp saktësia shkencore në këto raste.

* * *

Agim Kabashi kishte mbështetur bërrylin mbi skrivani dhe po shtjellonte një mendim të madh në kokë. E gjithë vështirësia qëndronte aty, se ai nuk

po e nxirrte dot nga koka atë mendim të madh. Ndoshta nga volumi, ndoshta nga madhështia, përfundimi mbetet po ai: mendimi nuk po kapej.

Ka shumë njerëz me mendime të mëdha, por që u mbeten në kokë derisa i marrin me vete edhe në atë jetë. Këta kanë nevojë për mami, profesion ky jo fort i përhapur në përpjesëtim me kërkesat. Sigurisht që këtu bota ka se ç'të humbasë.

Meqë Agimi nuk po e nxirrte dot atë mendimin e madh, e la për më vonë dhe u hodh në një tjetër mendim me rëndësi: «Ku do ta kalonte pasditen? Me «Babetën që shkon në luftë», apo me «Lozonjaren»? Sepse dje nuk shkoi dot as te njëra dhe as te tjetra, meqë kudo luante filmi: «Ruhuni nga gripi».

Sakaq u hap dera.

Kadri Lami hyri brenda me një pamje që pak i ngjante mamisë së përfytyruar nga Agimi.

— Kam ardhur për atë propozimin tim.

— Ah, po! Lidhur me atë transportuesin pneumatik, apo jo?

— Jo, lidhur me valvolën.

— Va... lvo... lat — e ndau ai në tri pjesë këtë fjalë, edhe pse nuk qe as e nevojshme dhe as e ligjshme një ndarje e tillë. — Val... vo... lat — e ndau ai sërish dhe ngriti kokën. — Diç më ka zënë veshi — tha i qetë, pasi veshët e tij nuk reagueshin fare në këtë apel.

Akim Kabashi u ngrit, gjë që nuk ndikoi mbi kubaturën e dhomës. Hapi një sirtar. Hapi dy. Hapi tre. I mbylli të tre dhe hapi tre të tjerë. Njerëzit duhet ta marrin vesh se sirtarët e shumë dëshmojnë gjithmonë për telashe të shumta. Edhe tre sirtarët e tjerë u mbyllën një nga një.


Agimi i hodhi një sy raftit përballë që ishte ndërtuar me përpjesëtimet e një garderobe të dhomës së gjumit. Aty flinin lirisht në një hapësirë të bollshme gjithfarë letra e shkresa nga tribu e fise të ndryshme.

Në klanin e skicave, ai kaloi me radhë pompetat, bronzinat, pistonët, cilindrat dhe bile një kuzhinë, modeli i së cilës me siguri i përkiste perspektivës. Dosjet shpaloseshin si fetat e mollës të thara në diell. Por ajrosja nuk zgjaste. Agimi i mbyllte sërish, i lidhte nga të gjitha anët dhe i vinte nëpër vendet e veta.

— Hëm... e gjeta!

Nuk dha shpjegim aty për aty. Palosi dosjet dhe dhe i sistemoi në raft, tamam sikur do të bënin aty gjumin e përjetshëm. Pastaj u ul, shkrep çakmakun dhe e ndezi. Duhet sqaruar dhe kjo me kërkesën e tij, se Agimi çakmakun nuk e mban për luks. Jo, këtë e ka nga frika. Mos u çuditni! Nga frika e shkrepes. Se, në një mbledhje, shkrepesja e tij, në tentativë për të ndezur cigaren, u nda si fishek-zjarr. Në pesë drejtime të ndryshme. Nga kjo breshëri u prekën: drejtori, kryetari, zëvendësministri dhe Sulo shoferi. Ndërsa goditja e pestë ju kthye të zot si resto, pa mundur të shkaktonte ndonjë plagë zjarri. Edhe të tjerët kishin shpëtuar pa ndonjë cen serioz. Që atë ditë, kur ndonjëri pregatitej ta ndize cigaren me shkrepse, Agimi largohej shtatë hapa dhe aty nxirrte çakmakun e tij të zbutur në alkool, sikur do t'i përgjigjej zjarrit me zjarr. Tamam si në duelet klasike.

— Propozimi juaj i ka kaluar për kompetencë byrosë teknike të institutit të kërkimeve — i tha Kadriut Agimi me një ton supersolemn.



— Mua kjo nuk më intereson — u përgjegj për çudi tjetri.

«...Nuk i interesonte! Po atëherë përse vinte?»

— Sepse dua të di përfundimin e propozimit si dhe rezultatin ekonomik. Sa kursehet, sa ngrihet rendimenti, sa ulet kostua... Sipas meje këto shifra lëvizin gjer 50 për qind.

— Sipas jush? Por, shok, duhet të dini, se jo çdo gjë lëviz sipas jush! Dhe as sipas meje! Por sipas dialektikës!

Në byronë teknike, Kadri Lami nuk e gjeti dot valvolën e tij, as komplet, as gjysmën e saj. Bile as gjurmët nuk i qenë parë gjëkund. Për këtë dëshmonte ndershmërisht edhe protokoli i administratës.

Agim Kabashi hodhi në orbitë një hipotezë të re. Dokumentat përkatës duhej të ndodheshin në drejtorinë mekanike të ministrisë. Argumentat për mbrojtjen e kësaj hipoteze ishin aq të shumtë, sa që donin gjashtë muaj kohë për t'u renditur.

Kadriu, tepër entuziazt, u drejtua për në ministri. Por valvola e tij as nuk qe dëgjuar aty rrotull.

Për të provuar ndonjë devijim të mundshëm nga orbita, Kadriu ktheu nga majat thembrat dhe u nis të trembte mendimet e mëdha të Agimit.

Pati një seri hipotezash. Mos vallë ajo që kërkohet ndodhej në Kryeministri? Po sikur të mos ndodhej as atje? Po sikur të ketë zënë vend në Komisionin e Planit? Edhe Radio Tirana nuk duhet përjashtuar nga përgjegjësia. Ndoshta e kanë marrë valvolën që në projekt për ndonjë radiokronikë apo intervistim! Hajde dhe futju këtij labirinti. E mira do të qe të krijohet ndonjë ekspeditë kërkimore. Siç janë, fjala vjen, ekspeditat gjeologjike apo arke-

ologjike. Ato kërkojnë dhe gjejnë dokumenta prej mijëra vjetësh të lashtë. Merret me mend se sa lehtë do t'i gjenin këto të ditëve tona. E, megjithatë, askujt nuk i ka shkuar ndër mend për këto.

Mos vallë duhet bërë ndonjë propozim konkret? Por Kadriu priste më këmbë për propozimin e tij dhe jo për të mësuar se çfarë fantazonte Agimi.

— Sikur t'i shikonim edhe një herë dosjet! — shfaqti mendimin e tij të vogël Kadri Lami.

— Po unë kërkoja, mor shpirt, kërkoja, mor byrazer. Megjithatë, për të mos menduar se jam dembel, po i përvishemi edhe një herë punës.

Agimi hoqi xhaketën, xhest ky që në mes të dimrit dëshmon për një lloj heroizmi krejt origjinal.

— Aksion me goditje të përqëndruar. Ti këtë anë, unë atë anë — i tha ai Kadriut, duke e ndarë raftin në dy pjesë simetrike.

Ndërkohë hyri aty përgjegjësja e administratës me një shkresë në dorë.

— Shoku Agim, keni një shkresë nga Spitali klinik nr. 2, — i tha ajo.

— Po kjo nga doli — u çudit Agimi, duke e marrë letrën. Si njeri kurioz ai nuk mund t'i mposhte ngacmimet e brendshme. Dhe lexoi... dhe ngriu ashtu më këmbë si një statujë e lashtësisë.

Në zarf, përveç skicave dhe relacionit mbi valvën, që propozohet për t'u prodhuar në atë adresë, ishte edhe një shkresë përcjellëse nga administrata e spitalit. Aty shkruhej:

«Në vijim të tuajës, nr. 11/6 datë, 173/69 po ju përgjigjemi se sërish keni gabuar adresën. Ne nuk kemi prodhuar ndonjëherë të tilla gjëra. Në qoftë se keni nevojë për ndonjë kurë apo operacion brenda mundësive tona, paraqituni sa më parë! Jemi tepër

të gatshëm t'ju shërbejmë! Ky është profili ynë...»

Si e pa që shpresat për një përgjigje telefonike

— Po si dreqin të jetë bërë kjo ngatërresë?

-- Me siguri nga vëmendja e tepërt — ja ktheu pa ironi përgjegjësja e administratës, duke e lënë në hall të vet.

— Eh, ç't'i bësh! Të ishe sadopak burokrat, nuk do të bije në këtë hall — ja nisi Kadriu. — Fundi do ta kishe depozituar aty në ndonjë dosje dhe në një ditë si kjo do ta gjeje se s'bën. Po ti je kaq operativ, sa i shkruan adresat me sy mbyllur. Mirë që nuk ma dërgove në OKB! — dhe, pasi e futi në xhëp propozimin e tij, Kadriu doli nga zyra, duke e lënë statujën ashtu siç qe me ato mendimet e tija të mëdha të kyçura në atë kokë të madhe.

LETËR NGA JETA PËRTEJ VARRIT TË MBYLLUR!

Disa miqve të mi, si dhe disave prej fafesisit tim, me rastin e ndarjes sime nga kjo botë.

Së pari, o miq, dua t'ju ngushëlloj për këtë humbje të parakohshme dhe të rëndë. Marr pjesë thellësisht dhe sinqerisht në pikëllimin tuaj dhe dëshiroj të jetë e fundit dhe t'ju kem lënë uratën! Jua ndjefsha zërin për të mirë (nëse do të arrij ta ndjej)!

Së dyti, dua t'ju falënderoj për zemërsisht për varrimin madhështor që më bëtë, për lotët e derdhur, e sidomos për fjalët e mira që thatë në adresën time (megjithëse disa nga këto fjalë nuk do që keq sikur të mos i kishit rezervuar kaq gjatë)! Dhe më vjen fort keq që nuk mundem t'jua shpërblej në kokën tuaj!

Të tretën e kam me ty, o Rushan, o miku i fëmijërisë! Ti u pikëllove shumë. Dhe me të drejtë! Humbe një mik të mirë dhe të vjetër. Aq të vjetër, sa do ta kesh të vështirë të gjesh një tjetër mik,

ta vjetërosh aq sa isha unë dhe ta bësh po aq të mirë, sa e do ti! Duket sikur po flas pa modesti për veten time, apo jo? Për nder, rrojta 88 vjet dhe nuk e pandehja të isha kaq i mirë. Dhe ndoshta kurrë nuk do ta kisha marrë vesh sikur të mos kisha vdekur! Përse të mos them edhe unë disa fjalë të mira për veten time pas vdekjes?

Sidoqoftë, me ty, o Rushan, nuk matem dot. E dija që më doje shumë, po kurrë nuk pandehja se do të më doje kaq fort, sidomos pas vdekjes! Përse nuk ma kishe thënë, o i paudhë, se po ta dija kështu, do të rroja edhe disa ditë!

Shumë qave! U bëre fare qaraman! Nuk e mbajta hiç veten, o Rushan!

Dihet, vdekja është e hidhur, po burri ama, e mban veten. Nuk bën ashtu siç bëre ti. Vajte e shkule flokët! Përse i shkule? Se vdiqa unë? Po unë një ditë do të vdisja!

Po as me kaq nuk u ndale. Në varreza ike fare nga terezia. Vajte t'i bie me kokë murit rrethues! Vetëm kur pe se muri ishte me dopio tullë silikate, nuk e bëre këtë hata! Dhe bërë mirë që nuk e bëre!

A i bihet murit me kokë, i dashur Rushan? Unë them se jo!

E kuptoj që u pikëllove! Përse të mos jemi të singërtë? Edhe unë u pikëllova jo pak për vdekjen time! U pikëllova shumë bile! Fundi, njeriu një herë vdes, prandaj ja vlen të pikëllohesh me këtë rast! Dhe unë kurrë nuk e kisha provuar një mynxyrë të tillë! As eksperiencë nuk kisha! Po ja, më erdhi dita! Ç'të bëja?

Megjithatë, e mbajta veten. E mbajta si burrat (ti e pe dhe vetë). Nuk derdha asnjë kokërr loti, apo jo? Se unë ju kisha thënë të më përcillnit me muzikë,

e jo me lot e vaj. Këto kurrë s'i kam duruar! Nuk desha lot dhe vaj në varrimin tim. Dhe unë vetë e mbajta fjalën. Vërtet që nuk këndoja dot (dhe kjo jo për fajin tim), po as për të qarë nuk qava.

Kurse ju, hë, ju kishit mundësi të këndonit. Kishit, po nuk deshët!

Pandehët se kështu do të më nderonit më tepër. por bëtë të kundërtën: më nxitë faqen! E, megjithëse thonë që turpi për të gjallët është, më besoni, qenka edhe për të vdekurit! Nuk qe nevoja për gjithë ata lot.

Numër ekstra. Dy fjalë me ty, o Niko kolegu. Edhe ti u pikëllove e u nxive si një natë pa hënë! Të ngushëlloj dhe marr pjesë në hidhërimin tënd! Megjithatë duhej ta mbaje disi veten, ashtu siç mbaheshe edhe para meje. Ti gjithnjë më merrje për instruktor papagajsh, përse pra e harrove këtë gjë të mirë në varrimin tim? Nuk bëre figurë fisnike që qave aq tepër në prani të ministrit! Se fundi, ai nuk kishte ardhur në varrimin tim të shikonte një koleksion vajtimtarësh! E tepruat, o miq, e tepruat!

Së katërti, dua të të them dhe ty nja dy llafe; o kushëri i dashur Lame! O Lame! Ishim rritur bashkë me bukë misri e me labot! Kishim ngrënë së bashku jo një thes me kripë, po një kripore të tërë!

E bëre si burrat këtë radhë, po burrë nuk u tregove! Se ti e bëre si burrat anadollakë, e jo siç llafosnim bashkë dikur! Po ç'që ajo hata që na bëre. o Lame!? Përse edhe konakun tim edhe kasollen tënde i bëre daulle? Përse, o Lame, i bëre daulle të dyja shtëpitë tona? Kush do t'i bjerë kësaj daulleje që të kërcejnë kalamajtë tanë?

Si nuk ja vure pak gishtin kokës, o kushëri, po vajte e nuk mbajte mend se ç'bëre!

Një viç, dy desh, katër qengja dhe 17 pula gjeten ngordhjen për sebpin tim. Përse i more më qafë gjithë ato vlera materiale? Ato i duheshin ende njerëzimit. Do t'ju duheshin ende juve që mbetët pas. Se nuk është e thënë që i vdekuri të marrë me vete çdo gjë!

Përndryshe, të gjallët do të mbeteshin në ditë të hallit me dy gishtat në gojë!


Edhe rakinë sikur e derdhe me tepricë, o Lamel! E tillë raki nuk qe pirë as në dasmën time, o Lame (e mbaj mend si sot)! Ç'qe pra nevoja të pihej në varrimin tim? Edhe sikur të mblidhje bashkë të gjithë sarahoshët e qytetit, nuk do ta pinin dot gjithë atë rrëke rakie. Dhe dihet, në varrim nuk është mirë që ndokush të trulloset nga rakia, nuk i ka hije askujt!

Më qatë me ligje, mirë bëtë xhanëm, po pse nga mëngjezi e gjer në darkë? As flokët nuk bëtë mirë që i shkulët dhe faqet i çorët kot së koti! Po ju harruat se ulërима dhe të shkukurit e flokëve në fshatin tonë është ndaluar nga populli që më 1920?

Së pesti, e kam fjalën për drekën time. Shumë vetë më kishin uruar sa isha gjallë: të hëngërsha drekët! Dhe, për kënaqësinë e tyre, mjaft personave unë ua dhashë këtë mundësi. Ma hëngërt drekën!

Ju bëftë mirë dhe jua paça hua! Por ju, o miq, po e teproni! Dreka ime nuk ka pse të vazhdojë 35-40 ditë! Pasi unë nuk kam 35 shpirtëra dhe nuk do të vdes 35 herë! Nga kjo nxjerr se qenka më mirë ta hash vetë drekën tënde, se sa të ta hanë të tjerët!

Njerëzit linin ditët e punës në kooperativë; linin mbjelljet dhe vinin e shtroheshin muhabet e raki nëpër drekat e mia që fillonin me sabah bashkë dhe mbaronin kur hëna ishte ngritur tre hostenël!



Bile disa shokë vinin me ditë-pune të regjistruara dhe kjo bëhej me qëllim që të shtohesh pjesë-marrja, në mënyrë që drekat e mia të dilnin sa më madhështore! Dhe nuk u vinte hiç keq që brazdat e hapura psherëtinin për një kokërr farë! Ndërsa ju bënit kokrrën e muhabetit në drekën time! Po a i llogaritët se sa ditë-pune humbën kështu? Pa i bini njëherë lapsit dhe më njoftoni!

Më turpëruat! Më duket sikur unë mbaj për-gjegjësi të rëndë për gjithë këto. Sikur të më jepej mundësia të ngrihesha përkohësisht nga varri, do t'ju bëja qepaze, do t'ju bëja, dhe pastaj do të kthehesha i kënaqur pas, si ai që e ka kryer gjer në fund detyrën!

Edhe në Brazil (për të cilin kam dëgjuar se kafja hahet përslesh me bukë, siç kemi ne çanakun me dhallë) nuk ma ha mendja të jetë harxhuar aq tepër kafe se sa në ish-shtëpinë time mbi tokë!

Por për ata që vuanin nga tensioni, nuk ju erdhi hiç keq? Sa për cigaret, angazhuat një depo të tërë! Qyl, qyl ishte xhanëm, po kjo nuk do të thotë që cigarja qyl nuk vepron mbi mushkëritë!

Këtu ku jam tani të gjitha ditët i kam të diela. Por ky është një privilegj që na takon vetëm neve. Prandaj, të mos ngatërrojnë vendin, se e kanë gabim të gjithë ata që kanë braktisur punën dhe vijnë e venë ecejakë tërë ditën në shtëpinë time.

Me një fjalë, o miq, ju ma prishët të gjithë romantikën e varrimit tim. Ndryshe e kisha përfytyruar, ndryshe e kisha ëndërruar varrimin tim të vetëm! Dhe ja si më doli! Thomëni tani, a nuk janë këto zakone prapanike, kundra të cilave ju keni rrahur gjoksin saherë faqe meje? Dhe ja, sapo ju ktheva krahët, të gjitha këto i hodhët mbi varrin tim!

Nuk bëtë mirë që përfituat nga mungesa ime!
Kjo është dobësi!

Më ka mbetur aq shumë qejfi për këto, saqë do të isha gati të më zbulonit, të më zhvarrosnit dhe të më varrosnit sërish, ashtu siç më kishte hije dhe siç ju kisha porositur.

NJERIU QË NUK QESH

— Përse nuk qesh? — do të pyesni ju. Atë e di ai. Ai dhe varri.

Rrojti 75 vjet mbi tokël Megjithatë, asnjeri, as edhe unë, miku i tij i fëmijërisë nuk e pashë një herë të qeshte, të vente edhe ai buzën në gaz si gjithë njerëzit e tjerë! Përse? Hajde gjeje, të lutem!

Hëngrëm me të disa fuçi me kripë (ai e donte kripën të lëngshme) kemi pirë autobote të tëra me çaj, birra e verë. Megjithatë nuk e pashë një herë t'i qeshte buza! Dhe më vjen keq për të, pikëllohem!

Më vjen keq e pikëllohem, jo vetëm pse ra e vdiq para meje, (se kësaj i dihej) por vetëm pse nuk qeshi edhe ai një herë.

Unë jam i sigurtë vetëm për një gjë: ai vdiq para meje, vetëm e vetëm pse nuk qeshi. I kisha thënë aq herë, i kisha dalë borxhit: qesh, qesh a derëzi, se e qeshura ta zgjat jetën, të jep oreks, shëndet.

Po ai, i ndjeri, më shikonte me vetullat kryq nga zemërimi dhe ma kthente rëndë-rëndë, sikur të fliste vetë Baba Tomorri: — Nuk e kuptoj, përse të qesh, përse duhet që pa tjetër të qesh? Çfarë ka këtu për të qeshur?

Nuk mbaj mend mirë ata muaj kur ne përkundeshim në djepe nëse ka qeshur atëhere, apo jo. Sidoqoftë më vonë, kur ne u ngritëm më këmbë dhe vendosëm të bënim tutje në jetë, unë nuk e mbaj mend të ketë qeshur, qoftë edhe aksidentalisht!

E shëtita në të gjitha shfaqjet e estradave, në të gjitha komeditë (më aktualet dhe më klasiket) po meazallah se e vuri buzën në gaz!

Ishte njeri i vendosur, dakord, po një vendosmëri e tillë, vetëm për të mos qeshur kurrsesi, nuk më ngjan tepër seriozel!

Lexuam së bashku dhe veç e veç të gjitha veprat humoristike që na ranë në dorë. Që nga anekdotat e deri te romanet humoristike shumëvëllimëshe. Po ai nuk e çeli që nuk e çeli buzën!

Sikur të kishte vënë ndonjë bast me dikë. Një bast pra që do të vazhdonte tërë jetën. Por kushton tepër që e tërë jeta t'i kushtohej një basti të tillë! Jo, të tilla baste nuk hahen. Të mos qeshësh asnjëherë! Është dënim i rëndë! Kjo do të thotë të jesh buzëplatur! E, megjithatë, ai nuk qeshi asnjëherë, megjithëse nuk qe buzëplatur dhe as cipëplatur.

Ne pamë edhe festivalin e estradave. Jo se jo! Buza e tij ishte e vendosur të mos çelej. As në festivalin e teatrove me komeditë.

Mblidheshim dëndur me shokët në dasma apo bankete. Qarkullonin anekdota e shaka sa të këputnin brinjët. Por jo për atë.

Unë nganjëherë qeshja aq shumë, sa të dukej se po qeshja edhe për atë fatkeqin, të cilin natyra i kishte mohuar mizorisht dhuntinë më fisnike: të qeshurit.

Ai pra nuk qeshte. Nuk kënaqej si gjithë njerëzit e tjerë. Kishte shumë kërkesa ndaj çdo gjëje,

ndoshta edhe ndaj vetëvetes! Po për këtë nuk e ve dorën në zjarr. Këtu qe enigmatik!

Ai nuk provonte emocione. Dhe ç'kontrast: ndërsa unë (me sebeb-kuptohet) shkundesha së qeshuri, siç shkunden arrat, ai vrehej e nxihej si qielli në stuhi.



Ishte aq i ftohtë, i ndjeri, saqë unë shpesh pan-dehja se shoqëroheshja jo me një shok, por me një frigorifer.

Të afërmit dhe dashamirët më thoshnin den-dur: Si ka mundësi ta kesh aq të shtrënjtë një copë ajzbergu si ai? Natyrat tuaja dallohen si Groenlanda me Saharën!

E vërtetë: natyrat tona ishin larg. Po unë mi-dis të tjerash jam edhe zemërbardhë. Unë nuk mund ta braktisja mikun tim në atë situatë. Pa i mësuar të qeshurit. Se unë dëshiroja që edhe ai të qeshte si çdo njeri, të provonte emocione dhe të kënaqej si çdo i gjallë. Të kuptonte se në jetë ja vlen edhe të qeshësh. Bile shpesh kjo bëhet një domosdoshmëri. Desha të mësonte së natyra, përveç akullit, ka edhe diell, edhe hënë, edhe yje, edhe satelitë artificialë.

Eh, shumë gjëra desha të bëja për atë njeri, po nuk munda. U tregova i paaftë. Ju luta edhe një shoku humorist se mos më ndihmonte. Por ai m'u përgjegj buzëgaz: «Unë nuk kam të bëj me jetën pa diell!»

Pra mbeta në baltë. Për këtë unë pa dyshim që do të përgjigjem përpara njerëzimit. Po, unë do të përgjigjem, se unë nuk jam si ata që heqin dorë nga përgjegjësia. Dhe këtu s'ka asnjë për të qeshur.

E bash për këtë mosqeshje të atij, mua më duhet të përgjigjem.

Të vdesë tjetri pa i qeshur njëherë buza në jetë, kjo nuk është përgjegjësi e vogël! Kjo është tragjike! Jo, nuk ishte mendjemadh.

Ju betohem! Këto qenë akuza me hamendje, që shpesh arrinin në thashetheme. Se unë nuk njoh asnjë mendjemadh që të mos qeshë. Qoftë edhe me veten e tij.

As cinik nuk ishte — ju siguroj. Ju e dini fort mirë se ekzistojnë në botë edhe buzëqeshjet cinike, të cilat shpesh na hapin aq shumë punë e telashe. Po çfarë njeriu ishte pra miku im i ftohtë? Përse nuk qeshi asnjëherë, përse nuk ndjeu asnjë kënaqësi në jetë?

Natyrë na mban të kyçura ende shumë sekrete, përse të mos jetë edhe ky rast diçka e tillë?

Megjithatë, barra më e rëndë në zbërthimin e këtij misteri më bie mua. Dhe unë krenohem për këtë. Por, mendoj se edhe shoqëria në përgjithësi duhet të mbajë njëfarë përgjegjësie, si të thuash.

Se shoqëria kurrën e kurrës nuk duhet të lejojë që një anëtar i saj i denjë t'i mbyllë sytë pa i qeshur buza. Jo, edhe shoqëria duhet të jetë më vigjilente në këto raste. Të bëjë diçka në mënyrë që anëtari i saj dinjitoz të qeshë më në fund.

Ose, ose, në qoftë se as në këtë rast i ndjeri nuk do të qeshte, atëherë shoqëria ta mbërthente nga jaka e palltos dhe ta pyeste: o shok, përse nuk qesh Ti? Ç'kemi ne që nuk vete? Ç'kemi ne që ty nuk të pëlqen?

Ndoshta nga kjo së paku diçka do të mësonim... Të mësosh, përse një njeri nuk qeshi asnjëherë në jetën e tij, kjo nuk është pak!

Dhe do të qe një mësim i ri, i freskët. Ndoshta një zbulim në shkencat sociologjike dhe fiziologjike.

Se, më thoni, ju lutem, në cilën enciklopedi kenë gjetur diçka të tillë: Përse filan qytetar dinjitoz nuk qeshi asnjëherë në jetën e tij? Pa më thoni?

Të thuash se ishte ogursëz, si hudhra, e cila as sheqerohet dhe as kripohet, për këtë ne nuk kemi ndonjë bazë shkencore. Se nuk na vajti ndër mend t'i bënim analizën e gjakut.

Gabim që nuk i bëra ndonjë lutje për të qeshur. Ta lutja me gjithë mend: O shok, o mik i dashur i fëmijërisë, i rinisë dhe i pleqërisë, të lutem shumë qesh një herë! Të përgjërohem, mos na braktis pa një buzëqeshje optimiste apo gjysëmoptimiste!

Por kjo nuk më shkoi ndër mend. Dhe ai iku, u nda nga ne pa qeshur.

Iku pa shaka. Eh, sikur të kthehej edhe një herë në jetë sa të zërthenim këtë të fshehtë! Po do të jetë vështirë ta bëjë këtë njeriu i cili asnjëherë nuk qeshi në jetë.

Nuk qeshi që nuk qeshi. Dhe nuk e dimë arsyen e saktë. Natyrisht, barra më e madhe këtu më bie mua. Dhe unë po i vazhdoj kërkimet.

NJË SQARIM

Ky sqarim bëhet me kërkesën time këmbëngulëse nga unë vetë. Sapo u ktheva nga mbledhja, kolegët e mi m'u vërsulën pa mëshirë:

— Përse nuk diskutove?

— Përse nuk e çove fjalën tonë në institutin e kërkimeve?

— Kështu i ke kuptuar ti, shok, vendimet e Plenumit IX?

— Apo vajte sa për të zhvatur dietat?

— Apo pse atë ditë luante «17 Nëntori» me «Partizanin»?

— More shokë, ndaluni! Ju e dini që unë dy herë në vit shkoj në stadium! Pse e prishni gojën?

Por ata s'u ndalën. Nuk më dëgjuan. Dhe unë në përgjigje të të gjitha akuzave që padrejtësisht u ngritën mbi shpatullat e mia, po shënoja sa më poshtë:

Mbledhja kishte karakter akademik, ose siç u shpreh një shoku im në krah, ishte mbledhje e rangut akademik.

Unë e kisha për të parë herë që merrja pjesë në një mbledhje të atij lloji. Dhe, kuptohet që hera e parë ka emocione, drojtje, pasiguri... si hera e parë më, ç'ta zgjat...

Para se të nisesha, shokët më dhanë porositë e

fundit, gjë që influençoi në ngritjen e moralit.

«Folë — më thanë ata — edhe mbi termodinamikën tonë! U trego mbi metodat e reja që po eksperimentojmë në përpunimin termik të metalit! Folë për shfrytëzimin e kohës së punës! Për ngritjen e rendimentit! Folë për normat maksimale dhe mbi-maksimale që vendosëm!»

Më dhanë edhe porosi të tjera, por unë i mbaj mend ato po aq, sa edhe studenti formulat, kur merr biletën e provimit.

Kjo lloj ngritjeje e moralit tim u zhduk si zhiva, sapo vura këmbë në sallën e mbledhjes.

Referatin e dëgjova me shumë vëmendje, meqenëse ajo ishte detyra ime e parë. Dhe e kam patur parim qysh në vogëli: detyrat e para i thaja!

Detyra e dytë imja ishte që të jepja emrin për diskutim. Fill pas referatit, drejtuesi i mbledhjes komunikoi: «Dhjetë minuta pushim. Diskutantët të japin emrat dhe të na lënë nga një kopje të diskutimit.»

Eca me hap të vendosur drejt presidiumit dhe ju drejtova sekretarit të tij.

— Haxhi Perona!

— Mbi se do të diskutoni, ju lutem?

— Rendimenti dhe normat e reja në termodinamikë.

— Bukur fort! Sa faqe kap diskutimi juaj?

— Rreth dy e gjysmë...

— Çudi!

— Pse?

— Telegram e keni apo diskutim?

— Këtë do e shikoni kur të marr fjalën.

— Bukur fort! Tjetri?

— Jorgo Do...

Dola jashtë dhe e tymosa një herë për inat të atij burokratit, i cili e krahasoi diskutimin tim me një telegram.

Fill pas pushimit fjalën e mori një shok i trashë. Qysh në fillim pata përshtypjen se ai njeri duhej të kishte gëlltitur diçka, meqë ishte fryrë aq tepër. Dhe për fat të keq nuk isha gabuar.

Nga diskutimi i tij dilte fare sheshit se ai kishte gëlltitur një manjetofon bashkë me shiritat rezervë. Dhe hajde e dëgjo shiritat rezervë tani.


Herë pas here kthente ndonjë gotë me ujë, kjo gjë na mërziti jo vetëm ne por vetë atë. Kjo u kup-tua ngaqë ai, pasi e zbrazi njëherë gota-gota çininë, mbushjen tjetër me ujë të freskët e ktheu pa ndër-mjetësinë e gotës. Kjo gjë duhet patur parasysh për thjeshtimin e inventarit të mbledhjeve.

Atëhere mua më tërhoqi vëmendjen një kon-tradiktë. «Ky njeri, që pi kaq shumë ujë, duhet ta përdorë me teprim kripën. Dakord, po si ka mundësi atëherë që diskutimi i tij është kaq bajat?»

Nuk bënte të çuditesha? M'u kujtua se edhe peshqit e detrave, megjithëse jetojnë në ujë të kri-pur, nuk hahen pa kripë.

Diskutuesi i dytë premtoi se do t'i binte fare shkurt, gjë që mua më gëzoi singërisht. Por me ka-limin e kohës vura re se, ose unë nuk e pata dëgjuar mirë në fillim, ose ai nuk po e mbante fjalën.

Si njëra, si tjetra nuk e penguan atë t'i rreshton-te të gjitha pikëpamjet e tija mbi ndikimin e kush-teve atmosferike në prodhimin shoqëror, nga Ga-domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së ujit në pro-dhim, por linte në harresë të plotë dëmet kolosale të pjesëmarrjes së ujit në diskutime.



Ai rekomandonte që ne të studionim me vëmendje lëvizjet e yjeve dhe të planeteve, përdorimin e hartave astronomike si dhe probabilitetin e rënjes së meteorëve.

Por çështja nuk merrte fund me aq. Nuk merrte fund, për arësye se gjërat nuk ishin aq të thjeshta sa ç'dukeshin me shikimin e parë. As me shikimin e dytë. Jo, gjërat duheshin shikuar dhe sqaruar me saktësi astronomike deri në fund.

Edhe pas këtyre sqarimeve nuk po i dukej fundi diskutimit të tij.

E kishte kapur demin për brirësh. Si të qe torreedor... Nga dremitja më shkundi zëri i diskutantit të tretë të seancës së dytë. Ai u fut drejt e në thela. Si të qe në shtëpinë e tij:

— Shokë, unë do të diskutoj mbi tejkalimin e kapacitetit teorik të disa maqinerive në uzinën tonë. Kjo mund t'ju duket e pabesuar, por...

— Fantastike — fishkëlleu sekretari i presidiumit. — Fantastike bile! — përsëriti ai i vendosur. — Pastaj, shok, ti po del nga tema!

— Tema nuk më është caktuar nga ti — ja ktheu tjetri dhe shfletoi shënimet.

— Vazhdoni, vazhdoni, ju lutem — i tha kryetari i presidiumit, duke u përgatitur të mbante shënime.

Diskutanti solli fakte bindëse për sa premtoi. Sekretari u orvat nja dy herë që të përmbante vërshimin nga tema, por edhe këto qenë llogaritur nga ana e diskutuesit.

Mua në veçanti po më bëhej zemra det, pasi edhe në diskutimin tim kishte diçka të tillë. Dhe

është mirë, kur dikush tjetër e parapregatit mbledhjen për sensacione.

Por unë nuk e pata atë fat. Nuk qe e thënë t'i transmetoja mbledhjes përsa isha përgatitur. Me sa dukej qe vënë normativë që të mos ngjisnin dy surpriza në të njëjtën mbledhje. Kështu u mbyllën diskutimet pa ma dhënë fjalën. Nuk protestova, meqenëse si unë kishte edhe të tjerë.

Më të dalë ndala sekretarin e presidiumit dhe e pyeta përse nuk ma kishin dhënë fjalën.

— Kjo nuk kishte asnjë mundësi, i dashur shok — më tha ai me një dashamirësi kategorike. — Ju kishit një diskutim tepër të shkurtër. Pothuaj telegrafik! Këtë jua thashë qysh në fillim, po ju nuk më besuat. Si ka mundësi që të vini në një mbledhje si kjo me një diskutim të tillë skandaloz? Atë diskutim do të qe mirë ta çonit në postë-telegraf si model telegrami, pasi unë, shok. nuk jam postë-telegraf por institut kërkimesh. Bile unë mendoj t'i bëjmë një relacion qendrës tënde të punës dhe ta vëmë në dijeni për xhestin tënd të pahijshëm. Se ti me siguri për të na fyer erdhe në një mbledhje si kjo me të tillë diskutim prej dy faqe e gjysmë. Pra, nuk do të jetë keq që ata eprorët e tu ta marrin në shqyrtim këtë sjellje dhe të bëjnë diçka, që të tilla shakara të mos përsëriten.

— Jo — i thashë unë! — Këtë shaka nuk duhet ta bëni. Unë një vërejtje e kam për shkak të diskutimeve të shkurtëra. Dy nuk i mbaj dot, se dy janë tepër për të njëjtin faj.

— E shikon? E megjithatë e ke përsëritur!

Me kaq unë u ndava prej tij, se e pashë që nuk mund të sqaroheshim më tepër. Edhe aq sikur e kisha tepruar.

Diskutimi im, ashtu siç qe i kaloi shtypit me inisiativën time. Pas ca ditësh pashë me gëzim botimin e tij. Ishin rregulluar vetëm shenjat e pikësimi si dhe disa kohë foljesh. Por unë më tepër do të dëshiroja që të rregullohej disi edhe ndonjë sekretar pedant nga ata të presidiumeve.

LETËR FQINJIT

(Në katin e dytë)

I nderuari fqinji im, shoku Skëndo!

Është e vërtetë se ne jemi shumë afër (na ndan dyshemeja për ju dhe tavani për mua) e megjithatë, shumë rrallë i qajmë hallet bashkë.

Ç'është e vërteta, ju jeni ca i çuditshëm në sjellje, tip më vete, siç i thonë, por unë meazallah se dua t'ju kritikoj për këtë. Përkundrazi, unë jam pa rezerva për lulëzimin e një origjinaliteti të tillë. Prandaj ju shtërngoj dorën për këtë, se mbi të gjitha jeni burrë dhe i vendosur fort bile!

Megjithatë, nuk mund të rri sehirxhi, kur vë re se disa gjëra, që unë jua di përmendësh te të tjerët nuk di pse bien në sy për keq.

Fjala vjen, ju një natë ishit bërë në qejf dhe rastësisht u gjendët duke kënduar nën ballkonin e një tjetri. Dhe ai tjetri ndodhi tip jo fort i dhënë pas muzikës, kështu që i revoltuar ju qortoi me këto fjalë:

«Po pse, mor shok, borxh jua kam unë që vini e hapni gojën para shtëpisë sime?»

Ndërsa ju, natyrisht plot burrëri, ju përgjegjët në vend pikë për pikë:

«Po pse, mos vallë unë jua kam borxh juve, që keni ardhë e keni ndërtuar shtëpinë përpara gojës sime? Po lejen nga komiteti ekzekutiv e keni marrë për këtë? Hë, de, përgjigjuni!?»

Por ç'mund të përgjigjej ai tjetri? Se mos e dinte me kë kishte të bënte!

«Pastaj, ato nallanet, mik i dashur, si shumë po i përplasni dhe mua, që vuaj nga sinoziti, si shpesh po ma plasni shpirtin!»

Sa për drutë që çani mbi kokën time, kjo me të vërtetë duhet rishikuar! Vetëm dy ditë pashë qetësi në jetën time, kur t'u thye bishti i sëpatës. Por ju, duke vënë mend nga kjo avari, shkuaat dhe i bëtë një bisht metalik, kështu që s'kam asnjë shpresë se mund të thyhet për të dytën herë.



Ju, natyrisht, justifikoheni duke thënë: «Jemi lart, një kat mbi tokën. Pse të mos formohej toka pranë katit tonë?»

Por duhet ta dini, miku im, se unë nuk mbaj asnjë përgjegjësi për tekat e krijimit, që jua ka bërë me hile juve të katit të dytë.

Për çarjen e druve, do të dëshiroja në shenjë respekti që edhe unë t'jua ktheja drurin me dru. Por, siç dihet, graviteti pedant nuk të lejon që t'i çash drutë në tavan. Pra, ju nga poshtë jeni të siguruar me garanci nga forcat madhore të natyrës.

Pastaj, ajo gruaja juaj, desha të thoshja të mos lakmojë t'u bërtasë e t'u çirret aq shumë njerëzve të mi, pasi ka mundësi që të këputë mish në grykë!

Ja një ditë, meqë erdhi fjala, i bubulliti sime shoqeje mbi dy orë, por ajo, si gjë e humbur që është,



nuk bëri as gëk as mëk. Atëherë, shoqja juaj doli në ballkon, por jo për t'u hedhur nga kati i dytë.

Prej aty zbrazi një kazan me ujë mbi kokën e gruas sime. Sipas ligjeve të natyrës, dihet mirë se pas shkrepëtimave dhe bubullimave do të ketë edhe rreshje atmosferike.

Të ju them të drejtën më pëlqeni, sidomos me alegrinë tuaj të parreshtur si një gjinkallë, por si doqoftë nuk është e udhës ta bëni natën ditë me këngë e raki. Se, për pasojë të kundërt, dita do të bëhet natë me gjumë e çlodhje. Se pasojat dihen. Do të ketë defiçite në realizimin e normës, në shfrytëzimin e 480 minutëshit, e ku di unë.

E keqja këtu është se unë, që jam vetëm një kat nën ju, s'kam se si të shpëtoj nga këto pasoja jo tërë entuziazte. Kështu muaji që shkoi më doli me 160 orë pune dhe me një realizim mesatar ditor të normës prej 99%. Domosdo që 99% do të dilte, me që qindin e kishit mbushur ju.

Sa për pastërti, gruas suaj nuk i gjendet shoqja vetëm më ndonjë nga ato pasqyrat zmadhuese në dhjetëra herë. Unë, sapo kthehem nga puna, do të gjej një tok me plehëra në korridorin tim, të cilin, ndoshta më ka dalë nga mendja t'juaj them, por s'kam ndonjë plan ta shfrytëzoj as për shtretër të nxehtë dhe as si parcelë eksperimentale.

Kur i fola një ditë shoqes suaj për këto, ajo u përgjegj gjithë edukatë dhe pa u skuqur fare:

«Po ku ka bërë vaki gjer më sot që plehërat, pasi të fshihen, të hidhen lart dhe jo poshtë? Ah, mor gjiton, po lart nuk kthehet as ujët e jo më plehërat.»

Kjo ishte një e vërtetë e vjetër dhe unë i kërkova shpejt të falur për njohuritë e mia gjysmake qoftë

në njohjen e plehut, qoftë në hidrogjeologjinë shtëpiake.

Ju, i dashur, më keni edhe 100 lekë hua. Dua t'ju lajmëroj me kënaqësi të mos m'i ktheni, pasi radios suaj i detyrohem shumë më tepër. Vetëm çuditem, si dreqin nuk po bie në dorë të ndonjë ustai, pa e shikon vetë ajo pastaj!»

Me nderime:

Fqinji juaj që ju respekton dhe psherëtin një kat më poshtë:

Haruni!
d.v.

P.S. Njësia me origjinalin nuk ka rëndësi të vërtetohet, meqë jo vetëm s'ka asnjë teprim, por mjaft gjëra janë lënë mënjanë!

NË DEPON E KULTURËS

Kam vënë re se njerëzit, pasi lindin, rriten. Pastaj të tjerat dihen. Vetëkuptohet se gjatë kësaj kohe kalojnë vite, vijojnë mosha e mosha, si stinë të zmadhuara. Ja, unë para 10 vjetësh isha njëzet vjeç, ndërsa pas dhjetë vjetësh do të jem dyzet. Pse ndodh kështu? Hajde gjeje!

Unë njoh vetëm një rast, kur krijesa lindi, u rrit, u plak dhe pastaj u mbyll në arshivë (dhe jo në arkivol) brenda disa ditësh.

Kjo ndodhi kështu:

Një të hënë mora një letër, ku vihesha në dijeni se pas dy javësh duhej të dorëzoja një portret me rastin e hapjes së konferencës kombëtare të talenteve të reja. Kjo m'u duk një inisiativë fisnike, ndaj fillova punën pa asnjë vonesë.

As për agjitacion nuk ka nevojë, pasi dihen mirë detyrat që kemi ndaj talenteve të reja, ndaj brezit të ri që do të marrë stafetën. M'u mbush mendja të bëja portretin e një fëmije të moshës parashkollore. Kjo m'u duk një gjë e lehtë, siç ndodh zakonisht para fillimit të çdo pune. Por nuk doli kështu.

Provoni të pozoni një fëmijë në këtë moshë dhe do të bindeni mirë që kam të drejtë. Për pozim mora

Landin, çunin e tim vëllai, i cili shquhet në gjithë fëmijët tanë për durim dhe bindje.

I shpjegova një për një parimet themeltare të pozimit, si dhe disa çështje të tjera për të cilat ma mori mendja se ai qe i papregatitur. Landi nuk pati asnjë kundërshtim. Ai në përgjithësi qe dakord me detyrat që kemi ne ndaj brezit të ri. Vetëm një mizë kali nuk e linte të përqëndrohej në çështjen që kishte marrë përsipër. Kështu m'u desh ta përsëritja. Por Landi më nxori më shumë telashe nga ç'mund të parashikosh prej moshës së tij. Si e pa që po mundohesha e po djersitesha ashtu, u afrua dhe më tha:

— Xhaxha, meqë po lodhesh kaq shumë, ulu në vendin tim dhe lërma mua ta bëj këtë punë! Se dhe unë kam nevojë të çlodhem!

Natyrisht unë një kërkesë të tillë nuk pata kurajë ta pranoja.

Pas disa ditësh portreti qe gati. U mblodh komisioni i vlerësimit. Portretin e panë nga çdo qoshe, në çdo distancë, me aq këmbëngulje dhe imtësi, sa që radiografia ka ende mundësi të perfeksionohet.

«... Punim interesant. Kolor, dritë, hapësirë dhe qartësi... Pa dyshim origjinal! Sidoqoftë, fëmija është dhënë me ekspresivitetin karakteristik të kësaj moshe...»

Sipas shtatit duhet të jetë gjashtë vjeçe, ndër-
sa sipas tipareve të kristalizuara këtu nuk të jep dot përmbi tre vjeç. Pra kontradikta është e madhe. Nuk kuptoj ç'ka sinjifikative në këtë mes midis këtij punimi dhe predispozitave estetike të autorit... (e të tjera që mund të merren edhe me mend).»

Për të sqaruar se ç'kishte sinjifikative midis portretit dhe predispozitave të mia estetike, fillova ta ripunoja veprën.

Theksova mirë linjat e ekspresivitetit të një fëmije gjashtë vjeçe aq sa këtë fatos mund ta merrje për një akrobat cirku.

Tufa e dytë e vërejtjeve shënonte midis të tjerash... «Po, bukur! Veçse për t'ju shmangur shkarjeve në natyralizëm, fëmija duhet të dalë më burrërore, më e pjekur. Ja, shikojeni vetë! A kemi ne fëmijë të tillë? Nuk ma ha mendja. Fëmijët tanë, brezi i ri...»


Me sa dukej në këtë ripunim diçka nuk shkonte. Vërejtjet e para së paku qenë më inkurajuese. Pra, duke e ripunuar veprën, i kisha hapur më tepër punë vetes.

E mora në duar portretin gjashtë vjeç dhe nisa ripunimin e ripunimit. Pas disa penelash më doli një fëmijë, që duhej (së paku nga pamja) të kishte mbarruar shkollën e mesme, apo ndonjë nga shkollat e rezervave të punës. E paraqita atje ku duhej.

«...Portret interesant! Ç'ëmbëlsi tonesh të freskëta! Tamam si një tufë zambakësh të sapokëputur... Sidoqoftë, këtu nuk spikat me tërë madhështinë e saj solemne heroika e fëmijëvet tanë. Ne kemi fëmijë që dinë të përdorin kazmën, pushkën, drapërin. Kemi fëmijë zdrukthëtarë, hidraulikë, elektrikistë, farkëtarë. Fëmijë që ëndërrojnë të bëhen pilotë. Të fluturojnë, të notojnë... Kemi fëmijë të pjekur, të rritur... Por këtu, ja, shikojeni vetë! Ç'gjurmë ka lënë mosha te një fëmijë e tillë? Se mosha lë gjurmë edhe te një trung, e jo më te një fëmijë!

Ku është psikologjia e saj, ku janë pasionet, elasticiteti, plastika? Asnjë gjurmë, asnjë rrudhë, asnjë thinjë!»

U pa puna! E mora portretin e rikthyer. Rrugës filloi të më hante një dyshim. Mua zakonisht rrallë



më hanë dyshimet, prandaj kam hak t'i marr me seriozitet këtë radhë. Pra dyshoja: ose unë po tregohesha si tepër leshko me këtë ripunim, ose, ose, ai shoku kompetent. . . më mirë po e lë me kaq! Përse të mos e provoj deri ku do të arrihet me këto super-vërejtje! Ku ta dish, mund të dalë diçka e re që do ta pasurojë fondin e artë të artit.

Nisa të ripunoja ripunimin e ripunuar sipas rivërejtjeve. Shtova fare pak thinja, gjysmë rrudhe, ca mendime, ca pasione, elasticitet, plastikë, vibratione dhe fëmija ime tashmë i ngjante një të liruari nga ushtria. Por as ushtari i liruuar nuk u pranua në ekspozitë. Atë duhej ta thërrisnin në zbor, të nisej në marrshim dhe të ngarkonte në krahë një top fushor. Por as ky top nuk i theu dot dyert e ekspozitës. Fëmija ime duhej të dilte më burrërore, bile, mundësisht të dilte në krah të fëmijës së saj, si dy breza të rinj!

Pra fëmijën m'u desh ta martoja në minutë dhe po në minutë m'u desh ta bëja me fëmijë. Së paku këtu gjendja civile nuk më ra fare në qafë, kështu që mbarova punë shpejt e shpejt.

Por. . . «Ky nuk është një baba i vërtetë, një baba burrëror, atëror. Edhe ai vetë sikur është penduar që u bë baba! Duhet theksuar portreti i baba-bait. Më tepër forcë, më tepër thinja! Ato shprehin fisnikëri, respekt, energji! Këto thinja duhet të jenë lavdia e moshës.

Pastaj, ju, i dashur, përse ngatërroni dialektet? Herë shpreheni gegërisht, herë toskërisht. Në pikturë kjo nuk lejohet!»

— Si, dialektet? — Vura kujen unë. — Po ç'hyjnë dialektet në pikturë?

— Hyjnë, si jo! Në qoftë se nuk hyjnë dialektet, hyn dialektika...

Duke patur parasysh dialektet dhe dialektikën, i shtova fëmijës sime disa thinja fisnike plot respekt, ca energji primare dhe pas kësaj e quajta me vend t'i rrasja në kokë edhe një kasketë doku.

Këtë e bëra për arësye se më shpëtoi dora te thinjat e lavdishme, fisnike e plot energji, duke i vënë më shumë nga ç'qe nevoja. Kështu disa ja mbulova bukur nën kapelë.

Por kompetenti i ra edhe më bukur hilesë. Ai, edhe nën kasketë, i dalloj thinjat fisnike plot lavdi.

...«Pra, ti na ke stisur kështu një pensionist, apo jo? Ide interesante! Shumë interesante! Po si nuk ta preu mendja që përkrah pensionistit duhej radhitur i biri apo më mirë e bija, për të mos u treguar si të thuash, patriarkal?! Ose, ose mund të vije edhe mbesën apo nipçen! Ky lloj gabimi nuk të falet! Se nuk je më fillestar! Duhet tre breza, i dashur, tre brezat tanë që...

— Kjo edhe mund të bëhej — ja ktheva pa djallëzi — por i biri i këtij baballëkut këtu ka vendosur që të mos martohet pa dalë shëndoshë e mirë nga ekspozita juaj.

Me kaq u lashë tablonë në duar dhe ja mbatha për të mbushur mushkëritë me ajër në vendet klimaterike.

Dëgjova më vonë se komisioni i ekspozitës kishte vendosur që pensionistin tim ta nxirrte në pension në një qoshe të depos kulturale pranë shtëpisë së kulturës.

VAZHDIM I NJË FEJTONI

Isha duke shkrojtur një fejtton për shërbimin telefonik të qytetit tonë, mbi defektet e rastit dhe mbi vonesat e riparimit. Sapo shkrojta diçka mbi njoftimin e defektit në zyrën teknike, ra zilja e telefonit mbi tryezë.

Nuk u habita, pasi besoja në telepatinë, prandaj kapa receptorin. Një zë i furishëm dhe energjik buçiti në veshin tim.

— Aty është Çeço Damo?

— Kush e kërkon, ju lutem?

— More, lëre kush e kërkon. Kjo nuk është puna jote! Pyes, a ndodhet aty?

— Më falni, por ai nuk bisedon me njerëz që nuk i tregojnë as emrin në telefon! E ka si parim!

— More, ja tregoj unë parimet atij, po i thuaj të më presë aty! Oj, kërkoka edhe emrin! Mos do edhe emrin e nënës apo të gjyshes? Çfarë burokrati! Të më presë, se erdha!

— Më falni, por ka mundësi që ai të mos ju presë, kur nuk e di se kë duhet të presë. E ka si parim!

— Të mos qederoset, se arrita! Ja ndreq unë samarin atij! Të mos mërzhitet, se erdha!

— Shok, mos e ngatërroni me ndonjë tjetër, se ai nuk mban samar!

— Të më presë aty pa tjetër!

— Më falni, po me se do të vini ju dhe me se t'ju presë ai?

— Do të vij urgjent me taksi. Më pret te dera!

— Më falni për keqkuptimin! Unë nuk e kisha fjalën te mjete i transportit... Dua të di, nëse ju do të vini me topuz, me kobure, me karabinë, apo me murtajë? Që edhe ai të zgjedhë diçka reciproke.

— Atë ja tregoj unë, me se do të vij! — Dhe gypi u përplas me furi.

Mendova se kjo do të qe shaka e ndonjë shokut tim, prandaj s'e pashë me vend të merrja ndonjë masë preventive dhe as të lajmëroja policinë, apo shefin tim. As zjarrfikësit.

Vijoja punën mbi fejtonin, i sigurtë se dikur do ta mbaroja. Kur, sipas meje, tekniku i linjës duhej të trokiste në derë, dera e zyrës sime u hap me tramundanë dhe brenda hyri një burrë kokoroç rreth të dyzetave, me një tufë flokësh të ngritur për-pjetë, nuk dihej për ç'arësye dhe me ca mustaqe si rrip sahati.

— Ti, je Çeço Damo? — Oshëtiu një zë basi.

— Dora vetë, vula mungon! Ju mos vini nga postë-telegrafa? — Pyeta unë pa dashur dhe me sa duket, pa takt.

— Ta tregoj unë postë-telegrafën ty! Përse dhe me ç'të drejtë më ke bërë paçavure në këtë artikullin tënd të ndyrë? — Dhe ai përplasi mbi tryezë një copë gazetë të prerë, ku qe botuar një fejtoni im. Pastaj përplasi edhe grushtin e tij të rëndë, nga i cili kërciti jo vetëm tryeza po edhe dyshemeja.

E mora me kurajë dhe me kujdes fejtonin, du-



ke dyshuar se mos edhe ky xhest e zemëronte akoma më tepër të sapoardhurin. E, meqë ai nuk reagoi, fillova ta lexoja me vëmendje. Them me vëmendje, pasi kisha gjashtë muaj që e kisha botuar dhe kujtesën nuk e kam aq, sa duan sot kërkesat e kohës dhe të njerëzve.

— Më falni, po ju jeni arësimtari në fjalë?

— Jo, unë jam mjeku në fjalë. Dhe prandaj protestoj kategorikisht. Me ç'të drejtë emri im futet në gjithfarë kallëpesh? Çfarë, mos kam gjë emër eksperimental unë? Një herë më bëni arësimtar, pastaj shofer, pastaj zooteknik, e ç't'ju shkrepet tjetër! Kush jua dha këtë të drejtë që të diskreditoni botërisht emrin tim të nderuar? A e keni lexuar kushtetutën? Po të drejtat e qytetarit?

— Shoku mjek! Me sa shikoj, këtu ka një keqkuptim. Ky fejton është një kritikë konkrete. Ne kritikojmë këtu një njeri me emër të caktuar dhe me adresë të caktuar. E kemi fjalën për arësimtarin Rexho Bulo, nga fshati Bregas i cili, në vend të aritmetikës, u mëson fëmijëve kaladibrancën! Pra, ju jeni shqetësuar kot!

— Ashtu, ë? Kot, thua... Ta tregoj unë kotësinë ty! Nuk më thua, pse gjete të kritikosh pikërisht një arësimtar që mban emrin tim dhe jo ndonjë tjetër? Apo ka pak arësimtarë? Apo pak gabojnë ata? Hë, de, folë!

— Po, arësimtarë ka shumë. Dhe gabimet e tyre, ka mundësi të jenë të shumta. Por këtu është fjala për një arësimtar të caktuar dhe për një gabim të caktuar, të përsëritur, bile.

— Dhe pse u dashka të përgjigjem unë pastaj?

— Askush nuk kërkon përgjigje nga ju! Bile

neve na ka ardhur me kohë përgjigja nga arësimitari në fjalë. Ai na falnderon për kritikën.

— Aq më bën mua! Ai, bile, mundet që edhe t'ju qerasë për këtë, po unë pse të hyj në valle? Apo pse di të kërcej?! Ç'keni me emrin tim? Ku ju shpie kali? Mos vallë gabojnë vetëm njerëzit që mbajnë emrin tim? Askush tjetër? Kjo është poshtërsi! Unë, do më shikoni ju! Sikur të ishim nja 30 vjet më të vegjël, do të t'i përsheshja këta turinj të karamuar!

— Doktor, mbajeni vehten, ju lutem! Mos u bëni kot për doktor, pasi unë nuk kam haber nga medicina!

— Ashtu, ë? Ta tregoj unë medicinën ty! Do të të hedh në gjyq! Që tani bile! Do të shkoj atje, sa të mos kem më ku të vete! Do vë në dijeni të gjitha organet! Deri te Kryeministria! Ke për të parë ti! O do të të pushoj nga puna, o do ja heq vetes!

Unë, që nuk dëshiroja as të parën as të dytën, bëra çmos ta sqaroja. Por më kot! Kështu u ndamë. . .

. . . Ai bëri gjithshka sa mundi! Por, as mua nuk më pushoi dhe as vetes nuk ja hoqi dot! Bile nuk tregoi (siç doli më pas), se me personin që kritikohet konkretisht e lidhte diçka. Arësimitari në fjalë që baxhanaku i shefit të tij.

Prandaj, qenka më mirë që, përpara se të kritikosh ndonjë të tillë, t'i ndryshosh emrin.

PËRSE S'KA JETË NË POLE?

(Diskutim shkëncor, por jo fantastik)

I dashur Arsen!

Sapo lexova artikullin tënd, «Përse s'ka jetë në pole?» të të them të drejtën më ka hipur gjaku në kokë dhe, për të mos bërë ndonjë gjë më të madhe, vendosa të të shkruaja vetë. Nuk e pashë të udhës të të kundërshtoja në shtyp.

Ne jemi shokë fëmijërie dhe, po nuk u morëm dot vesh me letra intime, si mund të mirëkuptohemi me artikuj kritikë nëpër gazeta apo revista? Besoj se edhe ti nuk ke ndonjë kundërshtim në këtë pikë.

Le të kthehemi tani te tema, «Përse s'ka jetë në pole?». Me të vërtetë: «Përse s'ka jetë në pole?»

Ti, i dashur Arsen, pajtohesh me tezën e vjetër mbi ndryshimin e klimave. Dhe ç'nuk thua për musonet e supermusonet, për tajfungun dhe Golfstrimin, për ajzbergët, reshjet dhe stuhitë. Pastaj shkon e futesh në shirat e thata dhe del në reshjet e zjarrta. Pas këtij dushi, ti shkon e hyn në xhunglat pa fund të Amazonës e, fill pas kësaj, humbet në tajgën shekullore.

Unë çuditem me ty, Arsen. Mirë që nuk lodhesh nga gjithë këto ekskursione polemike, po si nuk mërzitesh xhanëm?

Pra ti je dakord që në pole nuk mund të jeto-
het për shkak të temperaturës shumë të ulët. Kur-
se unë ja ku po të them: Jo, jo dhe deri në fund,
jo! Jo, 100 herë jo! Arësyeja juaj nuk qëndron, se-
pse nuk ka asnjë bazë shkencore. Bile çuditem se
si ti, Arsen, me këtë emër që rrjedh nga fjala «arë-
sye», vete e arësyejon mbi jetën në pole!

E pranoj se nuk jam shkencëtar, si ata që nxje-
rrin teza dhe hipoteza, parabola dhe hiperbola, por
ama, ligjet themeltare të natyrës i di mirë.

Unë çuditem me ju shkencëtarët, Arsen! Ju, që
shpikët çdo gjë, që nga uthulla e deri te kiberne-
tika, ju, që mund të përcaktoni me saktësi se me
ç'pirun i hëngri Tamerlani trutë e Bajazitit, me ç'fyell
ka magjepsur muzat Orfeu, me ç'hanxhar u vra Ce-
zari, apo me ç'kupë u helmua Sokrati, ju, pra, shkoni
e humbisni pikë në çështje kaq modeste.

Si e harroni kaq shpejt ju shkencëtarët logjikën
e pamposhtur të natyrës mëmë? Si nuk i përfillni
pak ligjet e harmonisë, të ekuilibrit dhe të simetri-
së? Se ndryshe, si do të shpjegohej, i dashur Arsen,
që natyra në ekuator të stiste gjithfarë krijesash ele-
gante për t'u marrë kokën, ndërsa në pole vetëm
shkretërirë akulli?

Përveç kësaj, ju shkencëtarët harroni dhe dy
faktorë vendimtarë në këtë pikë: territorin gjeogra-
fik dhe profesionin,

Le të marrim së pari këtë të fundit. Ti je shken-
cëtar por, po të ishe palombar, nuk do të arësyejoje
kështu mbi jetën në pole. Ose të thellohemi në shem-
buj të tjerë.

Napoleoni kurrë nuk do të kishte hipur aq lart, po të ishte marrë me kërcim së larti. Gjithashtu muzika sot do që shumë e varfër, sikur kompozitorët e mëdhenj të qenë marrë jo me muzikë, por me ngritje peshash!

Tani le të kthehemi te territori gjeografik. Nju-toni nuk do ta kishte zbuluar as sot e kësaj dite gravitetin e Tokës, sikur të kishte banuar në Hënë. Gjithashtu nuk të garantoj dot se si do të pritej në Luksemburg treni fantasik i Ajnshtajnit me një gjatësi prej një milion e dyqind mijë kilometrash. Po ashtu edhe teoria e tij e relativitetit në Mars vështirë të pinte ujë (edhe nëse atje ka ujëra të pijshme).

Pastaj, mendo të lutem, si mund të zvarrise-shin në shkerëtirën e Saharës krokodilët dhe peshkaqenët?

Kështu pra, kushtet gjeografike nuk duhen injoruar. Jo pse ato luajnë ndonjë rol fatal në këtë çështje që po diskutojmë, porse ndikojnë mbi të deri në atë masë saqë, po të mos i marrim parasysh, përfundimi do të dalë i pasaktë.

Ja, ta zëmë se ti jeton në një mal të mbuluar nga bora. Në këto kushte, ti pak do mendosh mbi dobinë e plugimeve të thella në fushë, përse duhet kryer qilizma, apo përse u hanë brirët buajve.

Pra jemi te polet. Tani përgjigja pothuaj është unifikuar. E megjithatë e vërteta qëndron krejt ndryshe, e fshehur po aty në pole, në një kohë kur mendimet për këtë çështje nuk jepen të gjitha nga polet. Duhet menduar se natyra, që krijoi njerëz edhe në shkretëtirë, po ashtu fare lehtë mund të krijonte njerëz edhe në pole. Fare mirë mbi lëkurë natyra këtyre njerëzve mund t'u dhuronte gëzof natyral. Kjo nuk do t'i prekte fare rezervat e saj natyrale të gëzofit.

Përkundrazi! Natyra i ka mbrojtur me fanatizëm të tërbuar polet. Sapo ndonjë individ apo ekspeditë nisej për në pole, natyra vërsulej dhe i fshinte nga faqja e dheut, duke i mbuluar ato përjetësisht me akull.

Ti i di më mirë nga unë fatet e ekspeditave polare. Ngado që i aviteshin polit, si nga toka, nga deti apo nga ajri, përfundimi ishte po ai: pesë me hiç!

Vetëm tani me mjetet më moderne natyra ka bërë disa lëshime të vogla. Lind pyetja: përse natyra i mbron polet me kaq fanatizëm dhe këmbëngulje?

Unë jetoj buzë detit. Këtë e dinë të gjithë. Të them të drejtën nuk di ku kanë jetuar shkencëtarët që janë marrë me polet. Por ma ha mendja që shkencëtarët e poleve të mos kenë jetuar kurrë buzë deteve. Ndryshe s'ka se si shpjegohet miopia e tyre.

Eh, ti, Arsen! Ç'të të them! Ti nuk e njeh detin dhe as buzën e detit.

Të jam lutur kaq herë ta kalosh lejen këtu, por ti ende s'po vjen. Eja, eja këtu, të lutem, qoftë në muajin korrik, qoftë në muajin gusht! Apo nuk mblidhen këtu! Sportistë nga të gjitha llojet dhe degët e sportit me në krye futbollistët, muzikantë nga të gjitha gjinitë, me në krye ata të operës, poetë e prozatorë nga të gjitha moshat dhe sekset, piktorë, mjekë e ku ta di unë. Me kënaqësi të parrëfyer mbërrijnë këtu nëpunësa që nga referentët e deri te shefat e shefave.

Siç e merr me mend pra, këtu në verë mblidhen të gjithë; me shërbim e pa shërbim. Vetëm ti mbete! Vera buzë detit i ngjan kështu një panairi të vërtetë njerëzish. Vijnë këtu edhe për diell, edhe për

rërë, edhe për det, edhe për ajër, edhe për t'u martuar, edhe për t'u ndarë!

Vetëm shkencëtarët e poleve nuk po duken gjëkund! Sikur të vinte me të vërtetë ndonjëri nga ju, menjëherë do t'i kujtohej ligji i ekuilibrit. Ja, unë, duke i parë të gjitha këto, mendoj kështu. «Po sikur edhe në polet, në vend të akullnajave të kishte rivi-
era plot rërë e diell, si këtu, atëherë qysh do t'i bëhej hallit kur të vërshonin aty nga të katër anët e botës?»

Dhe mos harro se atje është pol dhe jo ekuator! Pra, duke vërshuar aty turmat e panumërta me njerëz të shquar dhe të pashquar, ekuilibri i tokës do të lëkundej menjëherë, dhe atëkohë rruzulli ynë fatkeq do të përmbysesh në humnerat e pafundme të gjithësisë.

Ja pse natyra i mbron me kaq fanatizëm polet dhe i ruan e i lejon ato vetëm sa për ndonjë eksperiment shkencor!

NJË MBLEDHJE PËR DASHURINË

Unë nuk desha të zgjidhesha sekretar i organizatës së rinisë në shkollë. Kjo, jo pse u shmangem detyrave që të ngarkon kjo përgjegjësi. Jo, njerëzit mund të ngarkohen me detyra edhe pa patur ndonjë përgjegjësi.

Disa mendonin se unë përbëja, si të thuash, një farë opozite me drejtorin e shkollës, gjë që nuk është aspak e vërtetë.

E mohoj këtë, jo pse dua t'i bëhet qejfi drejtorit, porse s'ka si të marr përsipër gjëra të pangjara. Ndërgjegja nuk duhet ngarkuar me ato që s'ka, por me ato që ka.

Mendohet kështu nga disa, pasi që një rasë që unë dhe drejtori shprehëm pikëpamje të kundërta lidhur me organizimin e një ekskursioni në shkollë shkollë.

Drejtori që i mendimit që ekskursionin ta bënim në Apolloni, kurse unë propozova për në liqejtë e Lurës. Vetëm kaq! Po të tjerët e morën për kapital dhe thonë se jemi në opozitë. Ja si të ngatërrojnë nganjëherë me tjetrin!

Nejse, këto u harruan. Kisha të tjera telashe unë. Duhej të organizoja një mbledhje. Por, më

mundonte rendi i ditës. Nuk doja një rend dite si ato të herëve të tjera. Duhej variacion.

Për këtë u konsultova edhe zëvendësen time, shoqen Parashqevi. I shpreha asaj pikëpamjet e mia lidhur me këtë mbledhje dhe ajo u entuziazmu.

Gjithnjë me konsultime dhe me rrugë kolegjinale, ja bëra të njohur edhe byrosë këtë mendim. Pata një farë drojtje se mos kushedi, mund të mos ma aprovonin, por ata më duartrokitën!

Pas dy orësh e afishuam këtë lajmërim në stendë.

« LAJMËRIM »

LAJMËROHEN TË GJITHË ANËTARËT E ORGANIZATËS SË RINISË SE DITËN E ENJTE DATË _____, KEMI MBLEDHJEN E ORGANIZATËS ME KËTË REND DITË:

« Ç'ËSHTË DASHURIA »

Do të flasë shoqja R...

Nga byroja e organizatës së rinisë.

Fill pas afishimit, stenda u mbush plot e përplot me nxënës dhe pedagogë. Reagimet qenë nga më të ndryshmet, por në shumicë ato ishin pozitive. Shumë nxënës më buzëqeshnin, kurse disa shoqe të klasës më thanë se qenkësja në hall për këtë punë.

Këtu filluan edhe komentet. Disa thoshnin se sekretari i rinisë na paska rënë në dashuri dhe nuk di si t'ja bëjë këtij halli. Disa të tjerë mendonin se gjithë byroja na paska rënë në dashuri. Por, këto ishin shakara shkolle, pa të keq.

Në pushimin e orës së parë më lajmëruan se më kërkonte drejtori. U nisa i bindur se kjo thirrje kishte të bënte me lajmërimin.

Trokita me edukatë në derën e drejtorit dhe hyra, pasi mora aprovimin e tij për ta shtyrë derën. Duhet të shënoj se dera e drejtorit tonë nuk hapet kollaj. Atë duhet ta shtysh me gjithë forcën e shpatullave, pa t'ja dalësh mbanë asaj pune.

Drejtorin e gjeta të vrenjtur dhe tymi i dendur i duhanit e bënte edhe më të rëndë. Më shikoi një copë herë në sy, gjë që unë nuk ja mora për të keq. Është më mirë kur të shikojnë në sy.

— A mund të më thuash se kush e ka afishuar aty në stendë atë lajmërim skandaloz? — Qe pyetja e tij e parë.

— Më duket se lajmërimi kishte një nënshkrim!
— Ju përgjegja.

— Aha, nuk qenqam gabuar! Këtu është dora jote.

— Jo! Këtu është dora e byrosë sonë. Pra, më falni, por më duket se jeni gabuar pak! — I thashë me një notë të zbetë ironie.

— Shoku sekretar i byrosë! Në doni të dini, unë personalisht nuk kam qenë dakord që ti të ngar-koheshe me këtë detyrë. Jo se kam ndonjë gjë personale me ty. Por, vetëm se e di mirë që ti je një tip ekstremist. Veç kësaj, ke edhe shpirtin e kundërshtimit!

— Ta zëmë se është ashtu, shoku drejtor. Po a

mund të më shpjegoni se ku qëndron në këtë mes ekstremizmi dhe shpirti i kundërshtimit tek unë? Apo te biseda se ç'është dashuria? Mos vallë ata që duan të dinë diçka për dashurinë qenkan ekstremistë dhe me shpirt kundërshtues?

Këto ja thashë me një frymë, jo se jam bilbil nga goja. Mua edhe tani më merret shpesh goja. Po kjo ngjet, kur e kuptoj dhe vetë se nuk kam të drejtë. Ose kur nuk e gjej dot argumentin që më duhet. Sa për këtë radhë, puna qëndronte ndryshe:

— E di që nuk të mungon ironia! Bile, disa thonë se ke prirje për letërsi. Po këtë prirje do ta sqarojmë më mirë në fund të vitit, në provimin e fizikës! — më tha ai qetë-qetë, si një njeri që është tepër i sigurtë në ato që flet.

— Më sa di unë, shoku drejtor, prirjet për letërsi nuk shfaqen përherë në lëndën e fizikës! Besoj se edhe Ajnshtajni nuk do të ma kundërshtonte këtë mendim!

— Ashtu ë? E megjithatë, ka për t'u bërë kështu si them unë, dhe jo ashtu siç mendon ti me Ajnshtajnin! Nejse, tani shko dhe hiqe atë lajmërim qesharak!

— Më falni, po mua nuk më duket aspak qesharake një bisedë për dashurinë. Të kjo ndjenjë e pas-tër në shoqërinë tonë, askush nuk shikon ndonjë gjë për të qeshur! Sa për ta hequr lajmërimin, unë nuk e kam këtë të drejtë. Po deshët, veproni vetë!

Në këto e sipër, hyri pedagogu i fiskulturës, që është njëkohësisht edhe sekretar i byrosë së partisë në shkollë.

Ardhja e tij për mua qe e dëshiruar, pasi me pedagogun e fiskulturës kam mirëkuptim të plotë. Jo vetëm unë. Kam vënë re, se në shkollë të mesme

të gjithë të rinjtë më mirë se më këdo tjetër ja kalojnë me pedagogun e fiskulturës.

— Një veprim skandaloz, shoku Mete! — Ju drejtua atij drejtori, ndoshta për t'i dalë përpara situatës. — Kërkojnë të bëjnë një bisedë mbi dashurinë! Dhe kjo na duhej! Edhe pa bërë biseda të tilla dhe disa nuk më duken në rregull në këtë drejtim! Lëre se ç'do të vejë pastaj, pas një bisedë si kjo...

— Unë nuk shikoj ndonjë gjë të keqe në këtë mes, shoku drejtor! Bile këtu shikoj një plotësim të boshllëqeve në programet tona mësimore, si të thuash.

— Si? Ju mendoni se dashuria u dashka futur si lëndë më vete? I bukur mendim, shoku sekretar, i bukur mendim! I ndritur, bile!

— Edhe aq i bukur apo i ndritur mund të mos jetë, po unë nuk e pata fjalën që të futet pa tjetër si lëndë më vete. Do të mjaftonte një kapitull në një nga lëndët e tjera.

— Mos do dëshironit që këtë kapitull interesant t'ja shtonim fiskulturës? — Pyeti drejtori me një ironi aq të hapët, saqë mua më erdhi shumë keq për të.

— Unë nuk jam aq ngushtë për ta ndarë lëndën në kapituj. Se ka të tjerë që këtë lëndë e fillojnë pa larë sytë dhe pa mësues.

Ata u futën thellë dhe nëpërmjet një rruge, e cila nuk më ngjante si e mirëkuptueshme. Dhe më dukej sikur unë isha shkaku.

Pra, duhej që edhe pasoja të binte mbi mua. Unë nuk desha dhe nuk kisha parashikuar që ngjarjet të merrnin këtë drejtim.

— Po mirë, shoqen R. a e ke njoftuar dhe a ke marrë pëlqimin nga ajo? — Më pyeti mua drejtori.

— E kam njoftuar, dua të them, i jam drejtuar zyrtarisht dhe ajo e priti me kënaqësi kërkesën tonë. A mund të largohem, shoku drejtor? — Ja kërkoja këtë leje, se e pashë që me kaq mjaftonte për këtë herë. Dhe ai, në mirëkuptim, më lejoi të largohesha.

— Sa për shoqen R. unë kam për të folur vetë me të! — Tha ai.

— Po të keni ndonjë kundërshtim lidhur me shoqen R., a mund të na e zhvilloni ju vetë këtë bisedë, shoku drejtor? — E pyeta.

— Shoku sekretar i rinisë! Mos harro se, në radhë të parë, ti je nxënësi im. Si i tillë nuk të lejohet të flasësh kështu me mua. Ka norma, ka rregulla, ka edukatë!

— Më falni, po pse ma morët për të keq, shoku drejtor. Unë sa bëra një kërkesë dhe asgjë tjetër. Shoqja R. u tregua aq e gatshme dhe aq entuziazte, saqë mua nuk më shkoi ndër mend se një kërkesë si kjo përbëka mungesë edukate.

— Edhe unë, pak a shumë i këtij mendimi jam!

— Tha pedagogu i fiskulturës.

Në këto e sipër, unë dola. E pashë se nuk ishte aq lehtë të bëje një bisedë për dashurinë në shkollën tonë. Merre me mend pastaj, sikur të kishe një kërkesë për të bërë, jo një bisedë të tillë, por thjesht, dashuri... Nuk di çfarë do të mendonte për këtë drejtori ynë. Ndoshta këtë mund ta marr vesh në fund të vitit në provimin e fizikës.

SEKONDAT E XANIT

Kur ne hymë në mbledhje, Xani qe ngritur më këmbë. Kuptohet se të ngriturit e tij më këmbë kishte të bënte me etiketën e pritjes.

Ne e kishim për detyrë të shkonim në mbledhje, por kjo s'donte të thoshte se dikush duhej të ngrihej më këmbë, sidomos kur hyn me vonesë. Vonetat askush nuk i respekton.

Xani pra qe ngritur dhe priste të vendosej qetësisia absolute. Fshiu njëherë hundën me shami, u kollit më të thatë nja dy herë dhe pastaj fshiu prapë hundën. Pastaj fshiu buzët, mjekrën, qafën dhe liroi kopsën e fundit të jelekut. Ky qe veprimi i tij i fundit para se të fillonte.

Edhe sot ruhet në fonotekën muze zëri tij në atë mbledhje.

— Shokë, keni mendjen! Sot kam bërë një gabim të rëndë. Shumë të rëndë. Eh, sikur ta kuptonit ju se sa rëndë kam gabuar unë sot!

Megjithëse ne nuk e dinim se sa rëndë kishte gabuar shoku ynë i dashur dhe i sinqertë, dhe përse ky gabim qe lënë pikërisht për sot, prapëseprapë u prekëm dhe u mallëngjyem. Bile edhe Sotiri, arkëtar i ynë, për të cilin shokët thonë me shaka se është

një shpirtkasafortë, i mbushi sytë me lot! Dhe, megjithëse sa vinte e sytë i mbusheshin plot e përplot me lot, ai nuk po u vinte kyçin.

Xani, i prekur edhe më shumë nga lotët e arkëtarit, vijoi:

— Ju, shokë, duhet të më dëgjoni me vëmendje, pasi unë sot kam rrëshqitur keq. Pasi të më keni dëgjuar me vëmendje, do t'ju lutesha shumë të më dënoni sa më rëndë. E kërkoj me këmbëngulje këtë, pasi kështu do të sigurohem se nuk do ta përsërit kurrën e kurrës të pabërën e sotme.

Dhe, ndërsa ne mendonim se çfarë dënimi do të qe më i përshtatshëm për shokun tonë fatkeq, lidhur me atë të pabërën e tij të sotme, ai vijonte:

— Sot, o shokë, kam ardhur në punë me një vonesë kolosale dhe të pajustificuar. Kjo nuk më kishte ndodhur kurrë. Dhe më ndodhi pikërisht sot, kur koha është flori. Dhe as që e pandehja se do më ndodhte ndonjëherë. Po ja që më ndodhi! Ke ç'i bën kësaj?

Nuk i thonë shaka. Tri minuta, katër sekonda e gjashtë të dhjetat vonesë! Gjithsejt 184 sekonda e gjashtë të dhjetat, ose, 1846 të dhjetat e sekondës vonesë! Dhe të mos harrojmë asnjëherë se koha është flori! Pra unë, shokë, kam vënë dorë mbi floririn; si të thuash, mbi arkën e shtetit, apo si të them...

Ndërkohë Sotir arkëtari kontrollloi xhepat me ngut se mos i mungonin çelësat e kasafortës. Por u qetësua shpejt. Atij më lehtë mund t'i merrje shpirtin se sa çelësat e kasafortës.

Xani vazhdonte të shprehte mendimet e tija mbi kohën (jo nga ana sinoptike), mbi floririn, mbi se-



kondat, vonesat dhe të dhjetat e sekondës. Fill pas Xanit u ngrit Turhani.

— Është e vërtetë se koha është flori, por jo çdo kohë, ama! Fjala vjen, koha e gjumit nuk është as flori, as tallash! As vajtja në stadium nuk ka të bëjë me floririn. Shoku Xani përse nuk na tha çfarë bëri ai pasi erdhi me tri minuta vonesë në zyrë për ta vënë në vend këtë kohë të humbur? Përse harxhoi këtu edhe 35 minuta duke vajtuar për ato tri minuta? Xani, sapo hyri në zyrë sot në mëngjes, tha: «Jazëk i qoftë «17 Nëntorit!»! Haram bukën dhe këpucët. Pse, ashtu luhet? Haram e pastë edhe «Besa» që nuk i futi 17 gola!» «Si? — kërceu përpjetë shofer Petrua, që kishte lënë gazin te hyrja me motor të ndezur. «Si? Ti guxon të ofendosh «17 Nëntorin»? Po kush ta dha këtë të drejtë, o karafil? Nga vjen ti kështu? Dhe a e ke larë gojën me laneu para se të përflasësh «17 Nëntorin?» Kaq deshí puna. Petrua zbrazí gjithë serbatorin e benzinës aty ku Xani na ndezi shkrepse. Oksigjen po kishte me bollëk. Dhe erdhi e t'u bë një pështjellim që as zjarrfikësit nuk do ja gjenin dot anën.

Kështu fluturuan tri orë e gjysmë me sherr e shamata. E meqë «17 Nëntori» — «Besa» dolën barazim, edhe Xani me Petron barazuan, pasi i humbën shtetit shtatë orë punë. Ja për këtë mendoj se duhej të kishte folur me aq pasion shoku Xani, dhe jo për ato tri minutat e përgjumura të vonesës.

Turhani u ul dhe tamam sikur të luanin në një lëkundës fëmijësh, u ngrit automatikisht Xani më këmbë. Ne tashmë i kishim harruar ato tri minutat e vonesës dhe po mendonim për ato shtatë orët që Xani kishte djegur me shkrepse e tij në serbatorin

e Petros. Sikur pendimi ta brente me proporcionin e tri minutave, të gjorit Xani, duhej t'i bënim nekrologjinë!

Ishte burrë i mirë! Për tri minuta dhe çfarë pikëllimi, po për shtatë orë? Sipas rregullit të treshit, Xani duhej të hidhej nga kati i katërt. Prandaj nekrologjia duhej të qe gati për çdo rast! Ku ta dije? Ama, me të vërtetë ka qenë burrë i mirë. Këtë nuk ja mohon dot. Dhe bash pse ka qenë burrë i mirë e me mend, ai nuk u hodh nga kati i katërt për shtatë orë të djegura! Ai vetëm se u hodh nga karrigja, por kjo nuk pati ndonjë pasojë. Dyshemeja qe shtruar me parket. Dhe autokritika e bërë mbi këtë lloj parketi tingëllonte më e pastër, se ata zërat kur i dëgjojmë për të parën herë.

SHEFI I SHEFIT

Atë ditë në një rën nga zyrrat këtu rrotull, u zhvillua kjo bisedë.

— Shoku Malo — ja nisi pak si me drojtje Halimi — nëse ka mundësi, desha t'ju bëja të ditur diçka...

— Si? — pyeti shefi me një habi jo të zakonshme, duke ngritur kokën nga dosjet. — Ti po më drejtohesh mua direkt? Po instancat ndërmjetëse pse nuk i respekton? Ku jemi këtu? Ka apo nuk ka rregulla? Si kërkon ta injorosh direkt shefin tënd? Jo, byrazer! Qeveria ka vendosur ligje dhe rregulla. Për mua nuk ka gjë më të shenjtë se rregulli. Po u thye rregulli, mbaroi çdo gjë. Ja e shikon këtë kalendarin këtu? — E pyeti shefi duke i treguar me dorë kalendarin e tryezës. — Ky pra është një kalendar tavoline! Apo jo? Pa merreni me mend sikur një ditë të mos e gjeja mbi tryezë, por në parmakun e dritares apo në mur të varur. A mund ta duroja një gjë të tillë? Si thua? Prano që ke bërë gabim!..

— Dakord, por...

— Mor këtu s'ka as por, as... Këtu ka rregulla. Ti, më parë lipset t'i drejtosh shokut Tono, shefit tënd direkt. Po qe se ai nuk të zgjidh punë, atëhere

unë, si instancë direkte superiore mbi shokun Tono, do vë dorë pa vonesë mbi çështjen në fjalë.

— Por ju nuk e dini ende çështjen në fjalë, ajo. . .

— Dhe as që dua ta di. Unë pikësëpari di mirë se jam brenda rregullit. A më kupton? E, po qe se je brenda rregullit, nuk të intereson asnjë çështje, goftë në fjalë, goftë në letër.

— Ashtu, si urdhëroni, veçse. . .

— Mor, po në daç thuaj ndryshe. Ke ç'ke, drejtoju shefit tënd. Ka hierarqi këtu, apo jo? Po të mos kish hierarqi, ndryshonte puna por, sapo që ka, atëhere duhet respektuar.

— Po hierarqia në këtë rast. . .

— Posi, posi, hierarqia në çdo rast duhet respektuar. Pa hierarqi nuk ka shtet dhe pa shtet nuk ka hierarqi.

— Puna është se. . .

— Sido që të jetë, nuk je ti në rregull. Pra të thashë që në krye, kthehu te shefi yt direkt. Është mirë që, edhe kur të më përshëndesësh, «mirë mëngjez», apo «ditën e mirë», të ma thuash me ndërmjetësinë e shefit direkt. A e kupton? Çdo gjë! Qofshin çështje private apo çështje shërbimi!

Halimi, megjithëse ishte tip i durueshëm e këmbëngulës, e pa se këtë radhë duhej të tërhiqej.

— A mund të largohem?

— Edhe kjo duhej me anën e shefit direkt, (!) por megjithatë mund të largohesh! . . .

Duke hapur derën, Halimi bëri orvajtjen e fundit, por pa sukses.

Ai hyri i dëshpëruar në zyrën e Tonos dhe i bëri të ditur përfundimin e takimit të pafat me shefin e shefit të vet.

Tonua bëri buzën në gaz dhe u ngrit e i vajti

vetë shefit të tij. Kur mori vesh shefi i shefit, se si qëndronte puna, thirri me urgjencë në zyrën e tij Halimin.

Sapo Halimi u fut brenda, shefi i shefit shpërtheu:

— Po pse, mor i uruar, po pse, shoku Halim, pse nuk ma the që në krye se si qëndronte puna?

— Dakord, po janë rregullat, hierarqia. Unë kam një shef direkt dhe, sidoqoftë, çdo gjë duhet t'jua kaloj me anën e tij.

— Shi... shiko sa i ngurtë. Po a e kupton se duhen bërë edhe përjashtime?..

— Ashtu, ashtu, po ja, sikur ky kalendari i tavolinës të gjendej i varur në mur.(!)

— Mor po lëri këta kalendarët, se nuk kanë të bëjnë fare me çështjen. Ti duhej të vije direkt tek unë. Nuk bëre mirë që çështjet e mia familjare i bisedove poshtë e lart.

— Ju lutem, shoku shef! Unë nuk i bisedova poshtë e lart, por vetëm me shokun Tono sipas urdhërit tuaj. Kështu e kërkon rregulli, hierarqia.

— Sidoqoftë për çështjet familjare hierarqia mund të mos respektohet. Tani më thuaj, në ç'orë im bir kërceu nga kati i dytë duke rënë mbi aku-lloren ambulante?

— Këtë ja kam bërë të ditur shokut Tono. Nuk ju ka sqaruar?

— Lëre pra, shokun Tono!

— Si ta lë, kur e kam shef direkt? Unë nuk mund t'i thyej rregullat!

— Shoku Halim, lëri këto rregulla dhe më sqaroni si qe puna. A pësoi gjë im bir?

— Edhe këtë ja kam bërë të ditur shokut Tono.

— Mor po lëreni pra të qetë shokun Tono, ç'na



duhen formalizmat? Kur të pyes unë, harroje shokun Tono!

— Kjo nuk ka si bëhet. E kam shef. Merreni me mend ç'do të bëhej një ditë, sikur kalendari i murit të gjendej mbi tavolinë.(!)

— Lëreni pra të qetë kalendarin e murit. Ai ka vendin e tij. Dhe shefi direkt ka vendin e tij. Por, kur çështja ka të bëjë direkt me mua, ti lipset pa vonesë të vish e të më raportosh direkt. Ky është operativitet, stil i ri në punë. Larg formalizmave, larg zvarritjeve burokratike. A e kuptoni këtë, shoku Halim?

— Puna është që ta kuptojmë të gjithë, shoku shef. Se thonë që behari nuk vjen me një dallëndyshe.

— Posi, posi. Ç'është një dallëndyshe? Duhet edhe bilbilat, edhe lejlekët, edhe gardalinat!..

— Sidomos kanarinat.

— Kanarinat? Hë, po! Mirë pra, dhe tani më çoni në vendin e ngjarjes — tha duke mbyllur me kujdes e rregull dosjen.

— Nuk është nevoja të ndërmjetësojë shoku Tono? — Pyeti më dyshas Halimi.

— Bah, ç'na duhet shoku Tono, kur ne të dy e flasim për mrekulli shqipen — tha shefi.

— E flasim, po vesh nuk merremi — ja ktheu tjetri.

Tregim i jetuar

FUNKSIONET E KAPELES

Para se të martoheshim, midis konditave të tjera, ime shoqe më vuri edhe një konditë të tillë: pas martesës, unë duhej të mbaja kapelë dhe të mos dilja më rrugëve kryeqendore.

Meqë kjo konditë nuk ishte gjë në krahasim me të tjerat, unë nuk e pashë me vend të kërkoja sqarime. Zakonisht sqarimet kanë më tepër romantikë pas martesë. Po për këtë arsye nuk m'u dha të mendoja as për pasojat e një koke e cila del në rrugë me kapele.

Unë vazhdoja të dilja pa kapele. Edhe ditët kalonin një nga një gjithashtu pa kapele. Erdhi më në fund edhe dita e dasmës.

Muajin e mjaltit e bëmë në plazh. Gruaja më kujtoi menjëherë për kapelen që nuk e kisha. I thashë se në plazh nuk më hynte gjë në punë kapelja. Doja rreze dhe jo kapele.

— Po këtu, mor burrë, të gjithë mbajnë kapele! Edhe ata që nuk kanë mbajtur ndonjëherë! Ja, shikoi vetë!

Vërtet, në plazh kishte shumë kapele. Kjo nuk më ndihmonte.

— Unë, moj grua e dashur, kam ardhur në plazh jo vetëm për të freskuar trupin, po edhe për të freskuar mendtë. Prandaj nuk mund të mbaj kapele. Kur të kthehem në shtëpi, shohim e bëjmë.

— Çfarë të shohim, mor burrë. Meqë dashke të freskosh trutë, mirë! Po ta lejoj. Ama, me t'u kthyer, kapelen do ta vësh në tren!

— Mirë xhanëm, po unë nuk kam mbajtur asnjëherë kapele. Nuk di ç'lloj kapele duhet të zgjedh.

— Sipas kokës! — më sqaroi me kënaqësi ime shoqe.

Dakord, xhanëm që sipas kokës, po modeli?

— Për këtë do të të bie një libër të tërë.

Unë pandeha se ime shoqe tallej. Si kishte mundësi që për aq gjë të shkruhej një libër i tërë? A nuk u vjen keq për letrën njerëzve?

Po ja që njerëzve nuk u vinte keq për letrën dhe ja që ime shoqe nuk tallej. Pas dy ditësh ajo më la në dorë një libër me titull: «NJERËZIT, KOHA DHE KAPELET».

E mora në duar me respekt këtë thesar të respektuar dhe nisa ta shfletoja. Të 650 faqet e librit mjaftuan që unë të sakrifikoja ditët e muajit të mjaltit.

Për një kapele m'u bë koka dhallë. Mësova, midis të tjerash, se si koha, si njerëzit paskan punuar dhe paskan kontribuar shumë në perfeksionimin e modës së kapeleve.

Po ashtu mësova se, në momente të dhëna politike dhe historike, një modë kapelesh qenka bërë shkak për rrëzimin e qeverisë, apo për shpërndarjen e parlamentit.

Për të mos u zgjatur shumë me ato që mësova nga ai libër, unë vendosa të zgjidhja një nga ato lloje kapelesh, të cilat nuk kishin ndonjë meritë historike.

Me një fjalë, kasketë të zakonshme me strehë kundra diellit. Por, ime shoqe më çau e më ndau për këtë shije.

— Pse mor ditëzi, aq keq qenke katandisur ti, që të mbash një leckë të tillë në kokë? Pa kujto pak fotografinë e tët gjyshi! Pa kujto çfarë kapele mbante ai! Kishte 100 herë më tepër gusto nga ti! Mendo sikur të jetonte tani!

— Ç'lloj kapele mund të zgjidhte sikur të rronte?
— pyeta unë për t'u orientuar në këtë det të stuhishëm.

— «Borsalino» — tha ime shoqe.

— Prishur mos qoftë! — ja ktheva unë me zemërgjerësi.

Që atë mbrëmje mbi kokën time u rras një borsalino që desh më gëlltiti edhe veshët. Ja që nganjëherë edhe veshët e mëdhenj hyjnë në punë. Po hajde e mbushu mendjen disave për këtë!

Merret me mend se gjatë plazhit unë nuk e mbajta kapelen. Futja aty veglat e rrojes, dominotë dhe gurët e shahut. Ime shoqe nuk e kishte vënë re këtë ngarkesë dhe mua një instinkt i sigurt më shtynte që të mos ja tregoja asaj strehimin kolektiv të të gjitha këtyre mjeteve. Mund të vinin pasoja jo në shije të mjaltit.

Kur u kthyem në shtëpi, unë gjeta disa shkaqe për të mos e vënë kapelen. Jo më dhimbte koka, jo më rrinte e vogël, jo më rrinte e madhe... ngjyra, perimetri, lartësia... Po ime shoqe nuk ma zgjati. O të vija kapelen; ose, ose... ajo e dinte se çfarë



do të bënte. Duke mos ditur se çfarë mund të bënte ajo, unë më në fund e rrasa në kokë kapelen. Po ç'e do! Më dukej vetja si i huaj. Edhe nga pasqyra më shikonte me habi një tjetër Çelo! Si të dilja në rrugë? Po sikur të talleshin shokët? Për të zbutur sado-pak këtë elegancë, unë mora me vete edhe çantën e psonive.

— Shumë mirë — tha me entuziazëm gruaja.
— Ja një burrë i kulturuar! Bëre mirë që vendose të psonisësh se unë nuk kam fare kohë.

Pra, desha s'desha, dola të psonisja. Si njeri që kam pak haber nga këto punë, vajta drejt e në sallameri. Sallam kishim blerë edhe të djeshmen por, meqë u futa, nuk bënte të zbrapsesha.

Për bela kishte shumë radhë. Para banakieres rrinin katër vetë me kapele si e imja. Pra nuk isha i vetëm në atë rrebesh.

— Uuu, shoku Çelo, urdhëroni, urdhëroni në radhën time! — më ftoi ai, që nga burrat vinte i pesti në radhë. Ishte Sofua, njëri nga magazinierët tanë. Më zuri ngushtë. Si mund të hyja në radhë si xholi? Unë sapo kisha shkuar! Kjo ishte gjë që s'bëhej.

— Shoku Sofo, falemi nderit, por po pres radhën!

— Uuu, çfarë radhe, mo shoku Çelo! Edhe këta shokët para meje pa radhë janë! Ju jeni njeri i zënë me punë. Jeni personalitet. Për ne është nder i madh që ju lirojmë radhën!

Pashë ata që ishin jashtë radhe. Edhe ata kishin kapele si e imja. Dhe psonisnin jashtë radhë. Dhe pranonin të psonisnin jashtë radhe! Po ja që në radhë filluan reagimet. Qytetarët e tjerë nuk ishin dakord as me Sofon dhe as me ata shokët e tjerë që

po mbanin radhën jashtë radhe. Kjo më dha zemër.
— E keni gabim, shoku Sofo! Ju dhe këta të katër. Koha dhe punët janë njëlloj për të gjithë ata të cilët kanë respekt për të gjithë.

Nga këto fjalë nuk di pse u skuqa edhe vetë. Kur arrita në shtëpi, mora librin, «NJERËZIT, KOHA DHE KAPELET», e hapa në kapitullin, «FUNKSIONET E KAPELES» dhe shënova në fund të këtij kapitulli:

«Disa kapele të veçanta shërbejnë për të psonisur jashtë radhe».

Ime shoqe nuk e pa këtë shënim po, kur ta shikojë, jam i sigurt se mua më pret një polemikë e gjatë.

Nuk di sa do më ndihmojnë disa nga ato koka të veçanta që mbajnë të tilla kapele të veçanta.

MARIFETET E MITROS

Ishim duke lojtur voliboll në palestrën e uzinës. Po këtu kemi vendosur edhe shtyllat e basketbollit, paralelet, hekurat dhe unazat. Është e vërtetë se palestra nuk i plotëson dimensionet e fushës së basketbollit, por ne këtë mungesë e vëmë në vend duke dyfishuar dhe trefishuar kohën e lojës.

Për ta kthyer këtë lokal në palestër na u desh një punë e madhe. Drejtorja ngulte këmbë që lokalin ta kthenim në depo, kryeinxhinieri e donte për garazh, ndërsa ne të rinjtë, palestër.

Të tria palët ishin të vendosur dhe nuk pranonin asnjë kompromis. Krisën fletërrufetë në të katër anët e uzinës.

Drejtori midis të tjerash shkruante: «Këtu nuk është akademi sportive, por uzinë. Plani, shokë, plani mbi të gjitha. Po si mund të realizohet plani po të merremi me sport? Jo, shokë! Plani pa depot nuk mund të realizohet. As garazh nuk mund ta bëjmë. Na duhen depo! Për rëndësinë e depove në socializëm flitet edhe në kapitullin e pestë të «Ekonomisë dhe të organizimit tregëtar»...

Kryeinxhinieri, «...Sporti është me të vërtetë argëtues, por në fund të fundit ai është dhe mbetet sport, vetëm sport. Atë nuk, e bën dot as de-

talje, as garazh dhe as realizim plani. Si i tillë sporti nuk mund të kontribuojë në mirëmbajtjen e automjeteve tona, të cilat i kemi blerë me valutë dhe jo me klering, siç pandehin disa»... .

Kur ne pamë se palestra sa vinte e largohej nga projektet tona, atëhere ju drejtuam organizatës së partisë dhe kolektivit.

Vijonte loja. Rezultati ishte 18 me 23, se ne setet e voleibollit i zhvillonim jo me nga 15 por me nga 30 pikë.

Ndërkohë në hyrje të palestrës filloi një zhurmë e madhe. Kërcisnin dërrasa, ndjeheshin zëra të fortë, urdhëra... «Thanas, më majtas! Ashtu Thanas! Mba-je aty... Prit... Ule, Thanas! Ule dhe ti, Vasil, ule, të shkretën, ule, se do ta thyesh... Më ngadalë, më ngadalë, ashtu del!..»

Pak më vonë dera e palestrës u hap dykanatësh dhe u duk aty një torno e mbajtur nga kryeinxhinieri me një grup punonjësish.

— Djema — na u drejtua kryeinxhinieri — lëreni lojën dhe ejani të na ndihmoni se mos na kapin me presh në dorë.

— Ne ju ndihim, po duam të dimë, përse? Dhe ç'është ai presh që do na e kapin në dorë? — e pyeta atë.

— Shoku Çeço, këtu nuk ka kohë për shakara. Ju lutem! Mos na vononi se çështja nuk pret! Ka karakter urgjent!

— Asgjë nuk kuptoj. Ku do të vejë kjo torno?

— Mos është gjë torno sportive? — shfaqti dyshimin e tij Nikua.

— Shokë, ju lutem, mos u tallni! Çështja paraqitet urgjente, vendimtare dhe sidomos konspirative! — tha kryeinxhinieri.

— Ne duam sqarime, shoku Mitro! Mos doni ta mbushni palestrën me maqineri? Sot një torno, nesër një skodë, pasnesër fuçitë me karburant.

— Jo, shokë, në palestër vetëm kjo torno do futet. Për të tjerat janë marrë masa.

— Mirë, xhanëm. Po sqaroni, si është puna! — i thashë.

— Po s'ka kohë, mor shoku Çeço. A e dini ju se koha është flori? Po nuk u nxituam, do të na mбетet në dorë si dopiogjashta. Dhe pastaj sos dëmi, apo sos turpi.

— Punët e mira bëhen dalëngadalë, shoku Mitro! Na thoni, ç'kërkon kjo torno në palestër?

— Jua them po të dalin jashtë të tjerët.

— Me sa di unë, shoku Mitro, midis ne të dyve për punë tornosh nuk ka ndonjë sekret.

— Po ashtu është puna, more shoku Çeço. Ah, i gjori unë, asnjë s'më kupton. Ju do t'ja vini zjarrin uzinës!

— Më ngadalë, shoku Mitro! Mos ju dhemb gjë koka? Përse mendoni se pikërisht ne do ja vëmë zjarrin kësaj uzine?

— Po ja, mor shoku Çeço, gjyko dhe vetë si ekonomist që je. Para tri ditësh ministria na ka dërguar një urdhër zyrtar. Duhet që uzinës së Fierit t'i kalojmë dy torno, një frezë dhe dy trapano, meqë demek, te ne nuk paska punë për ngarkesë të plotë.

— Po, mrekulli. Ku ka më mirë! Kështu edhe koeficienti i shfrytëzimit të maqinerisë na del më i lartë.

— Bah, je në vete, shoku Çeço? E ç'na duhet neve koeficienti i shfrytëzimit përpara rezervës? Apo mos të thotë koka se do të na bien prapë në dorë këto maqineri si petullat nga qielli? Jo, vëllaçko!

Kjo është maqineri importi. Po e nxore nga dora të puthi halla në të dyja faqet. Ehu, i di vetë këto punë! Mezi i kam shtënë në dorë.

Unë e di ç'kam hequr. Na duhen, a më kupton? Na duhen! Në mos sot, nesër... Do u gjendet vendi. Me ngarkesë të plotë, bile!

— Dhe tani duhet t'i fshehim vrimave si mall të vjedhur.

— Bah, fjalë për të thënë. Pse vrimave? Kjo torno këtu. Dy freza i strehova në këndin e kuq. Kuptohet, përkohësisht. Një trapano e futa në dhomën e dezurnit, kurse trapanon tjetër do ta strehoj në kuzhinë ose në mensë. Kështu për Fierin do teprojë njëra torno. Kur të vijë komisioni nga ministria nuk do të gjëjë asgjë tepër, dhe u lamë! Kështu piqet mishi pa u djegur helli. Se këto do na duhen. A më kupton? Do na duhen. Ndërmarrja jonë do rritet, do zgjerohet. Bile veç këtyre ne do kërkojmë edhe maqineri të tjera.

Na habiti mjeshtëria gjeniale e kryeinxhinierit për ta fshehur minaren në thes. Pelivan qerratai!

— Shoku Mitro, ju që mbani referate mbi revolucionarizimin e ndërgjegjes dhe të kuadrove, ju që diskutoni me aq sinqeritet për disiplinën e punës dhe të prodhimit, a jini parë në pasqyrë ndonjëherë? — e pyeti me seriozitet Nikua.

— Si? Po bëni demonstratë dhe po shpërtheni në tallje personale?

— Mjaft më, shoku Mitro! Si nuk e kuptoni që u iku radha fetarëve që thoshnin: «Bëni si them unë, po mos bëni si bëj unë». Me sa dimë ne, shoku Mitro, ju nuk keni studjuar në medrese, apo jo?

— Si, po më fyeni sërish?

— Bah, ne duam që të zbatohen vendimet!

— Këtë do ta shohim kur të vijë drejtori.

— Pse, ju mendoni që drejtori do t'ju duartrokasë për këto marifete?

— Nuk janë marifete, shoku Niko, po janë përpjekje të singerta për të ruajtur bazën mekanike të ndërmarrjes.

— Po mirë, pse ta zgjatim? Nesër mbledhim kolektivin dhe i sqarojmë këto punë.

— A jeni në vete, shoku Çeço? Po a e dini ju se këto torno... ato freza... juve... mua më...

Por ne pa e dëgjuar vijuan lojën. Lamë aty vetëm tornon. Ajo dëgjonte kryeinxhinierin si fliste me vete për tornot, frezat, trapanot, me atë, me këtë, me ata, me ato...

RËNJA NË PESHË

Unë përherë kam dashur të shkruaj diçka mbi artin e rënjes në peshë. Jo pse jam specializuar apo diplomuar në këtë fushë, porse rastësisht në jetë më është dashur dëndur të bie dhe të ngrihem në peshë. Dhe munda ta bëja me aq lehtësi këtë gjë të vështirë, sa që për një orë arrija të ulesha dy kile nga pesha.

Shpesh më shkruhej që këtë eksperiencë të pasur ta hidhja në letër ashtu, si të mund e sa të mund, si autodidakt, duke qenë i bindur qysh më parë se do të plotësoj një farë kërkese nga të interesuar të ndryshëm.

Po ja që nuk më jepej për t'ju futur një shkrimi të tillë me përgjegjësi. Po rasti e pruri që unë, dashur pa dashur të mbaja disa shënime, të cilat po i shfaq ashtu, bruto, pa patur ndonjë pretendim shkencor, material, apo letrar.

Treni dhe njohja në tren

Udhëtoja me tren për në Fier. Në fakt, më duhej të arrija në Vlorë, po treni më linte deri në Fier.

Unë vetë nuk mund t'i caktoja atij kondita të tilla saqë të më çonte deri në Vlorë.

Jam rritur në fshat. Ndoshta për këtë pëlqej më shumë udhëtimin me tren. Në avion dhe në det më merren mendtë. Kurse treni është si puna e qerreve tona me dy rrota. Ecën i sigurtë në punën tënde. Është fakt, që deri më sot në fshatin tim nuk ka ndodhur asnjë aksident, apo katastrofë rrugore me qerret tona. Kemi qenë një fshat me katër shtëpi dhe me dy qerre. Mbanim krahun dhe askush nuk na e kërkonte patentën. Rrallëherë të dyja qerreve u takonte të gjendeshin ballë për ballë në rrugët e fshatit tim.

Ndërsa transporti automobilistik të mërzit. Kontroll rrugor, patenta që fluturojnë me 70 në orë, kthesa, shpejtësi të rrezikshme, karambole, e të tjera ngatërresa me pasoja e pa pasoja.

Kurse unë, fshatari i dikurshëm, dua të udhëtoj pa telashe. Për këtë mjet më të mirë nga treni nuk ka. Shpejtësi e kufizuar pa kontroll rrugor, pa karambole. Edhe po të vonohet treni përballë, të rrij gjer dy orë në pritje në stacionin përkatës, derisa të këmbehen trenat. Pse të mos rrish? Brenda je. I sigurt je!

Po unë edhe në tren e shfrytëzoj kohën sado i ngadaltë që të jetë ai. Se marr me vete dy libra. Të parin e lexoj në vajtje, të dytin gjatë kthimit. Kështu, edhe këtë radhë kisha marrë «Aventurat e Çipolinos» dhe «Teknika e kinoprojeksionit.»

Por, sa fillova nga aventurat e çuditshme të Çipolinos, përballë meje u dëgjua një zë i gjinisë femërore:

— Të lira i keni vendet?

— Mund të uleni!

Ajo u ul dhe unë për respekt e mbylla librin, pa mundur ta hapja gojën. Mendoj se më takonte mua t'i bëja shoqëri.

— Ju, a e pini duhanin?

— Jo, falemi nderit. Por e pi ime shoqe!

— Uuu! Unë nuk i duroj dot njerëzit që pinë duhan.

— Unë mund të mos i simpatizoj, po për të duruar, nuk kam ç'të bëj. U mësova tashmë. Pastaj ime shoqe i pi me filtër.

Mora guximin dhe ngrita kokën të shikoja bashkëbiseduesen. Qe një femër që nuk e kisha parë kurrë. E bëshme dhe e fryrë sa nuk kishte ku të vinte më. Peshë, po peshë kishte! Ku ta dija se sa do të qenë rrafshuar balestrat e vagonit tonë.

Në shumë raste mua volumi dhe përmasat e mëdha më imponojnë respekt.

Interesimi për aneminë time

— E mrekullueshme!

— Kush kështu? — pyeta pothuaj pa dashur. E kush nuk do të dijë diçka për një mrekulli. Kështu që pyetja ime nga kjo anë përligjej.

— Pamja juaj! Sa i dobët që jeni! Mos keni dalur gjë nga spitali? Apo, ju lutem mos ma merrni gjë për të keq, se unë jam e sinqerë, mos vallë ktheheni nga senatoriumi?

Këto pyetje të bëra me sinqeritet më habitën dhe më çorientuan. Në spital s'kam shkelur kurrë, senatoriumin, siç tha ajo në mos gaboj, nuk e di nga bie. Megjithatë, për takt, e pyeta:

— Pse, çfarë ka të mrekullueshme në aneminë time?

— Ka atë që unë ju kam zili. Mos ma merrni për të keq, se unë jam e singertë, por ja që jua kam zilinë! Si keni mundur të dobësoheni kaq shumë? Cila qenka ajo sëmundje që mund të bëjë mrekulli si kjo?

— Shëndeti — ja ktheva me të vërtetë pa dashur.

— Shëndeti? Mos më bënë veshët? Po a hani gjësendi ju, a pini ujë? Po birrën e keni vënë ndonjëherë në gojë? Keni dëgjuar gjë për shijen e veçantë të verës dhe për aftësitë e saj dhjamore?

— Nga këto unë ha pjesën time, si çdo njeri i ndershëm!

— Po të qe kështu, atëherë si qenki katandisur kështu kockë e lëkurë? Se dhe unë dua t'ja arrij kësaj dite!

— Me sa di nga anatomia dhe fiziologjia, trupi i njeriut nga brenda ka kockë dhe nga jashtë mbulohet me lëkurë. Mund të ndryshojë disi trashësia e lëkurës, por kjo është punë tjetër.

— Po asnjëherë nuk keni qenë i sëmurë? Dhe jeni në gjendje të punoni ju? Me se merreni?

— Me ngarkim-shkarkim! Merrem edhe me sport!

— Ju me sport!? Mos ma merrni për të keq, ju lutem, se unë jam e singertë, po me çfarë sporti mund të merreni ju?

— Unë jam kampion në ngritje peshash!

— Si? Po sa kilogram mund të ngrini?

— Varet nga forma sportive. Arrij të të 100 kilogramët. Herë më lart e herë më poshtë, sipas urdhërit të trainerit.

— Po vetë sa peshoni?

— 52 kilogram pa bizhamat! Por, po të dojë treneri, unë mund të bëhem edhe 56 kilogram! Ama, më tepër nuk mundem.

— Pra, mua, që peshoj 101 kile, ju mund të më ngrini?

— Edhe kjo varet nga rrethanat. Po të ma lejojë treneri.

Qëllimi i udhëtimit me tren

— Deri ku do të vini? — e pyeta unë.

— Deri në Durrës.

— Po pastaj?

— Do të kthehem prapë për në Tiranë.

— Çudi! Po derisa ju do të ktheheni prapë për në Tiranë, pse shkoni kot në Durrës?

— Eh, udhëtimet e gjata mua m'i ka këshilluar mjeku!

— Si kështu?

— Po ja! Siç e shikoni dhe vetë, vuaj nga pesha e tepërt! Në fillim mjeku më këshilloi të mos haja shumë. Dhe unë që ditën e parë pas vizitës nuk vura gjë në gojë, Isha gati për çdo sakrificë, mjaft që të bija nga gjithë kjo peshë e mërzitshme. Por, ama, natën më griu barku nga uria. Nuk e kisha provuar të flija pa darkë dhe nuk arrita ta provoja! Aty nga ora 12 u ngrita dhe fillova të përvoja ç'gjeta në bufe. Im shoq u rrotullua njëherë në shtrat dhe mëmëriti nëpër gjumë: «Çfarë drejç maçoku kobash që kemi dhe ne»!

U struka se më vinte turp të më shikonte duke ngrënë natën dhe nisa të përtypesha më me edukatë. Pas pak im shoq u rrotullua prapë në shtrat dhe

mbi kokën time fluturoi llulla e tij. Ai deshi të qëllonte kështu mbi maçokun kobash.

E pashë se kështu nuk ja dilja dot. Nuk mund të rrija pa ngrënë. Ditën po, bëja si bëja dhe nuk vija gjë në gojë, përveç nja 7-8 pjata, po ama natën bëja kërدينë në bufe dhe në kuzhinë.

Ja qava hallin tim mjekut me singeritetin më të madh! Më këshilloi të udhëtoja sa më shumë më këmbë. Të udhëtoja sa të dërmohesha.

Por mjekët nuk e kanë për detyrë t'i dërmojnë pacientët e tyre. Unë këtë kurë e nisa me optimizëm. I rashë një xhiro lulishtës së çerdhes, po ama në darkë e ndjeja veten të këputur fare. Kjo më bëri të haja dyfishin e racionit të zakonshëm.

Si e pashë që udhëtimet më këmbë nuk dhanë ndonjë rezultat për të qenë, vendosa të udhëtoja me autobusin urban. Kështu nisa xhirot me autobusin e unazës. Pas dy tri xhirosh rreth Tiranës, unë zbrisja nga autobusi e përcjellur nga shikimet plot habi të faturinos.

Por me kalimin e kohës, e kuptova se edhe udhëtimet me autobus urban nuk do të më ndihmonin fare për të rënë në peshë. Përkundrazi, sa vinte e shtoja në peshë! Sikur ma bënte për inat vetë trupi im.

Atëherë më lindi ideja të udhëtoja me tren. Po nuk më dha as kjo kurë ndonjë rezultat; do të konsultohem prapë më mjekun, se çfarë mund të përdoret përveç udhëtimeve për të rënë në peshë.

— Pisk e paskeni punën!

— Mos dini ju ndonjë mjet?

— Si të them... sikur të merreshit me sport...

— Uuu, me sport! E me çfarë sporti mund të

merrem unë? Apo, ju sigurisht që mendoni për ngritjen e peshave!

— Jo, jo, në asnjë mënyrë. Sipas meje, basketbolli mund t'ju përshtatej më tepër. Po edhe me ski mund t'ja dilni në anë!

— Këto nuk më pëlqejnë. Tjetër, tjetër...

— 100 metërsh stil i lirë, ose 80 metra me pengesa...

— Tjetër... tjetër... unë jam këmbëngulëse!

— Hedhje me parashutë, hipizëm, kërcim së larti... trehapësh...

— Tjetër...

— Mund të shitni biletat në stadium, duke përjashtuar vetëm rastet e ndeshjeve ndërkombëtare të futbollit!

Problemi im dhe zgjidhja e saj

— Megjithatë, të ngrënit e kam kufizuar shumë, sidomos ditën. Bëj si bëj dhe e mbaj veten. Ama natën, kusur nuk lë.

Unë e kam për parim që udhës duhet ngrënë mirë. Dhe përherë marr diçka me vete për ta zbatuar këtë parim. Po tani, në sytë e kësaj hallexheshe, që i duhej të agjëronte, ditën, unë nuk mund të haja. Se, përndryshe, mund të merrej si mungesë edukate, apo respekti.

E megjithatë, më hahej, se nuk kisha vënë gjë në gojë përveç erës së byreçkave që më kishte mbështjellur ime shoqe.

— Në udhëtim njeriu kurrë nuk duhet të rrijë pa ngrënë, sidomos në moshën tuaj — ja nisi bashku-udhëtarja ime. — Duhet ta dini mirë këtë. Ja, këtë

radhë, po ju jap unë diçka, herë tjetër kijeni vetë parasysh!

Me të thënë e me të bërë. Ajo hapi një çantë tri herë më të madhe se sa çanta ime e sportit. Aty brenda qe strehuar një magazinë e vërtetë ambulante ushqimesh.

Konsërva, sallam, kavanoza, bukë të pathyera ende, termos, putarka, cironka të tymosura dhe cironka në vaj, arra, mollë e turli. Sikur do të bënte një udhëtim rreth Tokës, e jo sikur nisej nga Tirana në Durrës.

— Është rrugë, a më kuptoni? Diçka duhet futur në gojë. Përndryshe mundet të të bjerë damllaja.

Ndërkohë ajo i shtroi të gjitha. U bë një gosti e vërtetë. Aq, saqë jam më se i sigurtë se ajo as në dasmën e saj nuk ka ngrënë aq shumë. Me atë rast, edhe unë futa diçka në gojë, i bindur tashmë se kjo nuk do të përbënte ndonjë shkelje të rëndë të edukatës sime fshatare, meqë agjërimi i saj qe i çuditshëm.

ÇARMATIMI I ARMATOSUR

Ndoshta partizanët e paqës, ku janë e ku s'janë, nuk e dinë të gjithë se në Gjenevë u përpilua më në fund projekttraktati mbi çarmatimin e plotë dhe të përgjithshëm!

Kjo është një tjetër fitore e partizanëve të luftës! Sado me shaka që mund ta marrin disa skeptikë këtë fakt, prapëseprapë fitorja është e madhe. Është e madhe dhe jo e vogël kjo fitore, sidomos po të kemi parasysh ato mijëra orë e seanca si dhe miliona faqe me procesverbale që harxhoi Gjeneva për çarmatimin.

Këto sakrifica, s'kemi si t'ua harrojmë, autorëve!

Pra, projekttraktati mbi çarmatimin e plotë dhe të përgjithshëm u përfundua! Kjo fitore është e dyfishtë, pasi kësaj radhe çarmatimi do të jetë si kurrë ndonjëherë tjetër: edhe i plotë, edhe i përgjithshëm! Do të ketë për të gjithë!

A nuk e mbyll një çarmatim i tillë shtegun e luftërave? Bile, edhe sikur t'u tekët disa të krisurave për një takim të tretë botëror, lufta do të zhvillohet me mundje klasike ose me mundje të lirë!

Ka mundësi të shfrytëzohen edhe shkopinjtë e

golfit apo ata të dirigjentit... Kështu, pas kaq mijëra e mijëra vitesh, Botës ju dhurua më në fund bakshishi i shumëpritur: çarmatimi i armatosur, sipas një projekttraktati tepër zyrtar!

Dhe për çudi, në vend që bota të çmendej nga gëzimi dhe festa me këtë rast, ajo me mosmirënjohje po vijon projektet dhe prodhimet e një armatimi super të plotë. Por kjo mbase ka të bëjë me atë teorinë e të kundërtave, teori të cilën revizionistët e kanë aq shumë për zemër, saqë ndonjë ditë do të zëvendësojnë me të edhe gulashin!

Ftohtësia e popujve ndaj këtij evenimenti ka arësytet e veta.

Historia na mëson se përherë sipërmarrjet e mëdha në fillim janë pritur me ftohtësi dhe skepticizëm! Por enciklopedia e çarmatimit, që do të kapë mijëra vëllime, do ta bëjë të sajën. Ajo do t'i shpjegojë të gjitha. Si lindën dhe u zhvilluan pasionet e armatimit, të luftërave grabitqare dhe të shfarosjes humanitare! Pastaj, do të fillojë me ëndrrën e bukur të çarmatimit...

Sipas kësaj enciklopedie madhështore, ëndrra e çarmatimit është po aq e lashtë sa dhe armatimi! Disa gjithnjë kanë dashur të çarmatosen dhe si pasojë janë armatosur përditë e më tepër!

Po tani, ama, që u përfundua ky projekttraktat, tani s'ka më nevojë për agjitacion! Armatimi dhe armatimet kaq e patën!

Do të vijë ajo orë e bardhë, kur Bota do të bjerë për të fjetur si zakonisht, e armatosur deri në dhëmbë, dhe do të ngrihet nga gjumi e çarmatosur si për çudi, e çarmatosur plotësisht dhe përfundimisht.

Rrezik se disa nuk do të gjejnë në bufe as thi-

kat e bukës apo të ëmbëlsirave! Dhe pas kësaj kurrë nuk do armatosen. Kurrë më!

E, megjithëse deri atëherë do të rrjedhë shumë vodka dhe uisku, projekttraktati u përfundua!

Çarmatimi do të jetë i plotë dhe i përgjithshëm. Ndërsa dora dorës projekttraktati nuk është ende i plotë. Atij i mungon vetëm parathënja si dhe neni tre! Ky nen është ai që do të sqarojë metodat e kontrollit. Por kontrolli pak rëndësi ka, ndaj dhe neni tre nuk i kanë kushtuar aq kujdes sa dhe neneve të tjera. Të bëhet çarmatimi njëherë, pa për kontrollin shohim e bëjmë! Është punë që pret!

Kontrolli do të bëhet me shije, si veprat e artit, kështu që nuk duhet nxituar. Bazat teorike të kontrollit do të perfeksionohen në shekuj. Në këtë mënyrë një ditë do të përfundojë dhe neni tre!

Disa duan të thonë se ky projekttraktat, pa neni tre, është si ajo karabinaja pa çati. Por gjuhët e këqia s'kanë tjetër punë!

Kontroll do të ketë. Bile ai ka filluar që në kohën e krizës së Karaibeve! Fotografimi ajror është një nga format e para dhe interesante. Se kështu mund të merret edhe në televizion për të argëtuar popujt! Pra, popujt do ta ndjekin nga afër këtë çarmatim, siç ndjekin një ndeshje futbollit.

Kur Bota të ndahet në dy pjesë të barabarta midis dy luftëtarëve të çarmatimit, (gjë që do të ngjassë, sapo bualli të hipë në fik) çarmatimi do të jetë më i lehtë.

Në bazë të parimeve të bashkekzistencës revisioniste, puna do të vejë kështu:

Ndërsa njëra nga gjysmat e Botës do të çarmatoset plotësisht, gjysma tjetër do të armatoset në mënyrë suplementare, për të mbrojtur gjysmën e

çarmatosur. Ky do të jetë një racionalizim i madh; pasi do ta lehtësojë kontrollin.

Kështu nën hijen e avionëve të bashkekzistencës, gjysma e Botës do të ndërtojë socializmin paqësor, kurse gjysma tjetër do ta brohorasë dhe do ta marrë në televizion këtë parodi!

Nga kjo do të përfitojë edhe opera komike, meqë ajo pas kësaj do t'i kërkojë talentet nga radhët e diplomatëve.

Kështu, rolet u ndanë, regjitë janë gati, vetëm se publiku nuk po i mbush shkallët e teatrit komik.

Revizionistët dhe miqtë e tyre e dinë mirë se me ç'breshëri duartrokitjesh do ta presë ky publik rënjen e perdes dhe të skenës njëkohësisht.

KARAMBOLI

Po të pyesësh Vejko Bajgallovin, ai thotë se e kanë gabim ata njerëz të cilët mendojnë se tregëtia është vetëm tregëti!

Këta, sipas Bajgallovit, janë dritëshkurtër dhe hyjnë në punë për të furnizuar rregullisht ankan-din. Këta, po sipas Bajgallovit, të nxjerrin me kë-pucë të kuqe, me të cilat mund të biesh kur të duash në humnerën e falimentit.

Bajgallovi shpjegon me durim se, tregëtia së pari është shkencë, po është edhe art, një art mjaft i ndërlikuar dhe i gjerë, ku midis të tjerash hyn edhe psikologjia, logjika, matematika, morali, poezia, e të tjera marifete kësodore.

Bile për të trullësuar tjetrin, Bajgallovi mendon se, në vend që të bisedosh mbi pazarin, fare mirë mund të fillosh të flasësh për filozofinë, për historinë e vjetër, për të lashtat, për reumatizmin, veshkat e sidomos për kancerin.

Vejko Bajgallovi ka dy mjeshtëri. Të parën shtetërore, të dytën private. Kështu që ai i jep shoqërisë në dy frontë, pa zënë me gojë të ardhurat kombëtare apo personale.

Edhe këtë radhë Vejko e përgjoi me mjeshtëri

momentin, duke siguruar një variant tepër të leverdisshëm. Boksierin Milan Krajcev ai e bleu me gjysmë çmimi nga një farë Dushan Skipçeviç që ishte në faliment e sipër.

Por një javë më vonë ndodhi diçka tronditëse dhe mjaft e papëlqyer.

Boksieri Krajcev u grabit ndërsa po kthehej nga trainingu. Gjurmët e grabitjes së pacipë nuk po dukeshin gjëkund. Policia me gjithë vullnetin e saj të mirë si dhe me shpërblimet që mori për këtë lloj vullneti, nuk bëri dot gjë më tepër se një vrimë në ujë.

Dukej se grabitësi që firaun i madh. Megjithëse ai ndoshta nuk merrte vesh nga psikologjia, fiziologjia apo historia, prapëseprapë e la tjetrin me gisht në gojë. Në këto rrethana me një postë enigmatike arriti një letër anonime.

Megjithëse Vejko Bajgallovi nuk që marrë ndonjëherë me zberthimin e minave ai, duke mbajtur në dorë atë letër anonime, provoi të njëjtat emocione siç i ngjet edhe minazberthyesit fillestar.

«I nderuari Vejko Bajgallov!

Me indinjatë të papërmbajtur mësuam gjestin tuaj antisportiv dhe antijugosllav, një gjest ky tepër i ulët prej matrapazi të zi!

Çuditëmi se si toka jugosllave mban akoma njerëz si ju, njerëz pa pikën e nderit dhe të moralit. Për një çmim fare qesharak, keni marrë nëpër këmbë personalitetin e një sportisti të talentuar. Si nuk skuqeni për këtë, zoti Vejko? Si nuk ju vret aspak ndër-gjegja? Keni apo nuk keni zemër ju? Apo në vend të zemrës keni një portofol?

Por ne, që na dhimset nderi dhe dinjiteti i një sportisti jugosllav nuk do ta lejojmë këtë krim të paparë në historinë e sportit tonë kombëtar!

Kjo ngjet se për ne, njerëzit e ndërgjegjshëm, është i shtrenjtë nderi dhe dinjiteti i një sportisti të tillë si Milan Krajcev.

Nuk do të lejojmë kurrën e kurrës, që as ti dhe as ndonjë tjetër nga marka jote e zhvlerësuar të marrë nëpër këmbë emrin e një sportisti. Prandaj, për të vënë çdo gjë në vend, me të marrë këtë letër, duhet të nisësh me urgjencë 5.000 dollarë në adresën e mëposhtme. Dhe mos pandeh, o njeri i poshtër, e i ndyrë, se këto të 5.000 dollarë janë shumë! Nuk është as gjysma e shumës të cilën ti e grabite poshtërsisht nga shitësi fatkeq i Krajcevit. Si ta keshë kryer këtë, sportisti do të të kthehet brenda ditës.

Vonesa ka pasoja serioze!»

«SHOQËRIA PËR MBROJTJEN E NDERIT DHE TË DINJITETIT TË SPORTISTËVE JUGOSLLAVË».

P.S. Çdo tentativë për dekonspirim, mos harroni se ka pasoja dhe kushton shumë më tepër nga ç'pandehni ju! «SHMNDSJ».

Sa mbaroi këtë lexim letrar, Vejko u shemb në karrige. Ju deshën disa minuta për ta marrë veten.

«Kjo është një paturpësi e paparë në mbarë Jugosllavinë. Është një tallje kriminale nga më të egrat. Ç'maskarenj! Dhe thonë se mbrojtkan nderin dhe dinjitetin e sportistëve jugosllavë. S'ke ç'u thua, horra të mëdhenj paskan qëlluar këtë herë.»

Vejko Bajgallovi bëri edhe shumë pyetje e filozofime të tjera po të kësaj natyre mbi moralin dhe

nderin në Jugosllavi, por pa rezultat. Deshi s'deshi, mbylli të 5.000 dollarët, ja dorëzoi bashkëpunëtorit të tij, Černovit dhe i nisi tutje sipas adresës.

Por pasdite në vend të Černovit ju kthye një tjetër zarf i mbyllur. Megjithëse kjo nuk ndillte asgjë të hajrit, Bajgallovi e hapi zarfin me aq rrëmbim, sikur aty brenda të qe mbyllur vetë Černovi i zhdukur.

«I nderuar zoti Vejko Bajgallov!

Morëm zarfin tuaj të paturpshëm dhe skandaloz. Keni fyer pa të drejtë ndjenjat tona morale dhe nacionale, duke futur në zarf jo 5.000 por 2.500 dollarë. Për të marrë Černovin tuaj si dhe Milan Krajcevin na ktheni kusurin si dhe 1000 dollarë gjobë nderi për gjestin tuaj të ulët dhe të pabesë!»

«SHMND SJ»

Kjo, sipas Bajgallovit, ishte një paturpësi historike që vështirë të përsëritej as në 1.000 vjetët e ardhshëm.

...«Po prit, do më shohin. Ata harruan funksionin tim shtetëror! Dale se edhe lepuri më mirë se me çdo gjë zihet me qerre. E mbushët kupën, o farë e ndyrë maskarenjsh! Unë nuk u kam asnjë faj!...

Në këto e sipër Bajgallovi brofi më këmbë. U armatos me dy pistoleta amerikane dhe për çdo rast mori me vete edhe 4.000 dollarë. Praktika e kishte mësuar atë që në ndërmarrjet e vështira, përveç trimërisë duhej të kishte edhe diçka tjetër këmbësuese.

Adresa e «SHMND SJ»-së nuk qe dhe aq e vështirë për t'u gjetur.

Bajgallovi në kërkim të maskarenjve u takua me një burrë thatim pak të gjatë e tepër fjalëpakë.

— Ku është Černovi dhe Krajcevi? — pyeti pothuaj me ulërimë.

— Në training! — ja ktheu qetë-qetë tjetri.

— Si? Ju merreni edhe me trainingin e sportistëve të grabitur? Ç'paturpësi! Po më thoni me ç'të drejtë vini dorë ju mbi një sportist jugosllav i cili më përket mua? I njihni mirë ligjet apo jo?

— Pikërisht prandaj vepruam kështu!

Bajgallovin e tërbonte ftohtësia dhe indiferenca e këtij njeriu të çuditshëm. Ç'dreq njeriu ishte ky xhanëm? Dhe a nuk e kishte hak plumbin ballit ky lloj horri?

— Dëgjoni, ju, maskarenj të paskrupull, — shpërtheu Bajgallovi duke nxjerrë njerën pistoletë — me mua nuk bëhen shaka të tilla!

Unë jua krip trutë me plumba! Pastaj ta mësoni mirë se si mbrohet nderi dhe dinjiteti i sportistëve jugosllavë! Ose do të vini në djallë me gjithë atë SHMNDSJ-në tuaj të shthurur! A e dini se në pak minuta mund të zini të sigurtë fundin e birucave? — pyeti më në fund Bajgallovi i stuhishëm.

— Furtunë pa dobi — ja ktheu tjetri, duke e parë me ftohtësi tytën e zezë të pistoletës. — Marrëzitë asnjëherë nuk të nderojnë. Uleni armën, i dashur. Këtu nuk jeni në poligonin e qitjes! Sapo që guxuat të fyesi autoritetin e shoqërisë sonë, dijeni se do të ndëshkoheni rëndë! Këtu e kemi të ndaluar përdorimin e armëve, qoftë edhe për shaka!

— Ashtu ë? pyeti me ironi Bajgallovi. Pastaj me një gjest teatral, vijoi. — Ta tregoj unë shakanë ty! Në emër të ligjit ju arrestoj!

— Pa dobi, pa dobi — ja ktheu tjetri krejt indiferent.

Atë çast pistoleta e Bajgallovit fluturoi krejt papritur dhe pa lejen e tij.

— Ou, ç'vizitë interesante! Një mysafir me pistoletë në dorë! — dëgjoji një zë të njohur tregëtari i sportistëve. — Major Maskariç — i shpëtoi goja nga habia Bajgallovit.

— Dora vetë, kapiten Vejko! Ashtu siç nuk ju mjafton juve grada e kapitenit, ashtu edhe mua nuk më mjafton grada e majorit. Vetëm nuk e kuptoj se si drejtin u pleksëm bashkë!

— Karambol! Po mbase më për hajër kjo, zoti major.

Kështu shokët e shkollës, kolegët e dy profesioneve paralele, u bënë ortakë për të përgjysmuar karambolet në dobi të nderit dhe të dinjitetit të sportistëve jugosllavë.

REVIZIONIZMI DHE REVIZIONISTËT

Dihet se me kalimin e kohës çdo gjë ka nevojë për revizionim, duke filluar nga mekanizmat më të thjeshta deri te kombinatet vigane. Bile, edhe njeriu ka nevojë për riparim. Po, ndërsa çështja e riparimeve teknike të mekanizmave tashmë është zgjidhur deri dikë, me riparimin e njeriut puna qëndron ndryshe.

Suksese ka edhe këtu. Bile mjekët me optimizëm premtojnë edhe për pjesë këmbimi me lëndë sintetike.

Duket sikur me kaq puna merr fund plot sukses. Por jo! Është harruar kryesorja, truri! Sado suksese fantastike të ketë arritur neurokirurgjia, çështja e transplantimit të trurit do të mbetet e pazgjidhur. Truri nuk mund të riparohet plotësisht si motorët «Dizel».

Për trurin nuk mund të prodhohen pjesë këmbimi. Ndryshe do të ndodhte që një mjek, pasi t'i bëhej diçka e tillë, të thoshte se ai ka qenë bandit, apo kozmograf. Po ashtu një jurist me tru artificial mund të merrej me matematikë apo me fiskulturë. Pra, një gjë e tillë do ta rriste shumë listën e mrekullive.

Nga kjo del se trutë që katandisen për revizionim kapital nuk kanë shërim. Mbase këtu e ka burimin edhe shprehja popullore që thotë: «Trutë e prishura nuk i hanë as qentë!»

Edhe trutë e revizionistëve këtu kanë arritur, megjithëse ata janë revizionistë modernë! Ata kanë nevojë të ngutshme për një revizionim kapital në tru. Ndryshe nuk ka se si të shpjegohen pelivanllëqet e tyre!

T'i thuash këmbës dorë, kjo ka ndodhur edhe përpara se revizionistët të mbanin konferenca shtypi. Por, ama, t'i thuash Perëndimit Lindje dhe anasjelltas, këto marrëzira vetëm ky brez ka fatin e madh t'i dëgjojë.

Kodrën pas bregu dhe malin pas kodrës na e kishin treguar edhe të tjerë të krisur nga kondaku. Por, ama, t'i thuash mikut armik dhe armikut mik, kjo do të thotë se tru të tilla vështirë t'i shpëtonë edhe revizionimi kapital me anën e lazerkirurgjisë.

Të mohosh në drekë atë që ke thënë në mëngjes dhe këto t'i kthesh së prapthi në darkë, kjo nuk është aq e lehtë, si të folurit me vetëveten.

Revizionistët e kanë shumë qejf revizionimin kapital. Se ka dhe emër të bukur: revizionim kapital! Jo pse fjala, «Kapital» u kujton revizionistëve kryeveprën e Marksit por, se padashur u bie në mendje kapitalin e florinj të atij Perëndimi nga i cili shikojnë dritaret e tyre!

Në fillim revizionistët e nisën revizionimin me trupin kolos të Revolucionit të Tetorit.

Së pari zbrëthyen kultin e heronjve, sepse ky kult kishte bllokuar ingranazhin e ritornos. Pastaj, vijuan më «kuadrot e vjetër», me reformat e reja

ekonomike, e kush mund t'i numrojë të gjitha pseudoneologjizmat e tyre!

Por, ashtu siç ngjet me axhamitë që zërthejnë një radio, edhe revizionistëve nga këto marifete u dolën shumë gjëra të tepërta, të cilat u mbetën në dorë.

Dhe, ashtu siç bëjnë në këto raste axhamitë, të cilët shajnë mjeshtërit, ashtu edhe revizionistët filluan të lehin kundër paraardhësve, që e paskëshin ngarkuar aq rëndë mekanizmin e shtetit dhe të partisë.

Filloi shkarkimi. Shkarkim dhe ndërrim i ngarkesës! Po prapë, tepronin shumë detale. Ç'të bënin me këto? Se kishte dhe rrezik komprometimi. Atëherë, ato që dolën tepër revizionistë, filluan t'ua shpërdanin popullit. Pikërisht këtu, filologët dhe linguistët e ardhshëm duhet të kërkojnë etimologjinë e shprehjeve «parti e të gjithë popullit» dhe «pushtet i të gjithë popullit»! Çdo gjë e tepërt i duhej dhënë popullit (mbase kështu ai e mbyllte gojën). Se edhe atij diçka i takonte. Për këtë revizionistëve u qante zemra prej kohësh!

Kështu populli filloi të ngopej me parti dhe me pushtet, duke shtrënguar rripin për bukë dhe për mish. Jo më kot thonë se njeriun e ngop më tepër një fjalë e mirë se një gosti e madhe. Prandaj revizionistët filluan të specializoheshin për fjalë të mira!

Përse të mërзитеj populli? Përse të protestonte? Partinë e kishte të tijën, pushtetin po ashtu! Dhe filluan të ndërroheshin me radhë si ministrat, gjeneralët, ashtu dhe funksionarët e partisë. Se të gjithë duhej të merrnin pjesën që u takonte!

Kur filloi të mbarohej gruri kanadez, revizionis-

tët u pakësuan derrave racionin e misrit. Bënë disa prova për t'u ndërprerë minjve firot e përvitshme, por pa sukses! Minjtë janë më të shkathët nga derrat dhe atyre pak vonë u bëhej pse revizionistët nuk kishin gulash për drekë! Fundi i fundit gulashi mund të gatuhej edhe me misër derrash!

Vazhdonte revizionimi kapital! Telash i madh! Filluan të ndjeheshin nevoja të tmerrshme për pjesë këmbimi në aparatet!

Librat e Trockit, Buharinit, Kautskit, Bernshtajnit e kompani ishin vjetëruar aq shumë, sa që nuk bënin as për guarnicion testatoje! Atëherë, me një akrobaci të rrufeshme u shkarkua përgjegjësi i oficinës revizioniste me një motivacion të artë e të shkëlqyer. Ishte i pari burrë shteti që shkarkohej për merita të jashtëzakonshme. E ç'nuk ngjet në panairret!

Dhe kështu oficina revizioniste filloi të punonte me ngarkesë të plotë me tri turne! Natën kurdiste dhe ekzekutonte, ditën vajtonte dhe përcillte telegrame ngushëllimi! Kështu hyri në punë në rang nacional e botëror edhe eksperiencia e krokodilit!

Por s'kaluan shumë dhe nevojat për pjesë këmbimi u rritën. Dhe, meqë «pushteti i të gjithë popullit» u forcua aq, sa s'qe parë as në kohën e Hitlerit, revizionistët filluan të porositnin pjesë këmbimi në Amerikë dhe në mbarë Perëndimin, të cilin ata e marrin për Lindje.

U ndërruan me radhë, Novotni, Dubçeku, ujku Gomulka! Këta jo pse qenë kundra, porse u kishte dalë boja dhe nuk e mbanin dot ritmin sipas shkopit të dirigjentit.

Dhe prapë qerrja nuk del nga balta. Dhe, as që ka për të dalë ndonjëherë!

Prapë populli nuk bindet se partia dhe pushteti i takojnë atij plotësisht dhe tërësisht. Për këtë dëshmojnë, midis të tjerash, edhe të shtënat mbi punëtorët heroikë të Polonisë!

Historia ka vërtetuar se në përgjithësi popujt janë kokëfortë.

Prandaj, revizionistët kanë marrë përsipër t'i zbutin turmat e popujve. Kështu, për të bërë një eksperiment të tillë, lëshuan tanket edhe avionët mbi Çekosllovakia!

Kjo që një fitore e shkëlqyer e armëve lavdimëdha të Traktatit të Varshavës! Bile, në kronikat, në histori dhe në enciklopedi, dashur padashur, kjo ngjarje hyri si fitorja e parë e madhe e këtij traktati.

Ka mjaft të dhëna dhe mundësi që të jetë njëkohësisht edhe fitorja e fundit e po këtij traktati!

Sepse popujt vazhdojnë të mbeten kokëfortë, pavarësisht nga ndëshkimet.

Ndërsa revizionistët modernë po e kuptojnë çdo ditë e më tepër se ata nuk do t'i shpëtojnë dot revizionimit kapital!

Ata e kanë të qartë tashmë se po afron dita kur populli do t'i mbyllë përgjithmonë në depon e materialeve të dala jashtë çdo përdorimi!

MREKULLITË E ORËVE TË FUNDIT

Një gjeolog sovjetik në Kamçatka u gjend befasisht përpara një ariu të uritur. Gjeologu, pa humbur gjakftohtësinë, i futi ariut në gojë një shishe me qumësht të sterilizuar dhe pastaj u përçafuan si miq të vjetër. Këtë gjest gazetat e vlerësuan si kulmin e shkathtësisë dhe të manovrimit. Ndërsa vetë gjeologu nuk është i këtij mendimi. Ai i ka të freskëta përçafimet e trojkës hrushoviane me ujçërit japonezë, pasi u kanë futur në gojë këtyre të fundit dhjamë nga i Siberisë.

Gjesti i gjeologut është, pra, vetëm një shfrytëzim eksperience në marrëdhënjet me shtazët dhe asgjë më tepër.

*
* * *

Në një kopësht zoologjik të Londrës, dy meshkuj dhe një femër (Pitter Katner, Stuart Brizhi dhe Xhenet Doiters) janë mbyllur në një kafaz të përbashkët. Qëllimi i këtij marifeti, sipas shkencëtarëve të tregëtisë, është që të vërtetohet reagimi i publikut me rastin e vizitës që u bëjnë këtyre «kafshëve».

Megjithatë, këto lloje «kafshësh» nuk janë krejt të humbura. Si në Londër, si në qytete të tjera po kaq të kulturuara të botës perëndimore njeriu e ndjen veten më të sigurtë në kafazet e kopshtit zoologjik se sa në rrugët e «lira», ku enden njerëzit e qytetëruar. Sepse kopshti zoologjik, në fund të fundit, nuk paraqet ndonjë interes të posaçëm për bandat e gangsterëve.

Një fotoreporter fotografoi brenda një kopshti shtëpiak në periferinë e Londrës dy lepuj të futur në dy këpucë të braktisura.

Në të vërtetë fotoreporterit i zellshëm është lodhur tepër. Ai kishte më afër selinë e kryeministrit Hill, të cilit zhvlerësimi i stërlinës engleze ja ka futur të dyja këmbët në një këpucë. Ndoshta kështu fotografia do të kishte më tepër sensacion.

Në Francë janë burgosur 835 narkomanë. Nga këta 678 të helmuar. Dogana vetëm njërit i konfiskoi 691 kg. heronit, 198 kg. morfium të papërpunuar, 222 ampula morfiumi e të tjera.

Shfirat janë aq entuziazte, saqë edhe apologjetët e rinj të kapitalizmit mund të flenë të qetë (kuptohet pasi të kenë pirë morfinë) për lumturinë e botës kapitaliste.

PËRGJIGJA E CARIT

Ish-ushtarit të mirë Shvejk, tani horr, bandit, kundërrevolucionar, nacionalist dhe antisovjetik me damkë me banim gjysmëilegal në Pragën e lirë.

— Ç e k o s l l o v a k i —

Së pari, o Shvejk, o idiot noterik, po të përgjigjem jo pse një i pacipë si ti e meriton përgjigjen time humanitare. Motivët që më shtyjnë ta bëj këtë gjest bujar i përkasin internacionalizmit tonë të ri fisnik dhe të paparë ndonjëherë në marrëdhënjet midis kombeve vëllezër.

Unë dëshiroj me sinqeritet të sqaroj të gjithë njerëzit e mashtruar, plus viktimat nga propaganda juaj kriminale e armiqësore e ushqyer nga disa fuqi të huaja.

Së dyti, vetë ti ke nevojë të mësosh mjaft gjëra, pasi ke mbetur aq prapa botës, sa duket sikur vjen nga epoka e piramidës së Keopsit.

Ti, Shvejk, duhet të dish se unë nuk jam Car dhe as perandor, (si ai për të cilin ti ke luftuar dikur me armë në dorë). Unë jam sekretari i parë i Presidiumit të Komitetit Qëndror të PK të BS. Po me siguri që ty të kanë rrjedhur fare edhe ato pak tru idio-

ti që pate dikur dhe nuk merr vesh fare se ç'është partia dhe ç'është komunizmi.

Komunizmi, o Shvejtk, është ai sistem social, ku njeriu me njeriun është vëlla, bile më tepër se vëlla, aq sa edhe supën mund ta hajë në një çanak me tjetrin. Kurse partia është vëllazërimi i barabartë i këtyre vëllezërve. Ndërsa unë, si të thuash, jam vëllai i madh i kësaj familjeje të madhe.

Por, më duket se mundohem kot. Nuk e besoj që truri yt i çoroditur nga ekstremistët t'i pranojë shpjegimet e mia të singërta.

Përveç kësaj ti je verbuar nga nacionalizmi perandorak dhe, me siguri shpjegimet e mia shkencore do t'i kthesh në anekdota rrugësh e kabaresh.

Ti ke arritur të shpifësh, duke thënë se '60 tanke nga tonat kanë dalë të shtypin demonstratat e 2 gushtit.

Mirë, o horr klasik, po si nuk u skuqe e si nuk u zverdhe kur ta nxuri goja gjithë këtë shpifje të paparë në historinë e perandorisë?

Është e vërtetë se ato ditë tanket tona dolën në mes të Pragës së lirë, por jo me ato qëllime që ke trumbetuar ti, o armik i internacionalizmit tonë social!

Tanket tona dolën që të shkonin për riparim në oficinën e tankeve. Por, meqë rruga ishte e zënë nga demonstruesit antisovjetikë, na u desh të kalonim përmes Pragës së turbulluar nga elementë të dyshimtë.

Kurse ti për ne nuk je i dyshimtë, por tepër i qartë: armik i betuar dhe i përjetshëm! Mos harro se ti ke qëlluar dikur me armë zjarri mbi ushtritë tona, kurse ne jemi aq humanitarë, sa nuk po të ndëshkojmë ende për këto. Po hajde e mbushi mendjen një idioti në katror, siç je ti!

Mosmirënjojha e një shpirtkazme arrin gjer aty, sa të lavdishmit Husak, i thua: «qen i shitur». Këtë ti e bën me siguri që të më fyesh edhe mua personalisht, meqë unë e propozova që të dekorohesh me urdhërin «Lenin». Përse kur dekoruam Indira Gandin po me këtë urdhër, o i paperëndi, nuk e hape gojën? Apo pse vetëm tani t'u dha rasti ta derdhësh gjithë helmin tënd antisovjetik?

Ti, Shvejk, je më të vërtetë një kriminel më vete, i padenjë për asnjë lloj litari, qoftë prej kërpi, qoftë prej kaproni. Po si, mor mosmirënjojës, helikopterët, autobлиндat dhe maqinat zjarrfikëse, që ne me shpirtmadhësi i sakrifikojmë për ruajtjen e rendit tuaj, ti dhe shokët e tu banditë i pritni me shishe benzine? Në vend që t'u hidhni tufa me lule!

A doni ndëshkuar posaçërisht ju, për këto shkelje të edukatës komuniste? Dhe a e besoni tani se gjer ku arrin durimi ynë historik?

Kurse ju, si kriminelë profesionistë, arritët gjer aty sa të përdornit edhe armët e zjarrit, duke vrarë 20 nga ushtarët tanë më të lavdishëm. Dhe shpifët me paturpësi, se ne i varrosëm fshehura, kur ne do t'i shpallnim botërisht si heronj të internacionalizmit tonë socialist.

Megjithëse jam i sigurtë se po rrah ujë në havan me një idiot fantastik, prapëseprapë detyrimet që kam karshi popullit tuaj të lavdishëm dhe konsideratat personale që kam për atë vend të bekuar më nxisin ta çoj deri në fund këtë letër sqaruese.

Ti me atë bandën tënde terroriste po nxini muret mikpritëse të Pragës socialiste me parulla të tillë armiqësore, si: «Okupatorë shporruni në shtëpitë tuaja... Po kujt i thua okupator ti, o pykë? Vëllezër-

ve çlirimtarë u thërret kështu? Ja, kësaj i thonë: bëj mirë e gjej keq!

Shvejk, poshtërsitë dhe paudhësitë e tua s'kanë fund. Edhe si kur të varesh 300 herë në sheshin «Vençesllav», prapë nuk do të arrish të shlyesh as të një-mijtën e krimeve të tua antisovjetike. Bile, unë çuditem përse midis 3690 të arrestuarve gjatë 20-21 gushtit nuk ishte edhe fytyra jote prej Kaini.

Kjo me siguri vjen pse ti je aq i poshtër, saqë askush nuk don t'i ndotë duart me kreaturë të tillë!

Po me gjeneralin tonë Jepishev, i cili vazhdon inspektimin ushtarak nëpër Çekoslovakia, ç'të ka zënë që po i ngjit gjithfarë epitetesh të ndyra? Bile ti, jashtë çdo norme të edukatës, e ke krahasuar me një gjeneral V.C-shë që paskeni patur ju dikur në ato hordhitë-tuaja plaçkitëse.

Ne pritëm me përzemërsi të paparë, ajkën e popullit tuaj, Husak, Svoboda, Sadoyski, Colotkan, Jan Marko... Po si e komentuat ju këtë gjest bujar? Thatë se ne i thirrëm që t'i çmonim se sa para u vlen-te lëkurë sikur të qenë derra pazari!

Shokët e tu dhe ti vetë i keni kthyer sheshet e Pragës aq të bukura e aq të hijshme në arëna rrëmuje e vandalizmi, ashtu siç bënë dikur fiset barbare në Romën antike.

Ti je aq i shfrenuar në propagandën antisovjetike, sa nuk t'u durua, po edhe me rastin e vitit, të ri arësimor mbajte një fjalim kundërevolucionar. Zatem ti nuk le rast pa shfrytëzuar, për të shfryrë historinë tënde antiruse.

Shvejk! Çdo pretencë ty të çon drejt litarit, por as kjo, si idiot që je, nuk të bën ndonjë përshtypje për të qenë. Nga ana tjetër, as unë nuk kam ndër



mend të bëhem prokurori yt. Se ti ke shkuar edhe herë të tjera në litar, por çuditërisht ke shpëtuar, se asnjë litar, gjer tani, nuk ka mbytur ndonjë idiot të tillë prehistorik.

Nejse, unë mendoj t'i mbyllim hesapet e vjetra dhe të hapim të rejat. Pavarësisht nga mosmirënjohja juaj, ne do t'i vazhdojmë sakrificat në adresë të Pragës së artë. Do ta bëjmë të mirën dhe, siç i thonë, do ta hedhim në det! Se ne nuk mund të durojmë, kur dikush nga forcat bandite tallet me fitoret e socializmit në një vend aleat.

Tani ju po e ndërtoni socializmin për zili! Ndihma internacionaliste nuk po ju mungon. As ju kursehet. Asnjë vend nuk është ndihmuar kaq shumë gjer më sot. Si ekonomikisht edhe ushtarakisht! Pra, ç'keni, pse nuk ju nxe vendi, siç bëjnë qengjat e urtë që pinë dy nëna!?

Asnjë vend në botë nuk do të lulëzojë si ju. Dhe kjo në sajë të peshës së madhe vëllazërore që po qëndron mbi shpatullat tona. Pra ju s'keni asnjë arsëye serioze që të djersitni, siç pretendohet.

Është e vërtetë se çmimet po ngrihen, po kjo është tepër e përkohshme dhe vjen gjithë për fajin tuaj. Megjithatë në farmacitë tona do t'i gjendet ilaçi edhe kësaj belaje.

Shvejk! Ti dhe shokët e tu po bëheni pengesë serioze për ndërtimin e komunizmit në shkallë të gjerë, ashtu siç na e do zemra neve. Këto nuk janë punë të mira dhe interesat e historisë kërkojnë që të tilla veprime të ndëshkohen pa hezitim.

Pra, më ngadalë, Shvejk, më shtruar në këto brazda të thella! Nuk bëni mirë t'i zini qetë me humanizmin tonë të madh. Pavarësisht nga këto, ne do

t'ju gjendemi fare pranë në çdo rast të vështirë e kritik. Si vëllezër të mëdhenj!

Pavarësisht nga konsideratat personale dhe pikëpamjet shoqërore, të fala socialiste:

Leonid Brezhnev

D. V.

ULTRAREVIZIONISTE

BRSS.

«Kushtet për thirrjen e menjëhershme të mbledhjes evropiane për problemet e sigurimit dhe të bashkëpunimit në Evropë janë pjekur», shkruan paçavurja revizioniste «Pravda». S'do mend, sheh dardha dardhën dhe piqet...

Imperialistët amerikanë kanë krijuar NATO-n, SENTO-n, SEATO-n, kurse socialimperialistët sovjetikë nuk mund të rrinë vetëm me Traktatin e Varshavës. Pas «sigurimit kolektiv në Azi», revizionistët sovjetikë nuk i zë gjumi edhe për sigurimin e Evropës sipas aspiratave të car Nikollës. Ëndrra të vdekura në shpirtëra të vdekura.

*
* *
*

Lituanian sovjetike ka arritur suksese të rëndësishme në luftën kundër fesë. Këto ditë Papa i Romës, Pavli VI emëroi Romauld Krikshjunasin peshkop titullar të Amait, kurse Ludovik Pavlonasit, për merita të veçanta, ju dha titulli peshkop i Arkavisë dhe ndihmës i Platkusit. Por emërimet peshkopale

në Bashkimin sovjetik përveç nënshkrimit zyrtar të Papës, kanë dhe nënshkrimin e heshtur të carëve të Moskës, të cilët njëri pas tjetrit i kanë puthur dorën Papës. Me këtë dashuri që po tregohet ndaj Vatikanit, nuk duhet çuditur, që ndonjë ditë Papa ta shpërngulë selinë e tij nga Roma në Moskë.

*
* *
*

Italia do t'i japë kredi Bashkimit Sovjetik rreth 500 miliard lireta. Gjysma do të përdoret për ndërtimin e gazsjellësit nga Çekosllovakia përmes Austrisë në Itali, pjesa tjetër për ndërtimin e fabrikës «FIAT» në Bashkimin Sovjetik. 15 banka gjermanoperëndimore janë të gatshme që t'i japin Bashkimit Sovjetik rreth 400 milion dollarë kredi me një kamatë prej 6-6 për qind për 10 gjer 12 vjet.

Ja një kapitull i ri mbi «ndërtimin e plotë të shoqërisë komuniste në Bashkimin Sovjetik me ndihmën miqësore edhe pa interes të kapitalit monopolist ndërkombëtar». Ky kapitull i mungonte edhe Buharinut edhe Trockit.

*
* *
*

JUGOSLLAVI

«Në Vojvodinë del në pah gjithnjë e më qartë roli i fshatarëve-mbikëqyrës, të cilët praktikisht nuk merren më me prodhimin drejtpërdrejt bujqësor, por me veprimtari të ndryshme «fitimtare», njofton agjencia e lajmeve Tanjug. Po, por kjo agjenci harron

të sqarojë nëse rruga e «socializmit specifik» do të çonte në ndonjë përfundim tjetër apo jo.

Punonjësit shkencorë të Institutit të Gjeografisë në Zagreb mendojnë se puna në botën e jashtme paraqet një nga faktorët e rëndësishëm të sotshëm të transformimit social-ekonomik të disa krahinave në Jugosllavi. Ky konstatim paraqet «çështjen kyç» në mbarim të studimit të këtij instituti, në kapitullin shkencor «punëtorët jugosllavë në Republikën Federale Gjermane», ku ka marrë pjesë edhe Instituti Gjeografik i shkollës së lartë teknike në Munih.

«Nga viti 1965 deri në vitin 1968 kanë shkuar për të punuar në Republikën Federale Gjermane 168.312 qytetarë jugosllavë...»

Përse pra çirren më kot njerëzit për papunësinë në Jugosllavi, kur «socializmi specifik» po ndërtohet edhe në Republikën Federale Gjermane për llogari të Titos? Një tjetër filial po kaq i madh i këtij socializmi është hapur edhe në vende të tjera kapitaliste. Por kjo nuk do të thotë se Titua po eksporton «socializmin e tij specifik». Përkundrazi ai, pasi ta përfundojë së ndërtuari këtë biçim socializëm në vendet kapitaliste, do ta importojë atë tërësisht në vendin e tij.

POLONI

Varrimet në Poloni po kthehen në melodramë publike. Ja disa aspekte nga varrimi i një «komu-

nisti»: Në krye të kortezhit të përmothëm vinin priftërinjtë që luteshin e faleshin pareshtur për shpirtin e të ndjerit, më pas banda frymore ekzekutonte hymne e këngë revolucionare. Kjo nuk është, pra, sallatë ala-rus, por sallatë ala-Gerek!

• • •

Gereku meqë shpenzimet e varrimeve, në Poloni janë rritur pa hesap, u sugjeron nënshtetasve të vet se kanë më tepër leverdi të vdesin diku jashtë shtetit se sa aty. Tani merret me mend: varrimet dhe sa vijnë e po shtrenjtohen në regjimin revizionist, le pastaj jeta! Por pa dyshim më i shtrenjtë dhe më interesant ka për të qenë varrimi i Gerekut dhe i klikës së tij nga klasa punëtore polake...

• • •

Polonia i dorëzoi një notë Gjermanisë Perëndimore që bisedimet politike midis të dyja qeverive të «fillojnë sa më parë». Boni u tregua tepër i gatshëm dhe notës ju përgjegj me një notë më të lartë dhe më të nxehtë. Kur të qan zemra për komshien, si mos t'i përgjigjesh thirrjes së saj miqësore? Pra Polonia nuk do të vuajë shumë shpirtërisht për arsye se Gereku di ta vërtisë punën. Mëritë e vjetra, lufta, gjaku? — do të pyesë ndokush! Këto duhen harruar, përderisa edhe gjaku bëhet ujë. Por revizionistët polakë harrojnë se ujku do gjak e jo ujë.

VEZA E KOLOMBIT

Ishim përpara sahatit me Maksin. Po prisnim nga Patosi një shokun tonë. Mezi i kishim gjetur një biletë dylekëshe. Sheshi përpara sahatit qe mbushur plot e përplot me tifozë. Dikush priste dikë, dikush shpresonte, një tjetër përtypte cigaren nga inati dhe pak më tej dikush fliste me vete.

Unë përfat e kisha siguruar biletën me kohë, ndaj nuk qe nevoja as të përtypja cigare dhe as të flisja me vete.

Shoku ynë nga Patosi po vonohej. Ora e ndeshjes po afronte. Ne numëronim me mend se sa vende mund të ishin zënë deri atë kohë, sa ishin rezervuar dhe sa mund të ishin ende të lira.

Dendësia e tifozave sa vinte e shtohej. Dendësia mesatare e tifozave përpara sahatit tashmë duhej të qe rreth 4-6 veta për metër katror.

— Do ta shes biletën — tha me nervozizëm Maksi.

— Je në vete — ja ktheva ashpër unë. — Këtu do të na mbytin. Shiko sa njerëz ka. Eja t'ja mbathim sa më parë, se ndryshe nuk do të dalim dot nga kjo bela!

Por unë flisja më kot. Dikush kishte dëgjuar se ne do të shisnim një biletë dhe u vërsul mbi ne. Mbi të u vërsulën edhe tre të tjerë, pastaj vrapuan nëntë të tjerë, dhe pas tyre vërsluan tëtëdhjetë e një tifozë të tjerë. Të tjerë dhe të tjerë shpërthyen nga të katër anët. Tashmë ishim rrethuar mirë nga të 360 gradët.

Shtynin e shtyheshin me tension nga çdo anë. Por i gjithë ky presion rëndonte mbi ne të dy.

Thonë se presioni rritet në raport me thellësinë e detit, por unë betohem, që presion më të madh se aty nuk do takoj as në fundin më të thellë të oqeanit.

Dy herë fasulet e drekës më erdhën deri te gryka dhe u kthyen sërish prapë, meqë unë ndala frymëmarrjen.

— Po ç'na bëre, o i mallëkuar, ç'na bëre, mor Maksi! Si dreqin do të dalim tani nga ky rrethim i zjarrtë? Më mirë të vije në djall me gjithë atë biletë dylekëshe! Po a shitet këtu bileta për një takim ndërkombëtar si ky i sotmi?

— Atë e di unë — ma ktheu i qetë Maksi. — Kryesorja është të ruash gjakftohtësinë. Kurse ti, fillove të ulërish si çakalli. Problemi është për të dalë sa më shpejt dhe sa më lehtë nga ky rrethim i hekurt dhe jo të ulërish si ti!

— Po hë de, se dhe unë atë dua! Të dalim sa më parë dhe pastaj diku të ndonjë kirurg të bëjmë inventarin e gjymtyrëve.

Ndërkohë rethi sa vinte e shtoej, forcohej dhe dendësohej. Tashmë duhej të qenë grumbulluar rreth 27-30 veta për metër katror.

— Shok, o shok, të lutem, ma jep mua!

— Unë të thashë i pari, mos harro!

— Mua një biletë, mua...

— Nxire të shkretën, se më nxore shpirtin — ulëriti një tjetër, duke mbërthyer Maksin për jake.

Një dorezë ombrelle më kapi për qafe dhe po më tërhiqte pas me sa dukej drejt pronarit të vet.

— Ma jep mua — urdhëroi një zë basi. Po më zhej fryma dhe nuk dija nga t'ja mbaja. Sytë po më lëshonin xixa. Nuk ktheja dot kokën nga prapa të shikoja se kush qe autori i kësaj shpikjeje, për t'i kthyer së paku honorarin. Sytë po më zmadhoheshin në përmasa alarmante. Ajri nuk po qarkullonte më nëpër organet e frymëmarrjes.

Për fat doreza e çadrës u këput dhe gryka ime u lirua përnjëherësh. Mora frymë thellë dhe sytë m'u kthjelluan përsëri. Pallati i Madh i Kulturës përballë, që më ishte larguar disa kilometra, m'u afrua sërish dhe zuri prapë vend aty ku kishte qenë më parë.

Ndërkohë ajri po nxehej si në furrat e shkrirjes së aluminit.

— Të mori djalli, Maksi, ç'na fute në këtë belaj! Hë, tani, bëhu zog me krahë dhe fluturo nga kjo unazë betoni!

Djersët na kishin mbuluar dhe po qarkullonin lirisht nëpër tessa. Këmbët e mia po shkelnin disa këmbë të tjera s'di të kujt, ndërsa të tjera këmbë të paightifikuara po shtyheshin mbi këmbët e mia. Pra isha vënë midis dy presash.

Pas pak nuk mora vesh se si në kokën time u rras një kasketë kadifeje. Pastaj kasketa iku apo fluturoi vetëvetiu, nuk e mora vesh mirë, dhe në vend të saj më mbuloi një kashtore e stërmadhe, e cila kapërceu të dy veshët e mi. Pasojë direkte e kësaj qe se mua kapela më zuri dritën e syve. Por një do-

rë shpëtimtare ma ktheu sërish fushën e pamjes.

— Shokë — ulëriti Maksi. — Mos u shtyni më kot! Bileta kushton 50 lekë.

— Maksi, je në vete? Nga të shkrepni kjo ide? Kërkon të spekulosh me një biletë? Dhe si, njëzet e pesë herë më shtrenjtë? S'të paskam njohur mirë Maksi! Si nuk skuqesh xhanëm?

Ndërkohë presioni rreth nesh filloi të binte me shpejtësi. Njerëzit na shikonin me përbuzje, siç mund të shihen dy bataqinj.

— Si nuk kanë turp xhanëm!

— Dhe janë alamet djemsh!

— Ngjajnë dhe me kulturë!

Pas pak pranë nesh qëndruan vetëm dy veta. Njëri mbante një gjel në dorë, tjetri 50 lekë.

— Urdhëro gjelin dhe hallall e paç — tha pronari i gjelit, duke i zgjatur Maksit shpendin e madh e të zi, të cilin donte ta shkëmbente me një ekuivalencë gesharake për vlerën e tij.

— Vetëm kjo 50-lekëshe, më ka mbetur — tha tjetri. Vij që nga Vlora. Ta jap me gjithë zemër. Mos pandeh se më vjen keq. Vetëm pa biletë mos më lërë.

— Po ju, more të uruar jeni dy veta — tha Maksi. — Kujt t'ja prish e kujt t'ja ndreq! U pa puna, do e hedhim në short. S'ka rrugë tjetër!

Ata pranuan. Unë u hoqa mënjanë për të mos patur gisht në këtë spekulim dhe po pregatisja fraza demaskuese për Maksin.

Shorti i ra atij që ofronte të 50 lekët. Maksi me qetësi i dha biletën, mori kartmonedhën e vetme dhe pa vonuar i ktheu dyzet e tetë lekë resto. Tjetri protestoi me zjarr.

— Pse, ç'më pandehe mua? Ç'jam unë? Të lu-

tem, nisu se vajti vonë! S'kisha si veproja ndryshe. Me çmimin e zakonshëm do më mbysnin ofertat, por jo vetëm kjo. E nga ta merrja vesh unë, se kush ishte më tifozi ndër të gjithë këta tifozë? Sidoqoftë më shtrydhën mirë, apo jo? Më duket se dy brinjë kanë ndërruar vend.

Dikush aty pranë psherëtiu dhe tha: — Ah, ja veza e Kolombit. Sikur ta kisha ditur! Djalli e mori, më shpëtoi nga duart.

Unë ju afrova Maksit dhe e mora për qafe.

— Po ti, ç'pate? — pyeti ai i hutuar.

— Më fal, Maksi! Unë...

— E përse të të fal? Lëri komeditë dhe eja të rendim se mbetëm!

Kështu të tre u nisëm për në stadium.

GJEOLOGJIA BUJQËSORE

Hyrjen e gjeologjisë ma kishte zënë një autokombajnë fringo e re. Po ajo, ç'donte aty?

Kushdo e di se gjeologjia studjon formacionet e tokës, po kjo nuk do të thotë aspak se ajo mbjell apo korr!

Ç'i paska shkrepur gjeologjisë të merret me autokombajna? Mos ka vendosur t'i vejë në ndihmë ndonjë NBSH-je, apo ndonjë kooperative bujqësore? Po tani nuk është as fushatë korrjeje, të shkretën?

Për këto më sqaroi shoku im, Skënderi, shefi i planit. Ngjarjet kishin zënë fill me një bisedë telefonike.

Baza grosiste: — Alo? Gjeologjia jeni? Gëzohemi shumë! Ju kërkonim ka dy ditë. Ju vemë në dijeni se në adresën tuaj ka katër ditë që ka mbërritur këtu një autokombajnë. Po! Kemi mirësinë të na e hiqni një orë e më parë, pasi na kanë zënë vendin.

Gjeologjia: — Si thatë, autokombajnë? Po ç'na hyn në punë neve, mor shok, autokombajna?

Baza grosiste: Edhe ne çuditemi, po përdërisa e keni në plan, duhet ta tërhiqni një orë e më parë! Ne s'kemi vend. Pastaj edhe kamata hypën për llogari tuaj!

Gjeologjia: — Alo! More shokë, po shikoni

se mos ka ndonjë keqkuptim, apo gabim në këtë mes? Ne nuk kemi ndër mend as të mbjellim dhe as të korrim!

Baza grosiste: — Ju ndoshta nuk keni ndër mend, po mund ta keni në plan. Meqë bujqësia po merr rëndësi të madhe këtë vit, mundet t'ju kenë planifikuar edhe juve të gjeologjisë nga një autokombajnë. Mundet vitin tjetër të hapet ndonjë degë e re në kërkimet gjeologjike. Fjala vjen, mund të krijohet «gjeologjia bujqësore», apo diçka tjetër e këtij lloji. Sidoqoftë, bëni si të bëni, neve aq na bën!

Po nuk erdhët një orë e më parë ta tërhiqni, ne do t'jua plasim në derë! Oj, po ku është parë kjo?! Gjetëm belanë me disa klientë! Edhe i kanë në plan, edhe nuk i terheqin!

Gjeologjia: — Po daleni, more shokë! Ta marim pak më shtruar se, po ta shikosh nga njëra anë çështjen...

Baza grosiste: — Ohu, nga të duash shikoje! Neve aq na bën. Ju e keni në plan, pra, i pafshi hajrin!

Kaq tha baza grosiste dhe e mbylli telefonin.

Të nesërmen, furnitori i saj takoi Skënderin. Shefi i planit e çoj atë në bufenë e xha Llukës, ku morën nga një bërçollë me verë Përmeti. Po as bërçolla dhe as vera e Përmetit nuk ndikuan dot mbi fatin e autokombajnës. Ajo që sakrifikuar për gjeologjinë! Edhe gjeologjia duhej të sakrifikonte për të: ta dimëronte!

— Shoku furnitor! — i kishte thënë Skënderi. — Jam më se i sigurtë për këtë! Këtu kemi të bëjmë me një keqkuptim. Ne kemi porositur sonda dhe jo autokombajna.

— Ehu, se mos jeni rasti i vetëm. Ka edhe më

keq. Fjala vjen, spitalit i kanë ardhur manjetofonë, rondele dhe hanxharë, revistës «Hosteni» plugje për qilizëm, e ku di unë. Edhe ju një rast i tillë duhet të jeni. Edhe unë kështu mendoj. Dhe kështu duhet të jetë. Por, sapo që në adresën tuaj mbërrin një autokombajnë, më thoni, ju lutem, si të bëj unë? Kujt t'ja plas në derë? Aaa, të qe televizor, ndryshonte puna. Edhe mund të rregullohej! Sos është dhe ndonjë artikull i vogël të cilin mund ta fshihja midis arkave të ambalazhit.

— Po ne ku ta shpiem?

— Ku të doni! Fundi, ç'ke ti? Po respekton planin, asgjë më tepër. Të gjithë me planin duhet të jemi brenda.

— Si, ore, planin?! Ne nuk kemi ndër mend t'i kthejmë minierat në fusha me grurë. Se gruri nuk korret nën tokë por mbi tokë!

— Bëni si të bëni, unë s'kam nga ja mbaj.

Pasi takimi i bërksollave me verën e Përmetit nuk e anuluan dot nisjen e autokombajnës, gjeologjia filloi të rrihte telat.

Ku qe parë kjo? Por, plani! Ishte plani ky! Ç'u duhej atyre që hidheshin përpjetë? Le të merrnin autokombajnën, pastaj të sqaroheshin.

Ose le ta rregullonin vetë punën me SMT-në. Ose me Ministrinë e Bujqësisë. Fundja edhe me ndonjë NBSH.

Kjo edhe mund të qe rregulluar, po të mos ishim në fund të dhjetorit. Dhe dihet se për kushtet klimatike të vendit tonë gruri nuk duron të korret në fund të dhjetorit. Përkundrazi, në këtë kohë duhet të ketë përfunduar që para dy muajsh mbjellja.

Por, autokombajna nuk kontribuonte dot në mbjelljet, qoftë dhe dy muaj pas përfundimit të tyre.

Ajo qe e destinuar vetëm për shirje. Si e tillë duhej të dimëronte në gjeologji. Dhe të hidhej përpjetë sa të donte Skënderi, shefi i planit të gjeologjisë. Baza grosiste qe brenda. Pas dy ditësh ajo i plasi në derë autokombajnën.

— Ç'i thua kësaj? — më pyeti i indinjuar Skënderi.

— Nuk di ç'të të them! — ja ktheva. — Ndoshta në të ardhmen gjeologët duhet të merren edhe me korrje-shirje. Pa firo, bile!

— Çudi! Po a nuk më ndihmon dot ti?
— Do flasim me NBSH-në. Sidoqoftë, në të ardhmen, ju të gjeologjisë duhet të merreni edhe me bujqësi. Se sot ju erdhi një autokombajnë, po nesër mund t'ju vijë ndonjë fabrikë mielli — i sugjerova unë.

KËRKOHET NJË QAFIR.

— novelë —

Në vend të parathënjes

Zakonisht parathënjet shkruhen për disa lloje veprash të mëdha, siç janë romanet, tragjeditë, drammat, apo kompozimet skulpturale, ose edhe për ndonjë vepër tjetër voluminoze kësodore. Por, meqë unë nuk kam menduar të shkruaj ndonjë vepër të tillë të madhe, e gjeta me vend të bëj një parathënie të gjatë për një tregim të shkurtër timin. Ai do të nisë fill pas kësaj parathënie.

Arësyet që më shtyjnë ta shkruaj këtë parathënie, janë të shumta dhe të forta. Unë do të përmend këtu në formë përmbledhëse ato më kryesoret.

Kam shkrojtur disa tregime, po asnjë lloj parathënie. Pra, ligjërisht më përket e drejta ta provoj penën time edhe në këtë komunitet të paprekur prej meje.

Çështjet që zënë fill në tregimin tim pas parathënjes, vende-vende mpleksen dhe ngatërrohen aq shumë, saqë kam tepër frikë se do të merren si të imagjinuara, kur ato kanë ngjarë para syve tanë nga

persona që marrin dhe nxjerrin frymë rregullisht.
Këto ngjarje nuk do të kishin zënë fill, sikur përpara tyre të mos qe bërë sebeb një ndodhi e rëndomtë: botimi i një fejtoni të shkurtër.

E, megjithëse fejtoni qe i shkurtër, jehona e tij zgjati shumë. Qe një jehonë e gjatë dhe interesante. Aq interesante, saqë disa dashamirës të humorit, më këshilluan të shkruaj një komedi. Por, meqë nuk më kanë ecur krushqitë me teatrin, vendosa që këtë barrë t'ua lë në mirëbesim humoristëve. Vetë nuk mund t'i shtrij këmbët më tepër nga ç'kam rrogazin.

Unë përherë kam qenë dhe mbetem i mendimit, se ngjarjet jetësore shpesh bëhen burim frymëzimi për vepra të reja. Kjo gjë duhet patur parasysh edhe në parathënjet. Ka ardhur koha që këto të shihen me seriozitet dhe më me përgjegjësi.

Disave mund t'u duket e pabesueshme, por është vërtetuar shkencërisht se parathënjet ose mund ta përmbysin një vepër, ose mund ta ngrenë atë në pedestal. Njihen edhe raste që ato i japin hakun veprës që vjen pas tyre.

Qëllimi i parathënjes sime mbetet po aq fisnik, sa edhe mjeti: Të vlerësojë veten e saj si dhe atë që vjen pas saj.

Fejtoni ishte me të vërtetë tepër i shkurtër. Nuk më kishte rënë rasti gjer atëherë të lexoja një fejton më të shkurtër.

Ndoshta këtu duhet kërkuar edhe arësyeja kryesore që unë e mbaj mend krejt përmendësh, në një

kohë kur harroj se përse mund të jem kritikuar përpara disa vjetësh nga shefi im.

Puna ma do që atë fejton ta riprodhoj këtu me besnikëri. Ja pra!

«DREJTORI KËRKON NJË QAFIR»

Qafiri është ai që ka kritikuar drejtorin, (sigurisht pa ja vënë gishtin kokës). Kurse drejtori, nga ana e tij, e kërkon të pabesin për ta ndëshkuar sipas kanuneve të shënjta të hakmarrjes!

Në të vërtetë drejtori ynë nuk është hakmarrës. Është i urtë dhe i shtruar. Mund të durojë çdo gjë. Edhe shiringën kundër tetanozit edhe atë kundër tërbimit. Mund të durojë edhe shumë prova të tjera të mëdha.

Vetëm kritikën nuk e duron dot drejtori ynë! Po e kritikove, kjo është baraz me dy veprime ekstreme: prerje e marrëdhënjeve diplomatike dhe shpallje lufte.

Kështu ngjau edhe këtë radhë. Përgjegjësi i kuzhinës kritikoi drejtorin se i kishte prurë për kryekuzhinierë një teknike të duhanit. Drejtori për hakmarrje, pas ca kohe, shkarkoi nga detyra përgjegjësin e kuzhinës.

Në vend të tij u emërua ish-shoferi i drejtorit që kishte dy muaj pa patentë. Atij i hiqej patenta disa herë në vit dhe drejtori kishte gjetur belanë me të. Duke e futur në kuzhinë, drejtori mendoi se, aty askush nuk do të ja hiqte më patentën shoferit. Na u dha mundësia që në kuzhinën tonë të hanim qofte aromatike me guarnicion testatoje, bërçolla me marsh injetro, supë me valvolinë apo imambajllidi të pomçisë.

Për këto novacione në kulturën kulinare, drejtori u kritikua në kolektiv nga një person i pidentifikuar. Bash për këtë shkak, drejtori tani për tani i ka lënë për më vonë të gjitha detyrat e ditës dhe është hedhur me të gjitha forcat e gjalla në kërkim të atij të pabesi që guxoi ta kritikonte. Me këtë rast, janë të lutur gjithë të afërmit, shokët dhe dashamirët e tij, që t'i vijnë në ndihmë në këtë ndërmarrje fisnike. Ai mirëpret çdo shërbim në cilëndo orë apo minutë!

N. Nallbani

Këtu mbaron fejtuni dhe fillon tregimi.

Sapo e lexoi drejtori përkatës ra në mendime serioze... Atë me të vërtetë nuk e vriste këpuca. Përpara tij hapeshin dy rrugë: Ose ta studjonte me kujdes kritikën, të shikonte ç'kishte të drejtë aty dhe të merrte masat përkatëse, ose ose, të mësonte se kush kishte guxuar të ngjyente penën në bojë për të marrë nëpër këmbë autoritetin e tij.

Drejtori nuk e kishte për zakon të mendohej gjatë. Për të vënë në vend atë që kishte humbur, (gjë që vjen në kundërshtim me një proverb popullor) drejtori zgjodhi rrugën e dytë.

Ai mblodhi menjëherë shtabin e tij të përbërë prej shtatë vetash. Nuk është e vështirë që në një ndërmarrje të madhe të gjenden shtatë veta për të mbushur gardën personale të një drejtori.

U bënë diskutime të shumta, të gjata dhe të ashpra! Por të gjitha këto (ashpërsia, gjatësia, shumica) rrihnin në një vend: Kush që ky, zorzop, N. Nallbani?

E, meqë nuk po i jepnin dotë rrugë hallit, vendosën sa më poshtë:

1. Të krijohej një komision i posaçëm me këtë mision të posaçëm:

Të paraqitej në Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit dhe në emër të kolektivit (i cili nuk do të pyetet fare) të hidhte poshtë këtë kritikë makabre.

2. Të krijohej një tjetër komision me specialitet përkatës, i cili do të shkonte fill e në zyrën e gjendjes civile të qytetit, por jo si dëshmitar për celebrimet. Ata duhej të shënonin një për një të gjithë qytetarët të cilët mbanin mbiemrin: Nallbani.

3. Të nisej urgjent me «Gazin» e ndërmarrjes për në redaksi një person i shkathët, i besuar dhe i gojës (jo në kuptimin e grykësit, siç duan ta paraqesin punën disa njerëz).

4. Një tjetër komision do të bridhte lagje më lagje, bllok më bllok e berrari më berrari, do të pyeste njerëz të ndryshëm dhe do të përpilonte një listë të plotë të shakaxhinjve të këtij qyteti.

Këtu, puna na e do të ndalemi një për një te çdo komision, pasi nuk kemi se si t'i japim përnjëherë aventurat e të pesë komisioneve, kur ato veprojnë në zona të ndryshme territoriale.

Komisioni i parë

Me në krye kryetarin e tij legjitim, u nis në drejtim të Komitetit Ekzekutiv të K P të rrethit.

Dezhurni i komitetit i sqaroi ata se personi që kërkonin (nënkryetar Sokoli) ndodhej në një mbledhje.

— Po a e dini ju se kur mbaron mbledhja?

— Këtë nuk kam si ta di se nuk varet nga unë!

— Po nuk mund ta merrni me mend?

— As kjo gjë s'më ka shkuar ndër mend!

Komisioni u mblodh një çast në hyrje të komitetit për të marrë në shqyrtim situatën e krijuar pas këtij parashikimi.

— Unë them, që ta presim! — qe mendimi i parë interesant.

— Pa tjetër! Mbledhja dikur do të mbarojë. Në mos sot, nesër. Asnjë mbledhje deri më sot nuk ka mbetur pa u mbyllur! — zbuloi tjetri.

— Një mbledhje që fillon, edhe mbaron!

— Po sikur të lëmë nga një dezhurn pranë dezhurnit të komitetit? Pse të rrimë të gjithë këtu? Ne të tjerët presim në turizmi.

— Llaf me gjongël!

Ky llaf me gjongël u pëlqye nga të gjithë. Ko-

misioni la një dezurn pranë dezurnit të komitetit dhe vetë u shpërngul për në kafën e turizmit.

Më në fund ata i pritën nënkryetar Sokoli.

— Shoku nënkryetar! Ne vijmë këtu tepër të indinjuar nga një skandal publik. Skandali është i madh dhe i pandreqshëm! Sapo lexuam shtypin, ku kritikohet tepër rëndë dhe fare pa të drejtë drejtori ynë shembullor. Ai i cili gjithë jetën e tij ja ka kushtuar artizanatit, drejtësisë dhe sidomos sektorit të këpucëve. Ai i cili është kujdesur që asnjëri të mos ecë zbathur, daç në fshat, daç në qytet. Gjëja më e shtrënjtë në jetën e tij ka qenë drejtësia dhe këpucët. Po ja, këtë radhë ja kanë fyer që të dyja: edhe drejtësinë edhe këpucët.

Ne e shqyrtuam me kujdes kritikën, i analizuam faktet një për një dhe tani vijmë te ju me një kërkesë fare të vogël: Të na bëni të ditur autorin e kritikës.

[Kaq tha kryetari i komisionit të parë, mori frymë thellë, derisa u sigurua se mushkëritë e tij nuk nxenin më, pastaj u ul.

— Vetëm kaq kërkonte nga unë? — pyeti nënkryetari i komitetit, me një ton midis ironisë dhe sarkazmës. Por komisioni, i dhënë me shumë pasion pas misionit të vet, nuk e dalloi dot këtë ton.

— Si urdhëroni, vetëm kaq!

— Mirë, po a ishte e drejtë kritika?

...

— Ju pyes! A ishte e drejtë kritika?

— Nga diskutimi doli se jo!

— Ashtu, ë? Atëhere, unë ju këshilloj që ju të ktheheni prapa! Ta diskutoni edhe njëherë me gjak të ftohtë këtë çështje dhe pastaj vendosni ç'do të

bëni. Po e patë të arësyeshme, mund të vini prapë!
Unë vetë e kam lexuar kritikën. Edhe vetë jam kritikuar në organet e shtypit. Por unë nuk jam në një mendje me ju. Bile çuditëm se, në vend që të bëni autokritikë, ju vini e më kërkoni autorin, sikur do ta shpini drejt e në litar! Pa gjyq fare!

Merreni më shtruar, shokë, merreni më shtruar! Dihet se kritika nuk pëlqehet sa sultjaçi, po edhe zehër nuk është. Kështu, shokë!

Dhe kështu, komisioni, nga majat thembrat, mori rrugën e kthimit, tepër i pikëlluar për këtë dështim të shpejtë e të papritur.

Nuk dinin se kush do t'i dilte në sy drejtorit dhe kush do t'ja jepte i pari mandatën...

Sondazhet personale të drejtorit

...«N. Nallbani... N. Nallbani... po kush, pra, do të jetë ky qerrata? Hej, mos më rëntë në dorë!.. po kush pra?.. Hëm... mos është, ai, drejtori i bankës bujqësore, Nuredin Nallbani? Apo nuk jam grindur kaq herë me të për punën e debitorëve të parashkruar, kur ai qe ende revizor... Apo e kam sharë pak?.. po, po, me siguri ai është!

Dhe e gjeti rastin! Qerratai... Por, do të më shohë... S'e paskam njohur mirë... por as ai nuk më paska njohur mirë! Aq më keq për të! Ka për t'u penduar më herët nga ç'mund t'i shkojë ndër mend.

Drejtori kapi telefonin dhe formoi me nervozizëm numrin.

— Shoku Nuredin?... Po, unë jam! Shoku Nuredin! Kolektivi im ju pret sot në orën 12 të vini e të

bëni autokritikë, lidhur me atë artikullin plot gabime dhe pasaktësira që keni botuar në adresën time.

— Më falni, po unë nuk kam pse të jap llogari përpara kolektivit tuaj për gjëra që nuk më përka-sin. Po qe se ju doni të dëgjoni diçka mbi rolin e bankave, apo të qarkullimit monetar, jam gati.

— Po ju kërkon kolektivi, more shoku Nuredin!

— Ata që më kërkojnë, do të më gjejnë! Unë asnjëherë nuk kam humbur! — dhe shoku Nuredin e la telefonin, se kishte edhe punë të tjera.

Drejtori mbeti me gisht në gojë dhe mjaft i fyer. Dhe u betua sërish për shpagim. Për më tepër se kjo fyerje e madhe vinte pas një tjetër fyerje kolosale. «Ndoshta sot qe dita e fyerjeve» — mendoi drejtori dhe, rrokullisi telefonin...

Komisioni i dytë

Ky komision e kishte më të lehtë punën pasi jo vetëm që nuk pati të bënte me ndonjë instancë eprore, por edhe pse qe ngarkuar me një barrë më të vogël. Për më tepër kjo detyrë u vinte për shtat të gjithëve.

— Shoqja, Linë — ja filloi kryetari i këtij komisioni, duke ju drejtuar asaj, që në fëmijëri e thërrisnin: Trëndelinë, — ne jemi të ngarkuar nga Instituti i Folklorit që të klasifikojmë disa mbiemra popullorë. Qëllimi shkencor i kësaj ekspedite është që të caktojë secilët mbiemra konkretisht janë më të përhapur.

Nuk di, a mund të na ndihmoni edhe ju me arshivën tuaj të madhe.

Lina, meqë i njihte personalisht, nuk e pa me vend t'ua zgjaste, po u vuri në dispozicion përsa kërkonin. Të eturit filluan nga puna.

— Sherbet Karagjoz Nallbani...

— Ali Fate Nallbani...

— Fatos Ali Nallbani...

Në rrugë të kthimit, kryetari i komisionit u shkëput si shigjetë nga shokët dhe i doli përpara një xhaxhoje.

— Më falni, xha Elmaz — ja nisi ai — po desha t'ju pyes për diçka.

— Për hair, biro, se ka kohë që nuk po e pyet njeri xha Elmazin.

— Ju mos e keni patur gjë llogapin Nallbani?

— Unë jo. Po pse, mos hyn gjë në punë ky llogap sot! Se unë njoh disa me këtë llogap.

— Mirë, po ju nuk keni punuar si nallban?

— Eh, e ç'nuk kam punuar unë, mor bir! More nallban do ti a, kovaç do ti a, kallajxhi do ti a, hallvaxhi do ti a!

— Po babai juaj?

— Dardha bie nën dardhë!

— Po gjyshi juaj?

— Atë nuk e kam arritur. Pse të të qesh. Po me sa kam dëgjuar, im gjysh ka qenë kovaç dhe jo nallban.

— Kaq desha! Falemi nderit, shoku Elmaz, më fal, xha Elmaz! — dhe kryetari i komisionit fluturoi për te shokët e tij.

— Allasëndek nga mendtë e kokës! — tha xhaxhoja dhe nguli më tej bastunin e tij.

Drejtori me telefon

E gjithë kjo kryqëzatë bëhej për hir dhe me hir të drejtorit, pra do të ishte fyerje e madhe për të, sikur ta linim fare pa përfillur, sidomos tani nga mesi i tregimit. Apo pak qe fyer!

Ai me mjete dhe forma të ndryshme vihej në ko-

rrent për tërë veprimtarinë e komisioneve të tija të shumta. Por mendja nuk i hiqej nga drejtori i bankës... «Me siguri ai duhet të jetë... dukej që nga zëri... jo si radhët e tjera... apo mos e kishte zënë gripi? Bah, ç'është ky grip në korrik?»

Drejtori mori sërish telefonin. Kërkoj prokurorin e rrethit. Dhe ai i doli.

— E dini si është puna, shoku Mete?

— Gjer tani jo!

— Ja, si t'jua them...

— Thuajeni ashtu siç është. Mos u impresiononi fare.

— Jo xhanëm! Puna nuk qëndron tek impresionimi. E, po ja, ai, shoku Nure, ka botuar një artikull, ku padrejtësisht më bën leckë. Po, po, leckë! Po, ashtu! Unë mendoj ta hedh në gjyq, po më parë desha të di se ç'më këshillon edhe ti si shok.

«Interesant, mendonte me vete prokurori, sa kurajoz ky qerrata! Edhe tani nuk i rrihet pa bërë ndonjë shaka. Po ku e gjeti djalli sot, që unë jam deri në grykë!»

— Mirë e ke! Edhe unë ashtu them, hidhe në gjyq menjëherë! Pse, ku jemi këtu?

— Po a do të më dërgosh njeri për të plotësuar dokumentat, se unë nuk di. Nuk kam patur ndonjë rast të tillë. Për herë të parë hedh në gjyq!

— Sapo të lirohem, do vij vetë!

— Falemi nderit shumë!

— Shumë nder paç!

Drejtori në shtëpi

Erdhi ora e drekës e, megjithëse e kishte marrë uria, ai nuk po i hidhte armët. Të ngrënë ai e kon-

sideronte përherë si një detyrë të shenjtë!

Ishte madhështor! Ishte madhështor! Kishte një kokë të madhe, një tru të madh. Ai kishte një tru të tillë të madh, për të cilin thoshte me vete, siç thuhej dikur për një perandori të lashtë: «Në trurin tim nuk perëndon kurrë dielli»!

Pra, si mund të mposhtej ai, kur kishte një tru të tillë madhështor? Jo, ai edhe sikur të ishte fare pa tru, nuk do ta bënte veten.

— Ti duhet të bësh autokritikë! — ja plasi e shoqja që para buke.

Drejtori, i cili nuk i honepste dot recetat as para buke dhe as pas buke, turfulloi, shkundi xhaketën, drejtoi kravatën dhe tha:

— Atë e di unë! Do të bëj ashtu siç dua unë!

— Dhe jo si e kërkon logjika?

— Dëgjo, grua! Emancipimi i gruas është një çështje, dhe sjellja e saj në ambientin familjar është tjetër çështje. Ti nuk duhet të flasësh kështu me mua. Unë nuk ta lejoj këtë. Unë akoma nuk jam katandisur në atë ditë sa të më japin mend gratë!

— Pse, kush qenka katandisur në atë ditë? Eh, mor burrë, të është bërë koka tym, më duket. Një herë të kritikuan dhe ti nuk di ç'flet. Eh, sikur të kishe të të kritikonin kështu përherë.

— Ty me siguri do të të bëhej qejfi, apo jo?

— Pa tjetër! Se atëhere do të kisha një burrë më të mirë!

— Po nuk do ta kishe drejtor, apo jo?

— Kjo nuk është e tëra. Burrëria nuk qëndron te pozita.

— Po ku?

— Te karakteri!

— Do ta kem parasysh!

— Si të duash!

Komisioni i tretë

Në fakt, ky nuk ishte tamam komision sipas rregullave të njohura dhe të pranuar deri më sot. Sepse ky ishte një njeri i vetëm.

Atij ju dha në dispozicion «Gazi» i ndërmarrjes.

Kur «Gazi» u fut në Kavajë, shoferi frenoi. Frenoi, jo ngaqë nuk i hapnin rrugën, porse kështu mori urdhër. Misionarit vigjilent nuk mund t'i shpëtonte nga syri vigjilent, fakti që në Kavajë kishin dalë ullinj.

Ai për ullinj linte kokën dhe jo «Gazin» e ndërmarrjes. Si bleu 10 kilogram ullinj, u nis me shpejtësi për të vënë në vend kohën e humbur. «Ishalla, ka dalë dhe peshk në Durrës!» — mendoi i kënaqur me vete. «Sa shkon peshku me ullinj dhe me verë!»

Dhe me të vërtetë në Durrës kishin dalë, jo vetëm peshk, por edhe ngjala. Bile edhe midhje! Misionari i drejtorit bleu tri kile peshk dhe dy kile ngjala. Midhjet nuk para i honeste!

Në drejtim të Tiranës, «Gazi» ecte me 80 kilometër në orë.

Në redaksi ai do të vepronte sipas një plani të parashikuar qysh në drejtorinë ku i qe dhënë «Gazi».

— Ju këni botuar një kritikë të gabuar dhe tendencioze. Faktet nuk janë ashtu. Në rreth janë alarmuar. Edhe kryetari i komitetit edhe nënkryetari nuk qenë dakord. Me një rektifikim, ju mund ta hidhni lumin.

Unë si shoku juaj, do të bëj çmos që çështja të mos i kalojë as gjyqit dhe as instancave eprore, siç kanë ndër mend shokët e bazës. Sa për shokun N. Nallbani, (ju e dini për kë e kam fjalën) pavarësisht

pse gaboi, (edhe ne mund të gabojmë) unë mendoj të mos i bëjmë gjë se është i ri. Megjithëse ka gabuar edhe herë të tjera, unë mendoj që këtë radhë të mos e rëndojmë.

Ndoshta nuk mund ta marrin me mend të gjithë se kjo ligjëratë diplomatike ju mbajt sekretarit të kolëgjumit. Ky, nga ana e tij, si e dëgjoji me mirësjellje tjetrin, ja ktheu:

— Të falemi nderit për konsideratën dhe për kujdesin! Por mos u bëj merak. Pasoja nuk do të ketë. Sa për ato gorricat që zure në gojë, dua të të vë në dukje edhe unë si shok se je vënë në një rol, që s'të ka fare hije. Bile të poshtëron. Nuk e kuptoj, ç'të detyroi ta bëje këtë?

— Unë edhe kaq e bëra si shok. Si e qysh, as e di dhe as që më duhet. Faktet anojnë nga i kritikuari. Desha vetëm që të mos kapeshit në befasi. Ti ma more tjetër për tjetër! Kjo është puna jote! Unë po shkoj — dhe misionari u çua, i sigurtë në dy gjëra: Që misioni i tij kishte dështuar plotësisht, dhe që peshqit ende nuk ishin prishur nga koka.

Drejtori pa telefon

Disave telefoni u jep pushtet të posaçëm, magjik, pothuaj. Ka njerëz që, sapo kapin me dorë telefonin, marrin fuqi të çuditshme. Për ta telefoni është një simbol force.

Robinson Kruzo, kur e shpalli veten mbret të ishullit ku zbriti, as që u kujtua fare për telefon. Ndërsa ky drejtor, kurrë nuk do ta shpallte veten mbret, pa siguruar më parë një telefon. Megjithëse ai nuk e krahasonte shokun.

...Kur, papritur në zyrë hyri prokurori, shoku i tij. Megjithëse ai nuk e krahasonte shokun e tij me telefon, prapëseprapë, sikur u ngroh ca nga ardhja e tij.

— Ku je, o bërxcollë me marshinjetro! — bëri shaka prokurori.

— Erdhe, o xhebrail! — ja ktheu drejtori, duke dashur të barazonte. Mirëpo prokurori, që dikur kishte lojtur qëndërsulmues dhe që nuk i kishte patur qejf barazimet, s'u pajtua me këtë rezultat.

— Pra, do bësh dokumentat për në gjyq, ë? Ama, thuaj ç'të duash, po bukur kishte qëlluar! Rruffjan i madh paska qenë. More, po kush është ky N. Nallbani? — pyeti si pa të keq prokurori, duke lënduar kështu bash plagën e drejtorit, të cilit sa nuk i iku kapaku.

— Kushdo që të jetë, unë do ta bëj pulë! Do ta bëj... që... që... të bëhet pishman pse e lindi nëna, ja këtë do t'i bëj!

Prokurori, që gjer atë çast punën e gjyqit e kish-te marë si mesele estrade, frenoi ca dhe po e shikonte me vëmendje shokun e tij.

— Dëgjo, drejtor! Unë i kam marrë për shaka të gjitha këto. Shokë jemi, por të thartat janë të tharta edhe midis shokësh. Prandaj vuri gishtin trurit, shkundu, pranoje kritikën dhe mos kërko qiçra në hell!

Oj ky! Ore! Qysh, ore, dashke të hedhësh në gjyq shtypin popullor? Merr vesh ti nga kjo jallane, apo jeton havadan? — prokurori dalëngadalë filloi të nxehej me të vërtetë, prandaj e pa të udhës ta mbyllte me aq.

— Si? Edhe ti po më braktis në këto momente? Dhe më thua akoma shok? Oh, të falem nderit, pro-

kuror! Po mua mos m'i trëgo as shtypin e popullit dhe as pushtetin e popullit, se këto i di edhe Irena ime tri vjeçe. S'ka gjë! Largohuni! Braktismëni. Be-teja ka më tepër burrëri, kur mbetesh vetëm!

— Ashtu qoftë, po deri më sot asnjë burrë nuk ja ka dalë dot vetëm!

— Atë do ta shohim!

— Lëri këto, drejtor! Të kam shok dhe po të flas hapur. Lëri këto! Në je burrë, prano kritikën, në s'je burrë, rrih ujë në havan!

Komisioni i katërt

Komisioni me detyrën më delikate dhe më të vështirë.

Që nga kohët më të lashta në qytetin tonë janë bërë gjithfarë listash, si: Xhelepet e prapambetura, nizamët e arratisur, taksat e papaguara. Ka patur pastaj lista të veçanta për komitët, për kaçakët e për të tjerë njerëz të pabindur.

Por që të kujtohej njeri e të bënte listën e shakaxhinjve të qytetit tonë, kjo nuk i kishte shkuar ndër mend njeriut deri më sot! Ishte pra, e para përpjekje serioze në histori për të futur në një listë të gjithë ata njerëz gazmorë!

Si çdo qytet tjetër edhe qyteti ynë ka kusuret e veta. Dhe këtë radhë kusuri kapi dy pijanecët tanë të vetëm. Kuptohet se, kur ata janë esëll (gjë që ndodh rrallë), nuk janë në qejf. Po më dendur i gjen rrumbull, duke këputur qyfyre majtas e djathtas. Kjo gjë e ngatërroi mjaft edhe komisionin e pestë. T'i fuste në lisën e shakaxhinjve apo të mos i fuste.

— Ne kemi për detyrë të bëjmë listën e shakaxhinjve. Dhe, përderisa këta janë njerëz që gjithë di-

tën bëjnë shakara, ne s'kemi asnjë të drejtë që të mos i futim në këtë listë me rëndësi.

— Kjo është një punë me të vërtetë e ngatërruar. Ne kemi urdhër të bëjmë listën e shakaxhinjve dhe jo të pijanecëve. Po fakti që të gjithë pijanecët bëjnë shakara e ndërlikon mjaft çështjen. A... po, sikur të hiqnin dorë nga pija, zgjidhej kollaj, i futnim menjëherë në listë.

— Po vallë a do të bënin më shakara ata sikur të hiqnin dorë nga pija? Unë jam i mendimit që lidhur me këtë problem të pyesnim njëherë ministrinë. Ata duhet t'i japin dum kësaj pune.

— Për të qenë brenda, ne duhet të veprojmë kështu: T'i regjistrujmë në listë të dy pijanecët dhe në kolonën, «vërejtje», të shënojmë: «Këta janë pijanecë, por merren vullnetarisht edhe me shakara».

Ky propozim u duk si më i pjekuri, prandaj dhe u pranua me shumicë votash. Kështu u inauguroi lista e shakaxhinjve të qytetit tonë.

— Hë, shokë, mendoni dhe flisni, kush tjetër bën shakara në qytet?

— Po pse, ata që bëjnë shaka në fshat, nuk do t'i përmbledhim.

— Kush tha, që jo? Ne do ta bëjmë listën si rreth.

— Sulo Kodra... Resul Saliu... Bate Duka... Vasil Tylo... Nase Kali...

— Prit, Bate Duka, ndjesë pastë, ka dy vjet që nuk merr më frymë!

— E kush i tha ta bënte atë punë?

Në krye të listës u vunë aktorët e estradës bashkë me regjizorin e tyre. Pastaj u shtua edhe drejtori i shtëpisë së kulturës. Ç'është e drejta, ky drejtor nuk ja shkrephte fare për shakara. Por ai u përfshi dety-

rimisht në listë ngaqë kishte të bënte me njerëz që pak a shumë rropateshin t'i bënin të tjerët për të qeshur, pavarësisht se sa ja arrinin qëllimit.

— Tendose aty dhe mos e zgjat — tha një anëtar i komisionit.

Regjistrimi vazhdonte, sapo që ndonjë nga anëtarët e komisionit kujtohej se filani, në filan vend, në atë apo këtë gosti, mbledhje, bisedë, piknik, kishte treguar ndonjë anekdotë, apo kishte dashur të tregonte ndonjë anekdotë.

Pa pritur, kryetari i komisionit brofi më këmbë dhe shpërtheu në bulevard si një ciklon verior. Në stuhi e sipër shkeli një zagar, u përplas me një kalë të komunales, kapërceu së larti dhe së gjati një karrrocë fëmijësh.

E gjithë puna që se atij ju kujtua një i njohur, plak 110 vjeç. Donte ta pyeste pa tjetër se mos njihnte ndonjë të moshuar që ishte marrë me shakara në kohën e turkut, në qeverinë e princ Vidit, apo gjatë rrebelimit të Haxhi Qamilit. Por u kujtua se ky plak kishte dy javë sëmurë, prandaj nxitonte për ta arritur të gjallë me çdo kusht.

Duke mos përfillur as trafikun dhe as bilbilin e policit, kryetari i komisionit të katërt u dha të shtëpia e plakut, kur nga larg i zuri veshi diçka të papëlqyer. Aty kishte krisur vaji. Duke marrë me mend fatkeqësinë e pandreqshme, arriti të thoshte vetëm kaq: «Si nuk duroi dhe ca. i uruari!»

Drejtori shkruan një letër

Fjala është ende për drejtorin e kritikuar. Duke menduar natë e ditë për kritikën, atij i lindi edhe një tjetër ide e dobishme: T'u dërgonte nga një le-

tër të fortë dhe mallëngjyese instancave qeveritare, duke filluar nga kryeqyteti e deri në rreth.

Për këtë thirri në ndihmë edhe personin që qe kthyer nga Tirana me «Gazin» e ndër marrjes. Atë e thirri meqë i jepej më tepër për të sheqerosur shkresa, megjithëse as vetë dhe as ndonjë nga të parët e tij nuk e kishin ushtruar profesionin e hallvaxhiut, qoftë edhe si amatorë.

Letra fillonte kështu:

«Jo për t'u shfajësuar dhe as për të hedhur poshtë kritikën, po vetëm për hir të së vërtetës historike, do ta quaja veten të ulët po të mbaja të fshehura ato që di.

Faktet janë shtrembëruar në mënyrë flagrante me qëllime të paramenduara dhe të përcaktuara mirë. Dhe këto qëllime janë:

Si e si të diskretitohen të fyhen dhe të thyhen kuadrot besnikë dhe të palodhur. Karshi këtij qëllimi të poshtër, kriminal dhe armiqësor, unë nuk mund të rri sehirxhi. E quaj për detyrë të sugjeroj, që të verifikohet me kujdes biografia e autorit, biografia që sipas mendimit tim lë mjaft dyshime.»

Pasi mbaruan këtë punë të paqme, drejtori pati një takim të shkurtër me ish-shoferin e tij, tani ende përgjegjës kuzhine.

— Ju vura, pa dashur në telashe, shoku drejtor! Kurrë nuk e kisha menduar se do të arrinte puna gjer këtu. Po ja që njerëzit të tillë janë!

— Mos u mërzit, pëllumbi im! Ka për t'ju gjetur ilaçi edhe kësaj!

Ta zëmë se komiteti do më urdhërojë të të heq nga kjo punë. Ta zëmë se unë do ta zbatoj këtë urdhër. Po armët nuk do t'i hedh. Fejohu një orë e më parë, pasi gruan tënde të ardhshme që sot mund ta

emëroj përgjegjëse kuzhine! More vesh? Të më njo-
hin mirë kush jam! Pastaj po deshën të më kritikojnë
për ngritjen e shoqeve në përgjegjësi.

— Të fejohej? Që ajo të zërë vendin tim!
Ide interesante! Do ta mendoj...

— Jo ta mendosh, por ta vendosësh sa më parë!

— Mirë, po ime shoqe e ardhshme mund të mos
jetë kuzhinierë?!

— Të jetë ç'të dojë. Në daç dokoreshë, në daç
arkitekthe. Unë për kapriçio të të tjerëve do ta bëj
përgjegjëse kuzhine. Të më shohin!

Rezultatet e kërkimeve

Mbledhja e përgjithshme e komisioneve ishte
me të vërtetë e përgjithshme dhe e plotë. Ishte në
nivelin e konferencave shkencore. Materiali i mble-
dhur ishte aq i shumtë, sa që për trajtimin shkencor
të tij hapej një punë me përpjesëtime kolosale.

Komisioni i parë kishte ikur me bisht në krahe
nga komiteti, prandaj ai raportoi shkurt, shpejt dhe
me zig-zage për misionin e vet të pafat. Përfundimi:
Komiteti do ta shqyrtonte çështjen dhe do ta nxirrte
autorin përpara përgjegjësisë. Kishte mundësi t'ja
hiqnin të dy veshët, megjithëqë askush nuk nisej nga
motive hakmarrëse.

Komisioni i dytë kishte më tepër bereqet. Për-
veç të 104 vetave që kishin të bënin me mbiemrin
Nallbani, dilnin edhe 35 të tillë nga të tri rrethet
fjinje, si dhe 61 nallbanë nga kryeqyteti. Pra lista e
të dyshimtëve arrinte në 200 veta. Për një komision
të vetëm, kjo ishte një punë me të vërtetë kolosale!
Komisioni i tretë e pa me vend të mos rapor-

tonte, jo vetëm se dështoi padashur, por edhe pse ai i kishte raportuar në vesh drejtorit për të gjitha përpjekjet e tij heroike dhe humanitare.

Interesante ishin edhe të dhënat e komisionit të katërt. Qyteti ynë kishte nxjerrë përmbi 450 shakaxhinj! Nga këta, katër qenë shpërngulur në kryeqytet, nëntë në bregdet, tre vazhdonin studimet, shtatë kishin hyrë dhëndurrë brenda e jashtë rrethit, 11 kishin vdekur vitin e kaluar, një qe mbytur pa dashje në lumë, duke peshkuar me kallam në orarin zyrtar, dy ishin bërë pilotë dhe hajde t'i kapje, ndërsa njëri kishte përfunduar si kampion në mundjen klasike. Edhe me këtë nuk rekomandohej t'i zije qetë, prandaj dhe u la në fund të listës.

— Qenki lodhur shumë! — falenderoi shkurt drejtori.

— Ne jemi me të vërtetë të lumtur që na u dhà rasti të shpehim devotshmërinë tonë ndaj një miku. ndaj një shoku. Raste të tilla janë të rralla në jetë, e bile shpesh të pamundura. Vetëm në romanet prekëse kalorësiake gjenden të tilla raste prove mbi dashurinë midis shokësh.

Kjo tregon se në jetë ka akoma miq besnikë, miq jo vetëm me kokë, por me këmbë të shpejta, siç ishte, fjala vjen, kryetari i komisionit të katërt, i cili nuk u kap dot nga asnjëri prej policëve të trafikut, me gjithë kondravajtjet e shumta.

Ja ç'do të thotë shoqëri dhe besnikëri prej shoku. Le të marrim shembull nga kjo provë prekëse rreth shokut drejtor.

Ndërsa lulëzonte kësisoj etiketa servile ndaj personalitetit të shokut drejtor, ndodhi një tjetër e papritur.

Kryetari i komisionit të katërt turfulloi në çast

dhe u vërvit në derë e jashtë si një firifickë! Ìnstinkti i detyrës e shtyu atë të verifikonte në vend varrimin e plakut 110-vjeçar, se mos kushedi, mund të kish patur vetëm vdekje klinike. E po të qe kështu, diç do të dilte nga një moshë e tillë, lidhur me shakaxhinjtë e lashtë të qytetit.

Ndërkohë vazhdonin diskutimet shkencore të të pesë komisioneve.

— Mua më duket se kemi lënë pa të drejtë mënjane disa prova nga materiali i shumë folkloristik. Fjala vjen, kush e ka bërë atë bejten:

*«O pasha, tungjatjeta,
Pse kështu të dridhet mjekëna?
S'ke parë plumba nga Gjonleka...»*

— Hane Shan, hane Bagdat! Ç'na ngatërron me Tanzimatin, o vülëhumbur! Më mirë të sqarojmë kush e ka kurdisur atë këngën:

*«Mu në breg të lumit një moll' e një shëlg,
Lëri, Shero, nazet, se s'të ka lezet...»*

Duhet sqaruar tani, cila ishte kjo Shero dhe përse bënte naze!

— Jo, shokë! Ne duhet të konkludojmë më në fund. Sipas jush, kush do t'i ketë kurdisur këto vargje:

*«Aisheja në vapor
Nuk do burrë, po do dashnor...»*

Unë vetë e kam dëgjuar tek e këndonin kalamajtë e një kopshti me katër edukatore. Po, se cili

që autori, fëmijët nuk besoj ta dinë. Sikur të pyes-
nim njëherë edukatorët, nuk do të qe keq.

Listat e njerëzve të dyshimtë kalonin dorë më
dorë, si menu gjellësh. Dikush hiqte kryqe, dikush
vija, pikëpyetje, pikëçuditëse, e të tjera shënja pikë-
simi, apo shënja të tjera konvencionale.

Rrethi i njerëzve të dyshimtë sa vinte e po ngu-
shtohet. Autori edhe zog me krahë të bëhej, nuk do
mund t'i shpëtonte dot këtij aksioni me goditje të
përqëndruar.

— Shokë! Ky rast dëshmon edhe një herë se
sa prapa ka mbetur shkenca e kërkimeve. Ç'është
kjo punë? Në shekullin e fluturimeve kozmike, kur
njeriu shëtiti në Hënë, sikur të jetë buzë Pogradecit,
nuk gjen dot se kush e ka shkrojtur iks artikull!

— Interesant kjo puna e kërkimeve! Le të ma-
rrim fjala vjen, arkeologjinë. Ajo deshifron shkrime
apo hieroglifë këtu e 10-15.000 vjet të shkuar, ndërsa
nuk gjen dot autorin e një artikulli të freskët! E, po
të jetë se arkeologjia nuk e gjen këtë autor pas 10-
-15.000 vjetësh, më thoni, ju lutem, kujt do t'i hynte
në punë një sukses i tillë?

Dhe a nuk dëshmon se ky sektor nuk po revol-
ucionarizohet?

— Ej, kujdes! Ne nuk po marrim në shqyrtim
këtu punën e arkeologjisë apo të monumenteve të
kulturës. Përse na ngatërroni kot me këto?

— Do ta gjejmë, shok, do ta gjejmë! Kurajo!
Edhe pa ndihmën e arkeologjisë mijëvjeçare do ta
gjejmë. Edhe sikur autori të futet në bri të buallit,
siç duan të thonë, por që unë nuk e besoj aspak, ne
do ta gjejmë. Do të pyesim dhe do ta gjejmë.

Bota me të pyetur kanë gjetë Stambollin dhe jo
ne një bashkëqytetarin tonë.

Dhe ndoshta do ta kishin gjetur me të vërtetë, sikur të mos kishte arritur një lajm antishkencor: Drejtori, hëpërhë, pezullohej nga puna! Vetëvetiu kërkimet shkencore në adresë të autorit bëheshin të pavlefshme.

Vetëvetiu komisionet u shpërndanë në rrëmujë, duke harruar kështu (ndoshta padashje), të ngushëllonin edhe ish-drejtorin e tyre!

Ata nguteshin për të marrë vesh, jo më emrin e autorit, por emrin e drejtorit të ri!

84	Kafka e Paris
85	I dashur Mirra!
86	Lufta dhe parroti
87	"Tërbësi i detëve"
88	Korja e kryetarit
89	Gjyqi në pyll
90	Huntë e leantëve
91	Instalvat e Bardhi
92	Projektet e Gëzimit
93	Jeta dhe shkencat
94	Letër nga jeta për varrit të mështit
95	Një ditë me një dash
96	Një apartam
97	Letër gjatë
98	Një dëron e kulturës
99	Vashdim i një lëstioni
100	Përse eka jeta në poezi
101	Një mbledhje për dashurinë
102	Skandat e Xantit
103	Shën i shëtit
104	Funkcionet e kapeles
105	Marjetet e Mitros
106	Rënia në peshë
107	Çarmantini i anashkorur
108	Karambali
109	Revizionimi dhe revizionistët
110	Mrekullitë e orëve të fundit
111	Përgjigja e Carit
112	Ultrarevizionistët
113	Veza e Kolombit
114	Çiftogjatë përdorore
115	Kërkohet në dafin (novelë)